



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

RAPORTI I VEPRIMTARISË

PËR VITIN

2020

Tiranë, 2021

© 2020

Ky raport dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë e drejtë autori. Të gjithë të drejtat janë të rezervuara për Bordin e Mbikëqyrjes Publike në Shqipëri. Kopjimi dhe përhapja e të dhënave apo përdorimi tregtar i këtij raporti nuk është i lejuar përveç kur jepet miratim me shkrim. Është i ndaluar vendosja e këtij raporti në faqe interneti edhe kur kjo bëhet pa pagesë, nëse nuk është marrë aprovimi paraprak nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Përdorime të tjera që nuk parashikohen në këtë seksion janë të lejuara vetëm nëse burimi i informacionit citohet me saktësi “Bordi i Mbikëqyrjes Publike i Shqipërisë”.

PËRMBAJTJA

Akronime	5
1.Përmbledhje ekzekutive	6
2.Përbërja dhe detyrat e Bordit të Mbikëqyrjes Publike	8
2.1.Përbërja e BMP	9
2.2.Të drejtat dhe detyrat e BMP	11
2.3.Direktiva 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 maj 2006, “Mbi auditimet ligjore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara, ndryshimin e direktivave të Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizimin e direktivës së Këshillit 84/253/KEE”, e ndryshuar.....	12
2.4.Kërkesat brenda Bashkimit Evropian mbi kontrollin e cilësisë - Rregullorja 537 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Bashkimit Evropian.....	14
3.Shërbimet e auditimit, kontabilitetit dhe rregullimi i profesionit kontabël	18
4.Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2020.....	21
4.1.Akte rregullatore të reja e të ndryshuara.....	21
4.1.1Statuti i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i ndryshuar	21
4.1.2Rregullorja nr. 2, datë 22.02.2018 “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar”, e ndryshuar dhe Rregullorja nr. 6, datë 31.05.2018 “Për procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale të kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar”, e ndryshuar	21
4.1.3Rregullorja nr. 5, datë 29.03.2018 “Për Organizimin dhe funksionimin e strukturës mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, e ndryshuar.....	22
4.1.4Rregullorja nr. 10, datë 11.06.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Regjistrimit dhe përditësimin e regjistrit publik”, e ndryshuar	23
4.1.5Rregullorja nr. 12, datë 02.07.2020 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”	23
4.2.Funksionimi i komisioneve të ngritura pranë BMP	24
4.2.1.Komisioni Ad-Hoc “Për Verifikimin e Kontabilistëve të Miratuar”	24
4.2.2Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale.....	38
4.2.3Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës	43
4.2.4Komisioni Ligjor.....	44
4.2.5Komisioni për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit	46
4.2.6Komisioni i Rishikimit.....	48
4.2.7Komisioni i Revistës së BMP-së.....	49

4.2.8Komisioni i Brendshëm për Kontrollin e Cilësisë	50
4.3.Rritja e kapaciteteve të stafit mbështetës	52
5.Vështrimi i përgjithshëm mbi shërbimet e auditimit	54
5.1.Cilësia në auditim	54
5.1.1Cilësia në auditim dhe përgjigja jonë.....	54
5.1.2Konkurrenca në tregun e auditimit	55
5.2.Inspektime me fokus kontrollin e cilësisë.....	57
5.3.Gjetje të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	58
5.3.1Manualet dhe procedurat e brendshme në lidhje me kontrollin e cilësisë	59
5.3.2Metodologjia e auditimit.....	59
5.3.3Mbledhja, arkivimi dhe ruajtja e dosjes së angazhimit.....	59
5.3.4Raporti i transparencës.....	60
5.3.5Auditimet e përbashkëta, kryerja e angazhimit, menaxhimi i dosjes, plotësimi dhe arkivimi i saj.....	60
5.4.Gjetje të angazhimeve individuale.....	60
5.4.1Parakushtet për pranim/vazhdim të klientit/angazhimit të auditimit	60
5.4.2Vlerësimi i riskut dhe përgjigja ndaj riskut të vlerësuar	61
5.4.3Raportimi	62
6.Rekomandime për audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit	63
6.1.Rekomandime për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë	63
6.2.Rekomandime për angazhimet e auditimit	64
7.Procese të realizuara në kuadër të kontrollit të cilësisë	65
7.1.Rishikimet e Kontrollit të cilësisë në bashkëpunim me Bankën Botërore.....	65
7.2.Vlerësimi i zbatimit të planit të veprimit në vijim të procesit të kontrollit për sigurimin e cilësisë66	
7.3.Inspektimet tematike në zbatim të rregullores nr. 12, datë 02.07.2020 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.....	66
7.3.1Rekomandime për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit	69
8.Masat e marra ndaj subjekteve të ndryshëm	70
9.Mbikëqyrja e organizatave profesionale	71
9.1.Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar.....	71
9.2.Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Audituesve Ligjorë.....	72
9.3.Inspektimi tematik pranë Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë.....	73

10. Aktivitetet me institucionet homologe dhe institucionet e tjera	77
10.1. Webinar mbi çështjet e papajtueshmërisë ligjore dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	77
10.2. Webinar mbi plotësimin e formularit të deklarimit të të dhënave për PPP-FT	78
10.3. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Moneyval	78
10.4. Roli dhe kontributi i BMP në raportimin në FATF	79
10.5. Bordi i Mbikëqyrjes Publike anëtar i IFIAR	80
10.6. Bordi i Mbikëqyrjes Publike anëtar i IRDAM	81
10.7. CFRR	82
10.8. Bashkimi Evropian – Progres Raporti	83
10.9. Bashkëpunimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	84
10.10. Bashkëpunimi me KKRF	86
10.11. Bashkëpunimi me rregullatorë të tjerë në rajon dhe organizata të tjera rajonale	86
11. Planifikimi i punës për vitin 2021	87
11.1. Planifikimi i punës për rregullimin dhe organizimin e kurseve profesionale për kandidatët për Kontabilistë të Miratuar	87
11.2. Ndryshimi i Rregullores Nr. 7, datë 02.10.2018 për “Procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor”	87
11.3. Memorandumi me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar	88
11.4. Kontrolli i cilësisë	88
11.5. Inspektimet tematike për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	89
11.6. Testimi i kontabilistëve të miratuar për përmbushjen e orëve të edukimit të vijueshëm profesional	89
11.7. Mbikëqyrja e Kontabilistëve të Miratuar dhe organizatave profesionale përkatëse	90
11.8. Trajnime të ndryshme për zhvillimin e stafit	90
11.9. Roli dhe kontributi i BMP në raportimin në FATF	91
11.10. Bashkëpunime me institucione të tjera	92

Akronime

AL	Auditues Ligjorë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BMP	Bordi i Mbikëqyrjes Publike
BSH	Banka e Shqipërisë
BSNEPK (IESBA)	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël
CFRR	Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
EKR	Ekspert Kontabël i Regjistruar
EVM (SME)	Entitet i Vogël dhe i Mesëm
FATF	Taks Forca e Veprimit Financiar
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
IFIAR	Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Auditimit
IRDAM	Task forca për zhvillimet e rëndësishme ndërkombëtare në tregjet e auditimit
KIDB	Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës së Bordit të Mbikëqyrjes Publike
KM	Kontabilist i Miratuar
KPAP	Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale
NIP	Njësi me Interes Publik
NUIS (NIPT)	Numri Unik i Identifikimit të Shoqërisë
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SKK (NAS)	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
SNA (ISA)	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNKC1 (ISQC1)	Standardi Ndërkombëtar i Kontrollit të Cilësisë 1
SNRF (IFRS)	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet në mënyrë të detajuar punën e zhvilluar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) përgjatë vitit 2020, në funksion të mbikëqyrjes së audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, kontabilistëve të miratuar, si dhe organizatave profesionale përkatëse. Gjatë këtij viti, edhe pse në kushte jo shumë të favorshme për shkak të pandemisë globale të Covid-19, BMP ka vijuar punën në mënyrë intensive në kuadër të krijimit dhe rritjes së sigurisë së auditimit kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar, të kujdesshëm dhe në shërbim të interesit të publikut, bazuar në kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare.

Në këtë aspekt, gjatë këtij viti është realizuar procesi i raportimit të inspektimeve të kontrollit të sigurimit të cilësisë në nivel firme dhe dosjeve në nivel angazhimi të auditimit të realizuara në terren gjatë vitit 2019; kanë filluar inspektimet tematike në zbatim të rregullores nr. 12, datë 02.07.2020 *“Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”*, në kuadër të planit të veprimit të miratuar nga Komiteti i Bashkëndimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave me qëllim realizimin e kërkesave të grupit të punës ICRG/FATF; janë realizuar aktivitete bashkë inspektimi në bashkëpunim me DPPPP, me tematikë çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në shoqëri auditimi, për të vënë në zbatim të gjitha kërkesat që vijnë nga rekomandimet e Komitetit Moneyval dhe nga FATF për matjen e efektivitetit të zbatimit të këtyre rekomandimeve; ka filluar puna për realizimin e procesit të vlerësimit të zbatimit të planit të veprimit në vijim të realizimit të procesit të kontrollit të cilësisë pranë shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë të realizuar gjatë vitit 2018.

Gjithashtu, për herë të parë, në bashkëpunim me Bankën Botërore, u realizua procesi i vlerësimit për përcaktimin e pranueshmërisë së audituesve, duke kryer një rishikim të kontrollit të cilësisë të shoqërive të interesuara të auditimit. Ky vlerësim u realizua në përputhje me udhëzimet e vlerësimit të shoqërive të Auditimit, në zbatim nga Banka Botërore dhe përfshiu rishikimin e informacionit fillestar të siguar nga të gjitha shoqëritë e auditimit që shfaqën interesin e tyre nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të përgatitur nga Banka Botërore, vizitën në terren në shoqëritë e auditimit dhe komunikimin e rezultateve të rishikimit.

Si pjesë e planit të veprimit të miratuar nga Komiteti i Bashkëndimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, me qëllim realizimin e planit të veprimit, adresimit të kërkesave të grupit të punës ICRG/FATF për parandalimin e infiltrimit të kriminelëve në subjektet e licencuar auditues ligjorë dhe në interesat kontrollues të shoqërive të auditimit nga individë që nuk janë auditues ligjorë, u realizua gjithashtu për herë të parë gjatë këtij viti procesi i mbikëqyrjes së veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit dhe Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, përmes një inspektimi tematik.

Pjesë e rëndësishme e punës së BMP-së gjatë vitit 2020 ishte edhe verifikimi i ligjshmërisë së veprimtarisë së kontabilistëve të miratuar dhe mbikëqyrja e organizatave profesionale të

kontabilistëve të miratuar. Ky proces vlerësohet mjaft i rëndësishëm konsideruar faktin që kontabilistët e miratuar, përmes shërbimeve të tyre, luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e biznesit dhe formalizimin e ekonomisë dhe është një proces që ka për objektiva përfundimtar formalizimin e tregut të shërbimeve të kontabilistëve të miratuar, duke garantuar një edukim të vijueshëm, konsekuent dhe shërbime profesionale të mbikëqyrura përmes organizatave profesionale dhe BMP-së. Ky proces përkon edhe me veprimtarinë e Qeverisë Shqiptare në tërësi për reduktimin e informalitetit, ku roli profesional i kontabilistëve të miratuar është i domosdoshëm dhe i rëndësishëm.

Në funksion të përforcimit të integritetit të institucionit, por edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse, si një domosdoshmëri për të arritur standardet më të larta në profesionin e auditimit dhe raportimit financiar, duke e parë këtë zhvillim të lidhur ngushtë dhe me procesin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, BMP, ndërmori një sërë hapash si në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator, ashtu edhe në drejtim të plotësimit të strukturës së tij organizative përmes ngritjes së komisioneve të reja pranë tij.

Edhe gjatë 2020, BMP ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me rregullatorë homologë apo institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, veprimtaria e të cilëve lidhet direkt ose indirekt me aktivitetin mbikëqyrës. Vlen të theksohet se bashkëpunimi ndërkombëtar me homologët në Evropë ka kontribuar në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira mbikëqyrëse dhe rregullatore.

2. Përbërja dhe detyrat e Bordit të Mbikëqyrjes Publike

BMP u krijua në tetor 2009 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Ndryshimet e reja ligjore në ligjin 47/2016 përmirësuan ndjeshëm rolin e BMP-së duke pasqyruar vizionin e institucioneve homologe të Bashkimit Evropian dhe kërkesat e rregullores 537 të BE-së.

Pas këtyre ndryshimeve, BMP ka marrë statusin e autoritetit të pavarur rregullator duke realizuar mbikëqyrjen publike të profesionit të auditimit dhe shoqërive të auditimit, si drejtpërdrejtë, ashtu edhe nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë. BMP është gjithashtu autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e profesionit të kontabilistëve të miratuar dhe organizatave profesionale përkatëse.

Përmirësimi i mjedisit të auditimit nuk do të ishte i mundur pa burimet njerëzore të mjaftueshme dhe të kualifikuara. Bazuar në përcaktimet e ligjit të sipërpërmendur dhe me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 786/2016, i ndryshuar, u mundësua krijimi i një strukture mbështetëse të angazhuar me kohë të plotë me qëllim realizimin dhe ndjekjen në vazhdimësi të veprimtarisë së BMP-së. Aktualisht, BMP ka një personel prej 7 (shtatë) ekspertësh të kualifikuar, duke përfshirë 3 (tre) inspektorë të lartë të sigurimit të cilësisë.

Misioni i Bordit të Mbikëqyrjes Publike është mbikëqyrja publike e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, organizatave profesionale të audituesve ligjorë si dhe organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar me qëllim përmbushjen e objektivave publike në mbështetje dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, kuadrit rregullator dhe në shërbim të interesit publik.

Objektivi kryesor i BMP-së është të rrisë sigurinë që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik. Në ushtrimin e funksionit rregullator dhe mbikëqyrës, BMP udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.

2.1. Përbërja e BMP

Bordi i Mbikëqyrjes Publike përbëhet nga pesë anëtarë jo-praktikues, të cilët janë ekspertë në fusha të lidhura me auditimin ligjor, emëruar nga Ministri përgjegjës për financat, me mandat për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtën për t'u rizgjedhur jo më shumë se dy herë. Anëtarët e Bordit janë përzgjedhur bazuar në kritere të përcaktuara dhe përmes një procedure konkurruese të pavarur dhe transparente bazuar në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 *“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”*, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 786, datë 09.11.2016 *“Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”*, e ndryshuar; si edhe në Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 24.03.2017 *“Për emërimin dhe mandatimin e Kryetarit dhe Anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”*.

Bordi përbëhet nga anëtarët në vijim:

Kryetar - Dritan Fino

Edukimi dhe eksperiencia e Z. Fino ka qenë e përqendruar në fushën e kontabilitetit, financës dhe auditimit. Z. Fino zotëron gradën “Doktor i Shkencave”, të realizuar në Universitetin e Kyushu Sangyo, Japoni. Që prej vitit 2007 ka dhënë leksione në institucione të ndryshme në Japoni, Slloveni, Zvicër dhe në Shqipëri, duke përfshirë institucione të arsimit publik dhe atij privat. Z. Fino, përgjatë karrierës së tij, ka dhënë kontribut të rëndësishëm në profesionin kontabël, veçanërisht atë të auditimit, ku vlen të theksohet se më herët përgjatë karrierës së tij është angazhuar si anëtar në Komitetin e Regjistrimit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar për regjistrimin e Audituesve Ligjorë, si dhe Kryetar i Komisionit të Kualifikimit dhe Certifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik. Aktualisht, Z. Fino punon si Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Ai është bërë pjesë e kësaj Ministrie në muajin nëntor të vitit 2013, si këshilltar pranë Kabinetit të Ministrit, duke mbuluar fusha që lidhen me auditimin, kontabilitetin, menaxhimin financiar, etj. Z. Fino është anëtar i një sërë grupesh pune që lidhen me çështje të parandalimit të pastrimit të parave, integritit, etj. Ai është autor i një sërë librash dhe artikujsh të ndryshëm të publikuar brenda dhe jashtë vendit.

Anëtare - Adriana Berberi

Znj. Adriana Berberi ka mbaruar Fakultetin e Ekonomisë, degën e kontabilitetit në vitin 1981. Znj. Berberi ka një eksperiencë shumë të gjatë në fushën akademike që prej vitit 1986. Gjithashtu, Znj. Berberi është e certifikuar me titullin profesional të Kontabilistit të Miratuar dhe Audituesit Ligjor. Që prej vitit 1997, Znj. Berberi ka mbuluar funksione të rëndësishme si: Zëvendësministër i Financave, Drejtor Kabineti në Kryeministri, Drejtor Kabineti i Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtor Kabineti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Kryetare e Bordit të Mbikëqyrjes Publike për mandatin e dytë të funksionimit të BMP, etj. Gjithashtu, Znj. Berberi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm përgjatë karrierës së saj në ngritjen e kapaciteteve të profesionit kontabël, ku vlen të theksohet se ka qenë anëtare e Këshillit Drejtues të Institutit të

Ekspertëve Kontabël, si dhe e angazhuar në proceset e edukimit të kandidatëve të rinj. Znj. Berberi është e emëruar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë si anëtare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.

Anëtar - Luan Abazi

Z. Abazi është diplomuar në degën e financës, Fakulteti i Ekonomisë, në vitin 1984. Z. Abazi ka një eksperiencë të gjatë në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit, veçanërisht në institucione të sektorit publik. Gjithashtu, Z. Abazi është certifikuar me titullin profesional të Audituesit Ligjor. Ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në forcimin e profesionit kontabël ku edhe me herët përgjatë karrierës, edhe si anëtar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike në mandatin e mëhershëm, ka ndikuar në përmirësimin e një sërë aktiviteteve që prekin profesionin. Aktualisht, ushtron detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Z. Abazi ka një eksperiencë të gjatë në Prokurorinë e Përgjithshme si Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Gjithashtu, Z. Abazi është i kualifikuar edhe në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, për të cilën është certifikuar në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Anëtare - Edlira Luçi

Znj. Edlira Luçi është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë dhe Tregtisë, pranë Universitetit të Barit, Itali, në vitin 1997. Gjithashtu, Znj. Luçi ka fituar gradën “Doktor i Shkencave” në fushën e ekonomisë, me temën *“Përsosja e menaxhimit të portofolit të investimeve në kompanitë financiare”*. Ajo ka një eksperiencë të gjatë në fushën akademike, duke dhënë kontributin e saj në shumë fakultete, brenda dhe jashtë vendit. Më herët, Znj. Luçi ka qenë anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si dhe Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Znj. Luçi është drejtuese e Departamentit të Financës në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe njëkohësisht është anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ajo është autore e një sërë artikujsh dhe tekstesh të publikuara brenda dhe jashtë vendit.

Anëtar - Klement Mersini

Z. Mersini është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, pranë Universitetit të Tiranës. Aktualisht, Z. Mersini punon si Drejtor i Financës pranë SIGAL Uniqa. Z. Mersini ka një eksperiencë të gjatë në fushën e raportimit financiar dhe auditimit, lidhur dhe me fushën e sigurimeve, ku ka kryer një sërë specializimesh dhe trajnimesh të dedikuara brenda dhe jashtë vendit. Përgjatë karrierës së tij, Z. Mersini ka punuar edhe si inspektor pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si dhe ka fituar gjithashtu një eksperiencë të konsiderueshme në sektorin privat me kompani të ndryshme si drejtues në departamentin e financës dhe kontabilitetit. Ai është angazhuar më herët si lektor për lëndët e financës në institucione akademike publike dhe private në Shqipëri, si dhe numëron botime dhe artikuj të ndryshëm në

fushën financiare. Z. Mersini ka fituar titullin profesional të Kontabilistit të Miratuar dhe atë të Audituesit Ligjor.

Në përmbushjen e funksioneve të veta, Bordi i Mbikëqyrjes Publike asistohet nga Struktura Mbështetëse.

Struktura Mbështetëse drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv.

Drejtor Ekzekutiv - Aldo Spahiu

Z. Spahiu ka një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e auditimit, financës dhe kontabilitetit, të fituar përmes angazhimeve me kompani ndërkombëtare auditimi dhe institucione të ndryshme në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Gjermani, Austri, Francë, Zvicër, Greqi, Ukrainë, UK. Z. Spahiu është autor i një sërë artikujsh të publikuar brenda dhe jashtë vendit dhe është angazhuar si lektor në universitete dhe institucione prestigjioze në Kosovë, Shqipëri, Austri, Ukrainë. Më herët ai ka punuar si ekspert i angazhuar përmes Bankës Botërore, Bashkimit Evropian, projekteve të Qeverisë Zvicerane, projekte të UNDP në fushat e auditimit ligjor, kontabilitetit rregullator, auditimit të brendshëm, raportimit financiar, përcaktimit të tarifave, reformës territoriale, etj. Ai ka mbaruar studimet për Financë Kontabilitet në nivel MSc., si dhe ka kryer një MBA pranë Universitetit të Tiranës. Z. Spahiu është anëtar i SCAAK dhe zotëron titullin e audituesit të certifikuar në Kosovë. Ai ka fituar titujt e Audituesit Ligjor, Kontabilistit të Miratuar, Audituesit të Brendshëm për Sektorin Publik të Konsulentit të Drejtimit të Certifikuar (CMC). Z. Spahiu është anëtar i Bordit (Treasurer) të BCC në Kosovë, pjesë e listës së ekspertëve të jashtëm të BE-së, si dhe anëtar i disa grupeve ndër-institucionale shtetërore që lidhen me integrimin, parandalimin dhe pastrimin e parave.

Struktura Mbështetëse përbëhet nga inspektorë të lartë të kontrollit të cilësisë dhe staf administrativ, të cilët kanë një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e auditimit ligjor, raportimit financiar dhe ekspertizës në kontrollin e cilësisë së auditimit ligjor, kuadrit ligjor dhe fushave të lidhura me parandalimin dhe pastrimin e parave, standardeve ndërkombëtare të edukimit, etj.

Gjatë vitit 2020 BMP ka zhvilluar 13 mbledhje dhe ka marrë 102 vendime me qëllim përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të parashikuara në ligj. Vendimet e Bordit janë marrë në transparencë të plotë, duke respektuar parimin e kolegjalitetit.

2.2. Të drejtat dhe detyrat e BMP

Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, neni 5, BMP ka këto të drejta dhe detyra:

- harton rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale (KPAP) dhe të Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, të cilat i paraqiten për miratim autoriteteve të parashikuara në këtë ligj;
- mbikëqyr, monitoron dhe vlerëson zbatimin e procedurave të testimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese;
- miraton formatin e regjistrimit publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese, të regjistruara nga Komiteti i Regjistrimit, si dhe mbikëqyr respektimin e rregullave në lidhje me numrin e identifikimit të audituesve ligjorë në regjistër;
- miraton Kodin e Etikës të audituesve ligjorë e të shoqërive audituese, të përgatitur dhe të propozuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe mbikëqyr zbatimin e standardeve të këtij kodi;
- harton dhe miraton Rregulloren e Kontrollit të Cilësisë dhe manualin përkatës lidhur me kontrollin e cilësisë;
- mbikëqyr procesin e kontrollit të cilësisë dhe zbatimin e dispozitave të rregullores së Kontrollit të Cilësisë;
- mbikëqyr programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të audituesve ligjorë;
- miraton rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore;
- mbikëqyr përmes komisioneve të SM veprimtarinë e Komisioneve të Investigimit të Organizatave Profesionale;
- kur e gjykon të nevojshme, kryen investigime shtesë për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese;
- shqyrton dhe merr vendim për ankesat e bëra nga kandidatët, në lidhje me regjistrimin e tyre;
- miraton dhe publikon programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarisë së tij;
- shqyrton dhe merr vendim për rastet e shkeljeve disiplinore, që janë kompetencë e tij;
- miraton akte të tjera rregullatore, të cilat janë në kompetencën e tij;
- shqyrton dhe merr vendim për aspekte apo çështje të tjera, të parashikuara në këtë ligj, që janë brenda objektit të veprimtarisë së tij;
- miraton statutet e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e tyre.

2.3. Direktiva 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 maj 2006, “Mbi auditimet ligjore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara, ndryshimin e direktivave të Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizimin e direktivës së Këshillit 84/253/KEE”, e ndryshuar

Përkufizimi që bën direktiva për auditimin ligjor është si më poshtë:

“Auditim Ligjor” nënkupton një auditim të pasqyrave vjetore financiare ose pasqyrave financiare të konsoliduara për aq sa:

- (a) e kërkuar nga legjislacioni BE;
- (b) të kërkuara nga ligji kombëtar për ndërmarrjet e vogla;
- (c) të kryera vullnetarisht me kërkesë të ndërmarrjeve të vogla që plotësojnë kërkesat ligjore kombëtare që janë ekuivalente me ato të auditimit të përcaktuar nën pikën (b), kur legjislacioni kombëtar i përcakton këto auditime si auditime ligjore.

“Autoritetet kompetente”¹ nënkupton autoritetet e përcaktuara me ligj që janë përgjegjës për rregullimin dhe / ose mbikëqyrjen e audituesve ligjorë dhe firmave të auditimit ose të aspekteve specifike të tyre; referenca për “autoritetin kompetent” në çdo nen specifik nënkupton autoritetin përgjegjës më sipër për funksionet e përmendura në atë nen.

“Auditues ligjor” nënkupton një person fizik i cili është aprovuar në përputhje me këtë Direktivë nga autoritetet kompetente të një shteti anëtar për të kryer auditime ligjore.

“Njësi me interes publik” do të thotë:

- (a) njësi të qeverisura nga ligji i një shteti anëtar, letrat me vlerë të transferueshme të cilin pranohen të tregtojnë në një treg të rregulluar të çdo shteti anëtar në kuptimin e pikës 14, të nenit 4 (1) të Direktivës 2004/39 / EC;
- (b) institucionet e kreditit siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 3 (1) të Direktivës 2013/36 / BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, përveç atyre të përmendura në nenin 2 të kësaj direktive;
- (c) ndërmarrjet e sigurimeve në kuptimin e nenit 2 (1) të Direktivës 91/674 / EEC; ose
- (d) subjektet e përcaktuara nga shtetet anëtare si entitete me interes publik, për shembull ndërmarrje që kanë një rëndësi publike për shkak të natyrës së biznesit të tyre, madhësisë së tyre ose numrit të punonjësve të tyre.

Shtetet anëtare duhet të organizojnë një sistem efektiv të mbikëqyrjes publike për audituesit ligjorë dhe firmat e auditimit bazuar në parimet e përcaktuara në paragrafët 2 deri në 7 të direktivës dhe duhet të **caktojnë një autoritet kompetent përgjegjës për këtë mbikëqyrje**.

Të gjithë audituesit ligjorë dhe firmat e kontrollit i nënshtrohen mbikëqyrjes publike.

¹ Në legjislacionet e vendeve të BE-së dhe në ligjin 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar, autoriteti kompetent i referohet Bordit të Mbikëqyrjes Publike përkatës.

Autoriteti kompetent drejtohet nga jo-praktikantë që kanë njohuri në fushat e rëndësishme për auditimin ligjor. Ata do të zgjidhen në përputhje me një procedurë të pavarur dhe transparente të emërimit.

Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të financohet në atë mënyrë që të jetë e duhur dhe të ketë burime të përshtatshme për të filluar dhe kryer hetime, siç përmendet në paragrafin 5 të direktivës, ku kërkohet që këto aktivitete të realizohen përmes inspektorëve që kanë edukimin profesional të përshtatshëm, eksperiencë të rëndësishme në auditimet ligjore dhe raportim financiar, të kombinuara me trajnime në rishikimet e kontrollit të cilësisë së auditimeve ligjore, si dhe të mos jenë praktikues.

Autoriteti kompetent ka përgjegjësinë përfundimtare për mbikëqyrjen e:

- (a) miratimin dhe regjistrimin e audituesve ligjorë dhe firmave të auditimit;
- (b) miratimin e standardeve për etikën profesionale, kontrollin e brendshëm të cilësisë së firmave të auditimit dhe auditimin, përveç kur ato standarde janë miratuar ose aprovuar nga autoritetet e tjera të shtetit anëtar;
- (c) edukimin e vazhdueshëm;
- (d) sistemet e sigurimit të cilësisë;
- (e) sistemet disiplinore hetimore dhe administrative.

Autoriteti kompetent ka të drejtë, kurdoherë është e nevojshme, të fillojë dhe të kryejë hetime në lidhje me audituesit ligjorë dhe firmat e auditimit dhe të drejtën për të ndërmarrë veprime të përshtatshme.

Shtetet anëtare sigurojnë që, gjatë kryerjes së një auditimi ligjor, një auditues ligjor ose një firmë auditimi dhe çdo person fizik në gjendje të ndikojë drejtpërdrejt ose indirekt në rezultatin e auditimit ligjor, është i pavarur nga entiteti i audituar dhe nuk është i përfshirë në vendimmarrjen e subjektit të audituar. Gjithashtu, sistemi i sigurimit të cilësisë do të organizohet në atë mënyrë që të jetë i pavarur.

2.4. Kërkesat brenda Bashkimit Evropian mbi kontrollin e cilësisë - Rregullorja 537 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Bashkimit Evropian

Ligji 10091/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, reflekton kërkesat e kësaj rregulloreje, ndër të cilat vlen të përmenden disa dispozita kyçe si në vijim.

Audituesve ligjorë dhe firmave të auditimit u është besuar me ligj të kryejnë auditimet ligjore të njësisve ekonomike me interes publik me qëllim rritjen e shkallës së besimit që ka publiku

tek pasqyrat financiare vjetore dhe të konsoliduara të njësive ekonomike të tilla. Funkzioni i interesit publik i auditimit ligjor do të thotë se të cilësia e punës së audituesit ligjor ose firmës së auditimit mbështetet një komunitet i gjerë njerëzish dhe institucionesh. Një cilësi e mirë e auditimit kontribuon në funksionimin e rregullt të tregjeve përmes rritjes së paprekshmërisë dhe efikasitetit të pasqyrave financiare. Kështu, audituesit ligjorë përmbushin një rol me rëndësi sidomos për shoqërinë.

Është e rëndësishme të vendosen rregulla të hollësishme me qëllim që të sigurohet që auditimet ligjore të njësive ekonomike me interes publik të jenë të në cilësinë e duhur dhe të kryhen nga auditues ligjorë dhe firma auditimi që u nënshtrohen kërkesave të rrepta. Një qasje e përbashkët rregullatore do të duhej ta përmirësonte pacenueshmërinë, pavarësinë, objektivitetin, përgjegjësinë, transparencën dhe besueshmërinë e audituesve ligjorë dhe firmave të auditimit, që kryejnë auditimet ligjore të njësive ekonomike me interes publik, duke kontribuar në cilësinë e auditimeve ligjore në Bashkimin Evropian, pra duke kontribuar në funksionimin pa probleme të tregut të brendshëm, duke arritur në të njëjtën kohë një nivel më të lartë të mbrojtjes së konsumatorëve dhe investitorëve. Përgatitja e një akti më vete për njësitë ekonomike me interes publik, do të siguronte gjithashtu një harmonizim të njëjtë dhe zbatim të njëtrajtshëm të rregullave dhe do të kontribuonte kështu në një funksionim më të efektshëm të tregut të brendshëm. Këto kërkesa të rrepta është mirë të jenë të zbatueshme për audituesit ligjorë dhe firmat e auditimit vetëm për atë sa këta kryejnë auditimet ligjore të njësive ekonomike me interes publik.

Ofrimi i disa shërbimeve të caktuara që nuk janë auditim ligjor (shërbime jo auditim) njësive ekonomike të audituara nga audituesit ligjorë, firmat e auditimit ose anëtarët e rrjeteve të tyre, mund ta vënë në rrezik pavarësinë e tyre. Prandaj, është e përshtatshme të ndalohet ofrimi i disa shërbimeve të caktuara jo auditim siç janë shërbimet fiskale, të konsulencës ose këshillimit për njësinë ekonomike të audituar, ndërmarrjes mëmë të saj dhe ndërmarrjet e kontrolluara të saj brenda Bashkimit Evropian. Shërbimet që kërkojnë luajtjen e çfarëdo roli në administrimin ose vendimmarrjen e njësisë ekonomike të audituar mund të përfshijnë drejtimin e kapitalit qarkullues, sigurimin e informacioneve financiare, optimizmin e proceseve të punës, drejtimin e mjeteve monetare, transferimin e çmimit, krijimin e efikasitetit të zinxhirit të furnizimit dhe të tjera të ngjashme me këto. Shërbimet e lidhura me financimin, strukturën dhe shpërndarjen e kapitalit dhe strategjinë e investimeve të njësisë ekonomike të audituara është mirë të ndalohen, me përjashtim të dhënies së shërbimeve të tilla si shërbimet e vlerësimit të korrektesës së raportimit dhe të tjera të përcaktuara në këtë rregullore.

Është mirë që t'u jepet mundësia Shteteve Anëtare të vendosin t'u lejojnë audituesve ligjorë dhe firmave të auditimit të ofrojnë shërbime të caktuara fiskale dhe vlerësuese, kur këto shërbime nuk kanë rëndësi materiale ose nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë, veçmas ose së bashku, në pasqyrat financiare të audituara. Kur këto shërbime përfshijnë një planifikim fiskal agresiv, është mirë që të mos konsiderohen si pa rëndësi materiale. Në këtë kuptim, është mirë që audituesi ligjor ose firma e auditimit të mos i ofrojë këto shërbime njësive ekonomike të audituar. Është mirë që audituesi ligjor ose firma e auditimit të ketë mundësinë të ofrojë

shërbimet jo auditim që nuk ndalohen sipas kësaj rregulloreje, nëse ofrimi i këtyre shërbimeve është aprovuar paraprakisht nga komiteti i auditimit dhe nëse audituesi ligjor ose firma e auditimit bindet se ofrimi i këtyre shërbimeve nuk përbën rrezik për pavarësinë e audituesit ligjor ose të firmës së auditimit i cili nuk mund të zvogëlohet në një nivel të pranueshëm përmes përdorimit të masave mbrojtëse.

Niveli i tarifave që merren nga një njësi ekonomike e audituar dhe struktura e tarifave mund të vënë në rrezik pavarësinë e audituesit ligjor ose të firmës së auditimit. Prandaj, është e rëndësishme të sigurohet që tarifat e auditimit të mos bazohen në asnjë formë kushtëzimi dhe që, kur tarifat e auditimit nga një klient i vetëm përfshirë edhe filialet e tij janë në nivel të konsiderueshëm, të parashikohet një procedurë e veçantë që përfshin komitetin e auditimit, për të siguruar kështu cilësinë e auditimit. Nëse audituesi ligjor ose firma e auditimit bëhen tejet të varur nga një klient i vetëm, është mirë që komiteti i auditimit të vendosë në bazë të një arsytimi të duhur nëse audituesi ligjor apo firma e auditimit mund ose jo të vijojnë auditimin ligjor. Gjatë marrjes së këtij vendimi, komiteti i auditimit është mirë të marrë në konsideratë, ndër të tjera, rreziqet që i kanosen pavarësisë dhe pasojat që ka një vendim i tillë.

Me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, ka rëndësi që audituesi ligjor ose firma e auditimit, përpara pranimit ose vijimit të një angazhimi për auditim ligjor të një njësie ekonomike me interes publik, të vlerësojë nëse përmbushen kërkesat për pavarësinë dhe në veçanti nëse lind ndonjë rrezik për pavarësinë si pasojë e marrëdhënies me njësinë ekonomike në fjalë. Audituesi ligjor ose firma e auditimit do të duhej ta konfirmonte pavarësinë e vet çdo vit përpara komitetit të auditimit të njësisë ekonomike të audituar dhe do të duhej të diskutonte me këtë komitet për çdo rrezik që i kanoset pavarësisë, si edhe për masat mbrojtëse të përdorura për t'i zbutur këto rreziqe.

Një *shqyrtim i shëndoshë i kontrollit të cilësisë* së angazhimit për punën e kryer në çdo angazhim auditimi ligjor do ta ndihmonte rritjen e cilësisë së auditimit. Prandaj, audituesi ligjor ose firma e auditimit është mirë të mos e nxjerrë raportin e auditimit pa përfunduar ende rishikimi i kontrollit të cilësisë së angazhimit.

Rezultatet e auditimit ligjor të njësisë ekonomike me interes publik është mirë t'u prezantohen palëve të interesuara në raportin e auditimit. Për ta rritur besimin e palëve të interesuara tek pasqyrat financiare të subjektit të audituar është sidomos e rëndësishme që raporti i auditimit të jetë i bazuar dhe i mbështetur në mënyrë solide me fakte. Krahas informacionit që kërkohet të jepet sipas nenit 28 të Direktivës 2006/43/KE është mirë që raporti i auditimit të përfshijë në veçanti informacion të mjaftueshëm për pavarësinë e audituesit ligjor ose firmës së auditimit dhe nëse auditimi ligjor është konsideruar i aftë ose jo për të zbuluar parregullsi, përfshirë edhe mashtrimet.

Për të siguruar një nivel të lartë besimi të investitorëve dhe konsumatorëve në tregun e brendshëm përmes shmangies së konfliktit të interesit, audituesit ligjorë dhe firmat e auditimit është mirë t'i nënshtrohen kontrollit mbikëqyrës së cilësisë nga autoritetet kompetente të

pavarura nga profesioni i auditimit, të cilat kanë kapacitetin, njohuritë në nivel eksperti dhe burimet e mjaftueshme.

Autoritetet kompetente kombëtare rekomandohet të kenë kompetencat e nevojshme për të kryer detyrat e tyre mbikëqyrëse, përfshirë kapacitetin për të parë të dhëna, për të marrë informacione dhe për të kryer inspektive. Është mirë që ato të specializohen në mbikëqyrjen e tregjeve financiare, në përmbushjen e detyrimeve të raportimit financiar ose në kontrollin mbikëqyrës të auditimit ligjor. Por, është mirë të jetë mundësia që mbikëqyrja e përmbushjes së detyrimeve të vendosura mbi njësitë ekonomike me interes publik të bëhet nga autoritetet kompetente përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtyre njësive ekonomike.

Kontrolli i jashtëm i cilësisë së auditimit ligjor është themelor për një auditim të cilësisë së lartë. Kjo ua rrit besueshmërinë informacioneve financiare të publikuara dhe ofron një mbrojtje më të mirë për aksionarët, investitorët, kreditorët dhe palët e tjera të interesuara. Prandaj, është mirë që audituesit ligjorë dhe firmat e auditimit të ishin objekt i një sistemi të kontrollit të cilësisë nën përgjegjësinë e autoriteteve kompetente, duke siguruar kështu objektivitet dhe pavarësi nga profesioni i auditimit. Shqyrtimet e kontrollit të cilësisë është mirë të organizohen në atë mënyrë që çdo auditues ligjor ose çdo firmë auditimi që kryen auditime të njësive ekonomike me interes publik të ishte objekt i një shqyrtimi të kontrollit të cilësisë në bazë të një analize të risqeve. Në rastin e audituesve ligjorë dhe firmave të auditimit që kryejnë auditime të njësive ekonomike me interes publik, por që nuk përfshihen në ato të përkufizuara në nenin 2, nën-pika 17 dhe 18, të Direktivës 2006/43/KE, *ky shqyrtim do të duhej të bëhej të paktën çdo tre vjet dhe, në raste të tjera, të paktën çdo gjashtë vjet.*

3. Shërbimet e auditimit, kontabilitetit dhe rregullimi i profesionit kontabël

Profesioni kontabël përfshin profesionin e kontabilistit të miratuar dhe profesionin e audituesit ligjor, të cilët ushtrojnë profesionin sipas përcaktimeve të dispozitave të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Në mbështetje të këtij ligji, **Audituesi Ligjor** (*Ekspert Kontabël i Regjistruar, emërtimi para ndryshimeve me ligjin 47/2016*) është individ i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore, si dhe i regjistruar në *regjistrin publik të audituesve ligjorë* dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Kontabilist i miratuar është personi fizik, profesionist i lirë, i regjistruar në regjistrin e njëjës prej organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, që kontraktohet nga personi juridik, për të kryer shërbime të kontabilitetit. Ai mund të kryejë edhe shërbime të tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Regjistri publik i audituesve ligjorë është regjistri i audituesve ligjorë, audituesve ligjorë të huaj dhe shoqërive të auditimit, vendase e të huaja, të cilat autorizohen të angazhohen në auditimin ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe të konsoliduara të entiteteve që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. Organizata profesionale e audituesve ligjorë (IEKA) është struktura përgjegjëse që siguron mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, si dhe identifikimin e audituesit ligjor dhe të shoqërisë audituese në regjistrin publik, me një numër individual.

Regjistri publik i organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar është regjistri që duhet të mbajë çdo organizatë profesionale e njohur nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, në të cilën bëhet identifikimi i kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit, të cilët janë anëtarë të organizatës profesionale përkatëse, të njohur për të kryer shërbime kontabiliteti apo shërbime të tjera të parashikuara në ligjin 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar. Profesionin e kontabilistit të miratuar, nga personat që kanë kaluar provimin e aftësisë profesionale, ushtrohet vetëm pas anëtarësimit të tyre në një organizatë profesionale të kontabilistëve të miratuar, të njohur nga bordi, e cila angazhohet për ndjekjen e standardeve profesionale, cilësisht të larta dhe për zbatimin e një kodi etike që është në pajtim me kodin e etikës së IFAC-së. Organizmat profesionale të kontabilistëve të miratuar mbajnë dhe publikojnë regjistrin e anëtarëve, i cili ndahet në katër seksionet e mëposhtme: a) anëtarë, persona fizikë aktivë; b) anëtarë, persona fizikë joaktivë; c) kandidatë; ç) shoqëri të kontabilistëve të miratuar.

Në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, profesionistët që kanë të drejtë të ofrojnë **shërbime të auditimit ligjor** qofshin ato si rrjedhojë e kërkesave ligjore, por edhe në mënyrë vullnetare, janë Audituesit Ligjorë të cilët janë certifikuar nga Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale pranë Bordit të Mbikëqyrjes

Publike (ose Autoriteti i Certifikimit përpara ndryshimeve ligjore me ligjin 47/2016) dhe të regjistruar në regjistrin publik nga Komiteti i Regjistrimit pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

Gjithashtu, disa shërbime të tjera që ofrohen nga audituesit ligjorë, krahas *shërbimit të auditimit ligjor*, mund të jenë edhe *shërbimet e kontabilitetit*, *shërbimet e rishikimit e të dhënies së sigurisë* ose *shërbime të tjera*, sipas përcaktimeve të bëra për to në standardet dhe deklaratat e IAASB-së, kur ato janë në pajtim me natyrën e profesionit dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në të gjitha këto raste duhet të zbatohen dispozitat e këtij ligji për ruajtjen e pavarësisë dhe shmangien e konfliktit të interesit.

Vlen të theksohet se *shërbimet e kontabilitetit* të specifikuara në paragrafin më sipër, përveç audituesve ligjorë, kryhen edhe nga kontabilistët e miratuar.

Shërbimet e kontabilitetit përfshijnë:

- shërbimet e mbajtjes dhe përgatitjes së librave kontabël;
- shërbimet e mbajtjes dhe përgatitjes së librave fiskalë;
- shërbimet e mbajtjes dhe përgatitjes së pagave;
- shërbimet e mbajtjes dhe përgatitjes së kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit kontabël;
- vlerësimet dhe analizat e kostos dhe kontabilitetit të drejtimit;
- vlerësimin dhe zbatimin e procedurave kontabël të përgatitjes së pasqyrave financiare;
- analiza financiare dhe këshillime përkatëse;
- si dhe shërbime të tjera të ngjashme.

Në mbështetje të dispozitave të ligjit 10091/2009, të gjitha shërbimet e kontabilitetit mund të kryhen vetëm nga kontabilistët e miratuar dhe audituesit ligjorë, me kushtin që të mos kenë konflikt interesi dhe shërbimet e tyre të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e kodit të etikës së Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC).

Për më tepër, në mbështetje të dispozitave të ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, edhe *shërbimi i hartimit të pasqyrave financiare*, përveç rasteve kur personi fizik apo juridik ka një person të punësuar, ofrohet nga personi fizik i licencuar si *kontabilist i miratuar* apo *auditues ligjor*, si dhe personi juridik i organizuar si *shoqëri auditimi* apo *shoqëri kontabiliteti*, që ofron shërbimin e kontabilitetit, sipas kontratës së punës apo kontratës së shërbimit që ka me njësinë ekonomike dhe mban përgjegjësinë për hartimin e pasqyrave financiare.

Të gjitha institucionet apo subjektet private, të cilat angazhojnë ekspertë të jashtëm për të ofruar shërbimet e përshkruara më sipër, në mbështetje të dispozitave ligjore, duhet të konsiderojnë respektivisht profesionet e audituesit ligjorë lidhur me *shërbimet e auditimit ligjor*, *shërbimet*

e kontabilitetit, shërbimet e rishikimit e të dhënies së sigurisë ose shërbime të tjera, sipas përcaktimeve të bëra për to në standardet dhe deklaratat e IAASB-së, shërbimet e hartimit të pasqyrave financiare si dhe kontabilistët e miratuar lidhur me shërbimet e kontabilitetit dhe shërbimet e hartimit të pasqyrave financiare.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, ka si qëllim që, përmes sistemit të mbikëqyrjes publike të shërbimeve të këtyre profesionistëve, të rrisë sigurinë që këto shërbime të kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik. Për sa më sipër, BMP shpreh gatishmërinë për të mbështetur të gjitha institucionet publike në kryerjen e veprimtarisë së tyre lidhur me vënien në dispozicion të çdo informacioni të parashikuar nga legjislati në fuqi që kontribuon në mbrojtjen e interesit të publikut.

4. Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2020

4.1. Akte rregullatore të reja e të ndryshuara

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, gjatë vitit 2020, në funksion të përforsimit të integritetit të institucionit, por edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse, ndërmoi një sërë hapash si në drejtim të miratimit të rregulloreve të reja, ashtu edhe të ndryshimit të atyre ekzistuese. Kështu, u miratuan dhe u ndryshuan aktet rregullatore si më poshtë:

4.1.1 Statuti i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i ndryshuar

Statuti i Bordit të Mbikëqyrjes Publike është dokumenti themeltar ku përcaktohen parimet bazë të organizimit dhe administrimit të aktiviteteve të këtij institucioni. Në Statut paraqiten dispozitat e përgjithshme, misioni, organizimi, drejtimi dhe administrimi i bordit, veprimtaria ekzekutive, menaxhimi financiar dhe dispozitat përfundimtare. Që në hyrje të tij ritheksohet fakti i vendosur në ligjin e auditimit ku BMP është një autoritet rregullator i pavarur, si dhe ka të mirë përcaktuar edhe organet përkatëse për realizimin e misionit të Bordit dhe arritjen e objektivave si organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës.

Me Vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike Nr. 63, datë 04.08.2020, me qëllim harmonizimin dhe përputhshmërinë e statutit me Rregulloren Nr. 5, datë 29.03.2018 *“Për organizimin dhe funksionimin e strukturës mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”*, pas konsultimit edhe me Komisionin Ligjor të ngritur pranë BMP-së, u miratuan disa shtesa, përmirësime dhe riformulime në këtë statut. Këto ndryshime, më specifikisht, konsistuan në:

- Harmonizimin e kuadrit rregullator;
- Përcaktimin dhe qartësimin e rolit dhe disa detyrave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe Drejtorit Ekzekutiv;
- Përcaktimin mbi shumicën për marrjen e vendimeve nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

4.1.2 Rregullorja nr. 2, datë 22.02.2018 *“Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar”*, e ndryshuar dhe Rregullorja nr. 6, datë 31.05.2018 *“Për procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale të kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist i Miratuar”*, e ndryshuar

Në kuadër të përmirësimit të procesit të funksionimit të veprimtarisë së Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe vlerësimit të kandidatëve për titullin KM dhe AL, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, i mbështetur dhe nga Banka Botërore përmes angazhimit të një eksperti ndërkombëtar, bëri një diagnostikim të gjithë veprimtarisë së KPAP-së dhe kuadrit rregullator. Ky raport diagnostikimi u përdor si pikënisje për ngritjen e një grupi pune duke përfshirë organizatat profesionale dhe anëtarësinë e tyre, si dhe përfaqësues nga institucionet

shtetërore si Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për të hartuar ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e procesit të provimeve dhe solli si rezultat ndryshimin e Rregullores nr. 2, datë 22.02.2018 “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar” dhe Rregullores nr. 6, datë 31.05.2018 “Për procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale të kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist i Miratuar”.

Ndryshimet thelbësore konsistuan në:

- Rolin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP) dhe shpalljen e rezultateve;
- Rolin e Komisionit të Rishikimit;
- Procesin e hartimit të tezës përmes rishikimit të cilësisë së saj;
- Rolin e grupit të tretë të korrigjuesve për të gjitha fletoret me diferencë mbi 5 % të pikëve;
- Rastet e situatave të jashtëzakonshme.

4.1.3 Rregullorja nr. 5, datë 29.03.2018 “Për Organizimin dhe funksionimin e strukturës mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, e ndryshuar

Kjo rregullore është përgatitur në përputhje me ligjin për auditimin dhe parashikon organigramën e strukturës mbështetëse dhe mënyrën e funksionimit të saj. Rregullorja është miratuar me vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike Nr. 3, datë 29.03.2018 dhe në të parashikohet mënyra e organizimit dhe funksionimit të strukturës mbështetëse, përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat e stafit sipas pozicioneve përkatëse të punës. Në këtë rregullore janë të mirë përcaktuara ndarjet e detyrave, realizimi i çdo procesi pune, si dhe raportimi në nivel hierarkik.

Më datë 04.08.2020, me vendimin Nr. 62 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, me qëllim harmonizimin dhe përputhshmërinë e kësaj rregulloreje me përcaktimet e Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, si dhe me aktet e tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e BMP-së, pas konsultimit edhe me Komisionin Ligjor të ngritur pranë BMP-së, u miratuan disa shtesa, përmirësime dhe riformulime në këtë rregullore. Këto ndryshime, më specifikisht, konsistuan në:

- Përcaktimin mbi organikën e strukturës mbështetëse sa i përket personelit të përhershëm, i cili do të jetë në përputhje me Vendimin Nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”;

- Përcaktimin dhe qartësimin e rolit dhe disa detyrave të Drejtorit Ekzekutiv dhe harmonizimin me statutin dhe VKM Nr. 786, datë 09.11.2016;
- Përcaktimin e mandatit të Drejtorit Ekzekutiv, të emëruar me Vendimin Nr. 7, datë 27.03.2019.

4.1.4 Rregullorja nr. 10, datë 11.06.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Regjistrimit dhe përditësimin e regjistrit publik”, e ndryshuar

Kjo rregullore, miratuar për herë të parë me vendimin Nr. 24, datë 11.06.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, parashikon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komitetit të Regjistrimit, procedurat e regjistrimit dhe të çregjistrimit nga regjistri publik i audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese vendase dhe të huaja, procedurat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë për pasqyrimin e ndryshimeve në regjistrin publik dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit. Kjo rregullore është mjaft e rëndësishme në veprimtarinë e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, pasi pasqyrimi i tyre në regjistrin publik është elementi kryesor që u mundëson audituesve të ushtrojnë veprimtarinë e vet, sipas dispozitave të parashikuara nga ligji 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar. Në këtë rregullore specifikohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe procesi i verifikimit të tij, si element thelbësor, përpara se Komiteti i Regjistrimit (ngritur pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë) të miratojë ose jo, kërkesën e subjektit për të ushtruar profesionin.

Më datë 28.05.2020, me Vendimin Nr. 31 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, u miratuan ndryshimet në këtë rregullore, të cilat kryesisht konsistuan në shtesa/përmirësime në:

- bazën ligjore të rregullores;
- objektin e rregullores;
- dokumentacionin që duhet të paraqitet nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese për tu regjistruar në Regjistrin Publik;
- rastet kur mund të kryhet pezullimi i audituesit ligjor;
- rastet e fillimit të një procesi investigimi.

4.1.5 Rregullorja nr. 12, datë 02.07.2020 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”

Rregullorja nr. 12 dhe udhëzuesi për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit është hartuar bazuar në nenin 3 dhe nenin 5, të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, nenin 24, pika 2 të Ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit”, i ndryshuar, pika 1, germa ë, pika 2 e VKM Nr. 343, datë 08.04.2009 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse”, i ndryshuar, si dhe nenin 7 të Ligjit Nr. 157/2013 “Për masat

e marra kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar. Kjo rregullore, së bashku me manualin dhe udhëzuesin, është bërë në kuadër të zbatimit të kërkesave të ardhura nga FATF dhe grupi ndërinstytucional për zbatimin e rekomandimeve të FATF.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike miratoi këtë rregullore me Vendimin Nr. 41, datë 02.07.2020.

Rregullorja nr. 12 dhe udhëzuesi ka për qëllim përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për identifikimin e klientit, regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e tyre tek autoriteti përgjegjës dhe parandalimin e përdorimit të subjekteve për pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.

4.2. Funksionimi i komisioneve të ngritura pranë BMP

4.2.1. Komisioni Ad-Hoc “Për Verifikimin e Kontabilistëve të Miratuar”

Komisioni Ad-Hoc “Për verifikimin e Kontabilistëve të Miratuar” është krijuar në zbatim të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në mbështetje të Rregullores Nr. 9, datë 27.02.2019 “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të organizatave profesionale dhe profesionit të Kontabilistit të Miratuar” dhe vendimit Nr. 21, datë 03.06.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike “Për komisionin dhe procedurat e verifikimit të Kontabilistëve të Miratuar”. Komisioni Ad- Hoc ka filluar ushtrimin e aktivitetit të tij në datën 31 Korrik 2019.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, si një institucion i pavarur me një rol të veçantë në mbrojtjen e interesave publike, me anë të krijimit dhe funksionimit të Komisionit Ad-Hoc, gjatë kësaj periudhe zhvilloi procesin e verifikimit të zbatimit të dispozitave ligjore për çdo subjekt mbajtës të titullit “Kontabilist i Miratuar” (aktiv ose jo-aktiv). Procesi i verifikimit të Kontabilistëve të Miratuar do të bëjë të mundur formalizimin e të gjithë zotëruesve të titullit, duke garantuar zbatimin e dispozitave ligjore, në lidhje me detyrimet që përfshijnë zbatimin e standardeve etike dhe kërkesave të tjera në zbatim të akteve ligjore.

Finalizimi i këtij procesi është krijimi, hartimi dhe publikimi i regjistrave publikë të kontabilistëve të miratuar, i cili do të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga të gjitha palët e interesuara, duke garantuar ndër të tjera që shërbimi i kontabilistëve të miratuar të mos ofrohet nga individë apo subjekte të tjerë të pa licencuar, apo që konkurrojnë në mënyrë të padrejtë me ushtruesit e rregullt të profesionit.

Qëllimi i procesit është verifikimi i të gjithë subjekteve që kanë fituar titullin Kontabilist i Miratuar në lidhje me rregullsinë e dokumentacionit ligjor, regjistrimit në Organizatë Profesionale pas marrjes së titullit KM, marrëdhëniet e punës, angazhimi përgjatë 5 viteve të fundit, pajtueshmërinë me dispozitat ligjore në fuqi, kryerjen e edukimit të vijueshëm, si dhe verifikimin e dosjes personale të lidhura me çështjet gjyqësore dhe dëshmisë së penalitetit Ky

komision ka si qëllim monitorimin e zbatimit dhe pajtueshmërisë ligjore të kuadrit rregullator, si dhe ndjekjen e veprimtarisë së OP të KM, monitorimin e kryerjes së kurseve profesionale dhe ndjekjen e orëve të CPD nga KM.

Realizimi i këtij qëllimi ka vijuar edhe me ngritjen e Komisionit “Për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Qeverisjes së Organizatave dhe Anëtarësisë së tyre”, me Vendimin Nr. 59, datë 04.08.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, komisioni i cili u konstitua në datën 16 shtator 2020. Ky komision u ngrit me ndërprerjen e funksionimit të Komisionit Ad-Hoc, si dhe përfundimit të fazës fillestare të procesit të verifikimit dhe aktualisht po vijon procesin e verifikimit të KM-ve, si dhe monitorimin e organizatave profesionale të KM-ve. Procesi i verifikimit përfshin gjithashtu çështje të cilat bien ndesh me Kodin e Etikës për ushtrimin e profesionit apo me legjislacionin në fuqi dhe verifikimi i kryqëzuar me informacionet e publikuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit i të gjithë subjekteve, si dhe verifikimi i saktësisë së dokumentacionit të dorëzuar.

Objektivat

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë Komisionet kanë përcaktuar objektivat e mëposhtme:

- Rregullimi i profesionit të Kontabilistit të Miratuar dhe mbikëqyrja e ushtrimit të profesionit të tij nëpërmjet realizimit të vlerësimit të pajtueshmërisë ligjore të Kontabilistëve të Miratuar, për të cilët dëshmohet se kanë përmbushur kriteret ligjore;
- Monitorimi i kryerjes së edukimit të vijueshëm të kontabilistëve të miratuar që ushtrojnë profesionin si dhe atyre profesionistëve që kanë fituar titullin kontabilist i miratuar, të cilët nuk janë ushtrues të profesionit së bashku me procedurat e regjistrimit në regjistrin përkatës;
- Verifikimi i kontabilistëve të miratuar aktivë dhe kontabilistëve të miratuar Jo-aktivë, deri në finalizimin e këtij procesi.
- Me ngritjen e Komisionit “Për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Qeverisjes së Organizatave dhe Anëtarësisë së tyre” objektivisht edhe marrja e masave për monitorimin e proceseve të brendshme që kryejnë OP

Vendimmarrja dhe raportimi i komisionit Ad-Hoc

Ky komision ka realizuar veprimtarinë e tij gjatë periudhës Korrik 2019 deri në Gusht 2020.

Gjatë vitit 2020, Komisioni ka konkluduar me vendimin si më poshtë:

- **Vendim Nr. 5 rekomandim për Bordin e Mbikëqyrjes Publike** “Për monitorimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të testimit sipas moduleve përkatëse profesionale të detyrueshme për kontabilistët e miratuar që nuk kanë përmbushur detyrimin e edukimit të vijueshëm profesional për periudhën 2014-2019”.

Në përputhje me vendimin datë 03.06.2019 “Për komisionin dhe procedurat e verifikimit të kontabilistëve të miratuar”, Komisioni Ad-Hoc ka përcjellë pranë BMP-së, gjatë vitit 2020, raportet mbi ecurinë e procesit si më poshtë:

- **Raporti Nr. 6** i përgatitur nga komisioni Ad-Hoc mbi ecurinë e procesit të verifikimit të Kontabilistëve të Miratuar për periudhën 06.01.2020 – 31.01.2020.

Në këtë periudhë komisioni Ad-Hoc ka realizuar shqyrtimin e 32 dosjeve, ka intervistuar 44 subjekte KM, si dhe ka verifikuar 42 dosje sipas tabelës së mëposhtme:

Dosje të analizuar	KM të intervistuar	Subjekte të verifikuara
32	44	42

- **Raporti Nr. 7** i përgatitur nga komisioni Ad-Hoc mbi ecurinë e procesit të verifikimit të kontabilistëve të miratuar për periudhën 01.02.2020 - 29.02.2020.

Në këtë periudhë komisioni Ad-Hoc ka realizuar shqyrtimin e 25 dosjeve, ka intervistuar 58 subjekte KM, si dhe ka verifikuar 52 dosje sipas tabelës së mëposhtme:

Dosje të analizuar	KM të intervistuar	Subjekte të verifikuara
25	58	52

- **Raporti Nr. 8** i përgatitur nga komisioni Ad-Hoc mbi ecurinë e procesit të verifikimit të kontabilistëve të miratuar për periudhën nga 01.03.2020 - 30.04.2020.

Në këtë periudhë komisioni Ad-Hoc ka realizuar shqyrtimin e 30 dosjeve, ka intervistuar 20 subjekte KM, si dhe ka verifikuar 78 dosje sipas tabelës së mëposhtme:

Dosje të analizuar	KM të intervistuar	Subjekte të verifikuara
30	20* ²	78

² Numri i reduktuar i intervistave për shkak të gjendjes së pandemisë botërore të shkaktuar nga COVID -19.

- **Raporti Nr. 9** i përgatitur nga komisioni Ad-Hoc mbi ecurinë e procesit të verifikimit të kontabilistëve të miratuar për periudhën nga 01.05.2020 - 30.06.2020.

Në këtë periudhë komisioni Ad-Hoc ka realizuar shqyrtimin e 48 dosjeve, ka intervistuar 104 subjekte KM, si dhe ka verifikuar 154 dosje sipas tabelës së mëposhtme:

Dosje të analizuara	KM të intervistuar	Subjekte të verifikuara
48	104	154

Raporti Përmbledhës mbi veprimtarinë e komisionit Ad-Hoc, i cili ka paraqitur të gjithë veprimtarinë e komisionit për periudhën gusht 2019 - gusht 2020.

Raportim përmbledhës mbi ecurinë e procesit në vitin 2020

Komisioni Ad-Hoc ka zhvilluar veprimtarinë deri në datën 24.08.2020. Veprimtaria e komisionit Ad-Hoc ka konsistuar në shqyrtimin, analizimin dhe diskutimin mbi çdo dosje të kontabilistëve të miratuar. Paralelisht nga sa më lart, komisioni ka kërkuar në mënyrë të pavarur edhe informacion shtesë mbi çdo KM për të bërë një verifikim sa më të plotë të çdo dosjeje. Në rastet e evidentimit të mungesës së dokumentacionit dhe informacionit në dosje është komunikuar në mënyrë elektronike dhe telefonike me secilin KM për plotësimin e të metave. Një pjesë e rëndësishme e procesit kanë qenë edhe seancat e intervistave të subjekteve kontabël i miratuar. Secili subjekt është kontaktuar fillimisht me email nga ana e komisionit Ad-Hoc për caktimin e datës së intervistës, më tej është kontaktuar në mënyrë telefonike për caktimin e orarit të përshtatshëm për të. Nëpërmjet analizimit paraprak të secilës dosje dhe intervistave, komisioni Ad-Hoc ka konkluduar me vendimmarrje për çdo subjekt të verifikuar.

Komunikimi i vazhdueshëm në mënyrë elektronike dhe telefonike me subjektet në lidhje me informacionin e përgjithshëm dhe ndërgjegjësimin për procesin e verifikimit ka zënë një pjesë të konsiderueshme të kësaj veprimtarie.

Për subjektet kontabilist të miratuar të cilët i janë nënshtruar procesit të verifikimit dhe janë nxjerrë konkluzionet përkatëse gjatë muajit janar - qershor 2020, jepen të dhënat si më poshtë:

Nr	Muaji	Dosje të analizuara	Intervista të zhvilluara
1	Janar	32	44
2	Shkurt	25	58
3	Mars/Prill ³	30	20
4	Maj/Qershor	48	104
	Totali	135	226

Verifikimi i dokumentacionit të subjekteve KM

Referuar pikës 10, të nenit 12, të Rregullores nr. 9, datë 27.02.2019 “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të organizatave profesionale dhe profesionit të kontabilistit të miratuar”, dokumentacioni që paraqitën subjektet e vlerësimit paraqitet si më poshtë:

1. Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
2. Dëshmi penaliteti;
3. Certifikata e titullit KM;
4. Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (certifikatë NIPT);
5. Vërtetim nga OP përkatëse:
 - i. për rezultatet e kontrollit të cilësisë realizuar nga OP përkatëse (në rastet kur janë kryer);
 - ii. nëse janë marrë masa disiplinore ose jo nga OP përkatëse;
 - iii. për kryerjen me sukses të kualifikimit të vijueshëm për 5-vitet e fundit;
6. Vërtetim nga sigurimet shoqërore për marrëdhëniet e punësimit, për 5 vitet e fundit. Në rast se individit ka qenë jashtë vendit, si dokument vërtetimi shërbejnë kontratat dhe certifikatat e punësimit (fotokopje të noterizuara);
7. Vetë deklaram që dokumentet e paraqitura dhe të dhënat e deklaruara janë të sakta;

³ Numri i reduktuar i intervistave për shkak të gjendjes së pandemisë botërore të shkaktuar nga COVID -19.

8. Dokumente shpresë në lidhje me çështje të lidhura me parandalimin dhe pastrimin e parave, çështje të evazionit fiskal, si dhe çdo dokument tjetër bazuar në informacione të marra nga jashtë;
9. Të tjera të përcaktuara me vendim të BMP-së, në përputhje me kuadrin rregullator.

Komisioni Ad-Hoc, në kuadër të procesit të verifikimit të dokumentacionit të kontabilistëve të miratuar, ka hartuar dhe miratuar një formular për secilin KM, i cili është i ndarë në tre seksione:

- **Seksioni i parë:** Të dhënat identifikuese për çdo KM të verifikuar, si dhe adresa e mënyrat e kontaktit;
- **Seksioni i dytë:** Të dhënat për statusin e tyre në organizatën profesionale ku janë anëtarësuar, si dhe të dhëna në lidhje me pagesën e tarifës së verifikimit;
- **Seksioni i tretë:** Të dhëna në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar pranë OP-së dhe BMP-së, si dhe komente për çështje apo problematika të ndryshme që mund të shtrohen nga Komisioni Ad-Hoc.

Intervistat e subjekteve KM

Procedura e intervistave të subjekteve është realizuar me qëllim saktësimin dhe qartësimin e komisionit Ad-Hoc në lidhje me dokumentacionin e paraqitur për verifikim, si dhe gjetje të ndryshme të konstatuara gjatë shqyrtimit të dosjes. Disa nga pyetjet e intervistës kanë konsistuar mbi ushtrimin e profesionit si më poshtë:

- Nëse kanë qenë administrator apo ortak në shoqëri të tjera kontabiliteti;
- Shoqëritë e kontabilitetit ku ofrojnë shërbime;
- Nëse administratorët e tyre disponojnë certifikatë të kontabilistit të miratuar;
- Numri mesatar i subjekteve për të cilat i ofron shërbime dhe lloji i aktivitetit;
- Numri i punonjësve të angazhuar;
- Programi financiar që përdorin në punën e tyre;
- Ekspertiza të ofruara në prokurori dhe/apo gjykatë;
- Çështje të konfliktit të interesit dhe njohja e zbatimi në praktikë i Kodit të Etikës së organizatës profesionale ku bën pjesë;
- Ndjekja e kualifikimit të vijueshëm profesional sipas kërkesave ligjore dhe rregullatore, tematikat e trajtuara, si dhe trajnime të tjera të ndjekura jashtë organizatës profesionale ku janë anëtarësuar;

- Subjektet KM janë pyetur gjithashtu lidhur me kontrollin e cilësisë të organizuar nga Organizata Profesionale përkatëse përgjatë 5 (pesë) viteve të fundit, rezultatet e tyre;
- Masat e ndërmarra në kuadër të ligjit Nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”.

Me subjektet e intervistuar janë diskutuar edhe çështje në lidhje me gjetjet në dosjet përkatëse dhe ndaj tyre janë bërë pyetje për të qartësuar problematikat e konstatuara në procesin e intervistave.

Njëkohësisht, është kërkuar opinioni i KM-ve në lidhje me problematika apo rekomandime të cilat ata mund të paraqesin me qëllim përmirësimin e profesionit në të ardhmen, si nëpërmjet punës së Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar, edhe nëpërmjet veprimtarisë rregullatore të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Problematika të konstatuara në dosjet e analizuara

- Nga shqyrtimi i dosjeve të KM, problematika kryesore mbetet mos përmbushja e detyrimit ligjor përsa i përket kualifikimit të vijueshëm. Vërehet se gjatë pesë viteve të fundit, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk e kanë përmbushur detyrimin për sasinë e orëve që kërkohet;
- U vërejt se shumica e subjekteve KM të intervistuar janë të njohur me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Megjithatë, nuk kanë rregullore apo masa konkrete të tjera për zbatimin e kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore (problematikë e reflektuar pas ndërgjegjësimit nga ana e komisionit);
- Mungesa e kontrollit të cilësisë të ushtruar ndaj subjekteve KM të cilët ofrojnë shërbime kontabiliteti;
- Licencat e KM-ve të lëshuara ndër vite rezultojnë të jenë me numra jo unikë, pra numrat e licencës përsëriten për KM të ndryshëm, por me data dhe vite të ndryshme. Kjo problematikë paraqet domosdoshmërinë për krijimin e një regjistri unik të kontabilistëve të miratuar me numër individual të përcaktuar nga BMP;

Në dosjet e analizuara deri më tani, janë konstatuar disa KM, të cilët kanë të regjistruar në QKB subjekte juridike SHPK, ndërkohë rezultojnë të paregjistruar si Shoqëri Kontabiliteti. Gjithashtu, ka patur kontabilistë të miratuar të cilët janë njëkohësisht administratorë shoqërisht tregtare dhe hartues e nënshkrues bilancesh si KM të këtyre shoqërive.

Problematika dhe sugjerime të subjekteve KM gjatë intervistave të tyre

- Të bashkërendohet puna për uljen e informalitetit dhe tregut të zi në profesionin e KM. Nga deklaratat e dhëna gjatë procesit të intervistave pjesa më e madhe e subjekteve KM ka ngritur problematikën në lidhje me ofrimin e shërbimeve të mbajtjes dhe deklarimit të pasqyrave financiare nga individë pa certifikatë KM, të cilët kanë regjistruar aktivitetin si konsulencë fiskale në QKB;
- Shumica e subjekteve KM të intervistuar deklaruan se problem serioz në profesion është hartimi dhe deklarimi i pasqyrave financiare nga vetë inspektorët tatimore në mënyrë informale;
- Problematikë e theksuar e shprehur ka qenë niveli profesional i pakënaqshëm i stafit të administratës tatimore;
- Ndryshimi i vazhdueshëm i legjislacionit në fushën e tatimeve dhe taksave duke vështirësuar punën e kontabilistëve të miratuar në realizimin eficient të shërbimeve të tyre;
- Kërkesë tjetër e shprehur prej vetë KM-ve është rritja e cilësisë dhe etikës në ushtrimin e profesionit të kontabilistit të miratuar, si dhe përcaktimi i tarifave dysheme për shërbime të ndryshme kontabël;
- Rekomandime ka pasur përsa i përket përmirësimit të raporteve të OP-së me KM-të dhe institucionet e tjera rregullatore apo mbikëqyrëse (tatimet, etj). Kalendar i përbashkët seminaresh dhe trajnimesh me administratën tatimore për bashkërendimin e problematikave dhe çështjeve të tjera për tu trajtuar ndërmjet grupeve të interesit;
- Kryesisht, ndër arsyet e përmendura nga subjektet ka qenë neglizhenca në ndjekjen e vazhdueshme të trajnimeve të organizuara nga OP, mos marrja e njoftimeve përkatëse nga OP, rrethana personale që kanë pamundësuar pjesëmarrjen gjatë periudhës së përcaktuar për trajnime, mungesa e programeve të plotë të trajnimeve për kualifikimin e vijueshëm profesional, etj;
- Një problematikë e hasur më shpesh ka qenë dhe mungesa e vazhdueshme e komunikimit me OP-në përkatëse, kryesisht me përfaqësuesit e organizatave në rrethe, si dhe me përditësimin e të dhënave të kontakteve telefonike dhe postës elektronike të anëtarëve;
- Ndarja në grupe e kontabilistëve për zhvillimin e orëve të edukimit të vijueshëm sipas eksperiencës, vjetërsisë në profesion dhe trajnimeve të tjera që mund të kenë bërë;
- Në tregun shqiptar nuk përdoret masivisht faturimi sipas ligjit;
- Për punonjësit e administratës tatimore, kontabilistët sugjerojnë se duhet të ketë një periudhë nga momenti i largimit nga kjo punë deri në hapjen e një licence si kontabilistë;

- Për të punësuarit të cilët ofrojnë shërbimet e kontabilitetit për punëdhënësin por që nuk e mbajnë titullin KM, të vendoset një kufizim që të jenë të punësuar pranë këtij subjekti për të paktën një vit.

Rekomandime për Organizatat Profesionale

- Rekomandohet që organizatat profesionale që operojnë në treg të implementojnë eksperiencat më të mira nga institucionet dhe organizatat profesionale të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me zhvillimin e profesionit të kontabilistit të miratuar;
- Rekomandohet që organizatat profesionale, të cilat mbrojnë të drejtat e kontabilistëve të miratuar në nivel institucional, të rrisin bashkëpunimin me institucione qendrore dhe lokale si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoritë e Tatim-Taksave dhe të tjera me qëllim uljen e informalitetit në tregun shqiptar;
- Rekomandohet që organizatat profesionale të realizojnë trajnime sipas standardeve dhe praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me modulet, nivelin e trajnerëve, numrin e pjesëmarrësve, ndarjen sipas nivelit të tyre të kualifikimit dhe nevojave të trajnimit, etj;
- Rekomandohet që organizatat profesionale të përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme të dhënat e subjekteve (numër telefoni, email, adresë, etj) të anëtarësuar pranë tyre si dhe të mbajnë komunikim të vazhdueshëm me ta, në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të ushtrimit të profesionit të kontabilistit të miratuar.

Rekomandime për përmirësimin e profesionit të Kontabilistit të Miratuar

- Rekomandohet që kontabilistët e miratuar të rrisin cilësinë e shërbimit, si dhe në bashkëpunim me organizatat profesionale të miratojnë çmimet “dysHEME” për shërbimet e ofruara me qëllim rregullimin e tregut në të cilin ata operojnë;
- Rekomandohet që nënshkrimi dhe deklarimi i pasqyrave financiare në QKB të bëhet vetëm nga kontabilistët e miratuar dhe të punësuarit “ekonomistë” pranë shoqërive tregtare të paktën 6 muajt e fundit;
- Rekomandohet që Qendra Kombëtare e Biznesit të mos lejojë regjistrimin si person fizik për ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit të individëve që nuk mbajnë titullin kontabël i miratuar;
- Rekomandojmë që kontabilistët të miratuar, të cilët në pesë vitet e fundit nuk kanë përmbushur orët e edukimit të vijueshëm profesional për periudhën 2014-2019, t'i nënshtrohen procedurës së testimit;

- Rekomandojmë që, për kontabilistët e miratuar aktivë të cilët gjatë periudhës 2014-2019 nuk kanë ndjekur asnjë orë edukimi të vijueshëm, përveç testimit, duhet t'i nënshtrohen edhe kontrollit të cilësisë nga organizata profesionale në të cilën janë të anëtarësuar.

Rezultatet përfundimtare të procesit të verifikimit

Me përfundimin e afatit të funksionimit të komisionit Ad-Hoc dhe fazës së parë të procesit të verifikimit në gusht të vitit 2020, Komisioni ka arritur në konkluzionet e mëposhtme, bazuar në të dhënat e analizuara, duke i ndarë subjektet në disa kategori.

Organizatrat profesionale kanë paraqitur pranë Komisionit Ad-Hoc dosjet sa më poshtë:

Tabela 1: Të dhëna mbi dosjet e dërguara nga Organizatat Profesionale


Nr.	Organizata Profesionale	Dosje KM Gjithsej
1	IKM	474
2	SHKFSH	301 ⁴
3	SHKM	19
	TOTALI	794

Nga të gjitha dosjet e paraqitura nga organizata profesionale, nga Komisioni Ad-Hoc janë analizuar gjithsej 577 dosje të kontabilistëve të miratuar. Nga këto subjekte të analizuara 552 janë subjekte të verifikuara dhe 25 subjekte të cilat nuk kanë arritur të finalizohet verifikimi, nga ana e komisionit Ad-Hoc. Për këto subjekte, përveç problematikave apo mangësive të konstatuara në dosjet përkatëse të dorëzuara, nuk është bërë i mundur as intervistave për arsyet e mëposhtme:

- kanë të dhëna (e-mail, cel) të pasakta (pavarësisht komunikimeve të vazhdueshme me organizatat profesionale);
- kanë refuzuar të vazhdojnë verifikimin (intervistat);
- kanë ndërruar jetë.

⁴ Nga 301 dosje të ardhura nga OP SHKFSH janë shqyrtuar 90 dosje. Dosjet e tjera nuk janë shqyrtuar pasi i janë vënë në dispozicion komisionit në datë 30 Prill 2020.

Grafiku Nr. 2: Të dhëna mbi dosjet e paraqitura pranë Komisionit Ad-Hoc.



Subjekte të verifikuar të cilët e kalojnë procesin dhe duhet të publikohen në regjistër

Sipas të dhënave të analizuar rezultojnë 310 kontabilistë të miratuar të cilët e ushtrojnë aktivitetin si persona fizikë ose nëpërmjet shoqërive të kontabilitetit, për të cilët është analizuar dosja, është kryer procesi i intervistave nga Komisioni Ad-Hoc, është përfunduar verifikimi i dokumentacionit dhe përmbushin kriteret ligjore për t'u publikuar në regjistër.⁵ Prej tyre 282 janë persona fizikë dhe 28 shoqëri kontabiliteti.

Subjekte të verifikuar të cilët pas procesit kanë rezultuar problematikë dhe nuk duhet të publikohen në regjistër⁶

Sipas të dhënave të analizuar rezultojnë 32 kontabilistë të miratuar, persona fizikë dhe shoqëri kontabiliteti, për të cilët është analizuar dosja, është kryer procesi i intervistave nga Komisioni Ad-Hoc, është përfunduar verifikimi i dokumentacionit dhe nuk përmbushin kriteret ligjore për t'u publikuar në regjistër. Prej tyre 16 janë persona fizikë dhe 16 janë shoqëri kontabiliteti.

Subjekte të cilët nuk e ushtrojnë profesionin si person fizik ose nëpërmjet shoqërisë së kontabilitetit

Sipas të dhënave të analizuar, rezultojnë 144 kontabilistë të miratuar, të cilët pas procesit të verifikimit rezulton se i plotësojnë kushtet e përcaktuara në aktet nënligjore dhe duhet të

⁵ Përveç përmbushjes së orëve të plota të edukimit të vijueshëm profesional.

⁶ Të gjithë subjektet kontabilistë të miratuar të cilët pas procesit kanë rezultuar problematikë dhe nuk janë publikuar në regjistër, me përmbushjen e kriterëve ligjore përkatëse, do të përfshihen në regjistrin e konsoliduar të BMP-së, nëpërmjet një Vendimi të Komisionit përkatës.

dërgohen pranë organizatave profesionale me qëllim pasqyrimin e tyre në regjistrat përkatës sipas përcaktimeve ligjore.

Këta kontabilistë, në momentin që do të vendosin të ushtrojnë aktivitetin si person fizik apo si shoqëri kontabiliteti, duhet të përcjellin kërkesën përkatëse pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, me qëllim publikimin e tyre në regjistër.

Gjithashtu, rezultojnë edhe 4 kontabilistë të miratuar të cilët pas procesit të verifikimit rezulton se nuk e ushtrojnë profesionin si person fizik apo nëpërmjet shoqërisë së kontabilitetit dhe nuk përmbushin kriteret ligjore.

Vendimmarrja e Komisionit për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Qeverisjes së Organizatave dhe Anëtarësisë së tyre

Gjatë periudhës shtator-dhjetor të vitit 2020, ky Komision ka vijuar veprimtarinë e tij si më poshtë:

Verifikimi i dokumentacionit të dosjeve të ardhura pas përfundimit të afatit sipas rregullores

Referuar pikës 10, të nenit 12, të Rregullores Nr. 9 datë 27.02.2019 “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të organizatave profesionale dhe profesionit të kontabilistit të miratuar”, dokumentacioni që është pjesë e vlerësimit paraqitet si më poshtë:

1. Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
2. Dëshmi penaliteti;
3. Certifikata e titullit KM;
4. Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (certifikatë NIPT);
5. Vërtetim nga OP përkatëse:
 - i. për rezultatet e kontrollit të cilësisë realizuar nga OP përkatëse (në rastet kur janë kryer);
 - ii. nëse janë marrë masa disiplinore ose jo nga OP përkatëse;
 - iii. për kryerjen me sukses të kualifikimit të vijueshëm për 5-vitet e fundit;
6. Vërtetim nga sigurimet shoqërore për marrëdhëniet e punësimit, për 5 vitet e fundit. Në rast se individit ka qenë jashtë vendit, si dokument vërtetimi shërbejnë kontratat dhe certifikatat e punësimit (fotokopje të noterizuara);
7. Vetë deklaram që dokumentet e paraqitura dhe të dhënat e deklaruara janë të sakta;

8. Dokumente shtesë në lidhje me çështje të lidhura me parandalimin dhe pastrimin e parave, çështje të evazionit fiskal, si dhe çdo dokument tjetër bazuar në informacione të marra nga jashtë;
9. Të tjera të përcaktuara me vendim të BMP-së, në përputhje me kuadrin rregullator.

Komisioni, në kuadër të procesit të verifikimit të dokumentacionit të kontabilistëve të miratuar, ka plotësuar për secilin subjekt një formular të ndarë në tre seksione:

- Në seksionin e parë jepen të dhënat identifikuese për çdo KM të verifikuar, si dhe adresa e mënyrat e kontaktit;
- Në seksionin e dytë jepen të dhënat për statusin e tyre në organizatën profesionale ku janë anëtarësuar, si dhe të dhëna në lidhje me pagesën e tarifës së verifikimit;
- Në seksionin e tretë paraqiten të dhëna në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar pranë OP-së dhe BMP-së, bazuar në pikën 10, të nenit 12, të rregullores Nr. 9, si dhe komente për çështje apo problematika të ndryshme që mund të shtrohen nga Komisioni.

Intervistat e KM-ve

Procedura e intervistave të subjekteve është realizuar me qëllim saktësimin dhe qartësimin e Komisionit në lidhje me dokumentacionin e paraqitur për verifikim si dhe gjetje të ndryshme të konstatuara gjatë shqyrtimit të dosjes. Disa nga pyetjet e intervistës kanë konsistuar mbi ushtrimin e profesionit si më poshtë:

- Nëse kanë qenë administrator apo ortakë në shoqëri të tjera kontabiliteti;
- Shoqëritë e kontabilitetit ku ofrojnë shërbime;
- Nëse administratorët e tyre disponojnë certifikatë të kontabilistit të miratuar;
- Numri mesatar i subjekteve për të cilat ofron shërbime dhe lloji i aktivitetit;
- Numri i punonjësve të angazhuar;
- Programi financiar që përdorin në punën e tyre;
- Ekspertiza të ofruara në prokurori dhe/apo gjykatë;
- Çështje të konfliktit të interesit dhe njohja e zbatimi në praktikë i Kodit të Etikës së organizatës profesionale ku bën pjesë;
- Ndjekja e kualifikimit të vijueshëm profesional sipas kërkesave ligjore dhe rregullatore, tematikat e trajtuara si dhe trajnime të tjera të ndjekura jashtë organizatës profesionale ku janë anëtarësuar;
- Subjektet KM janë pyetur gjithashtu lidhur me kontrollin e cilësisë të organizuar nga Organizata Profesionale përkatëse përgjatë 5 (pesë) viteve të fundit, rezultatet e tyre;

- Masat e ndërmarra në kuadër të ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”.

Njëkohësisht është kërkuar opinioni i KM-ve në lidhje me problematika apo rekomandime të cilat ata mund të paraqesin me qëllim përmirësimin e profesionit në të ardhmen si nëpërmjet punës së organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, edhe nëpërmjet veprimtarisë rregullatore të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Raportim përmbledhës mbi ecurinë e procesit në vitin 2020

Veprimtaria e komisionit ka konsistuar në realizimin e detyrave si më poshtë vijon:

1. Verifikimi i kontabilistëve të miratuar aktivë dhe kontabilistëve të miratuar jo-aktivë, deri në finalizimin e këtij procesi, përmes publikimit dhe përditësimit të regjistrave të konsoliduar të kontabilistëve të miratuar, duke garantuar ndër të tjera që shërbimi i kontabilistëve të miratuar të mos ofrohet nga individë apo subjekte të tjerë të pa licencuar, apo që konkurrojnë në mënyrë të padrejtë me ushtruesit e rregullt të profesionit. Në kuadër të kësaj detyre, komisioni ka realizuar shqyrtimin, analizimin dhe diskutimin e 85 dosjeve të Kontabilistëve të Miratuar, të cilat janë paraqitur pas afatit të përcaktuar në rregullore. Paralelisht nga sa më lart, komisioni ka kërkuar në mënyrë të pavarur edhe informacion shtesë mbi çdo KM për të bërë një verifikim sa më të plotë të çdo dosjeje. Në rastet e evidentimit të mungesës së dokumentacionit dhe informacionit në dosje është komunikuar në mënyrë elektronike dhe telefonike me secilin KM për plotësimin e këtyre mangësive.
2. Si pjesë e procesit të verifikimit janë realizuar gjatë muajit dhjetor 2020 intervista me 22 subjekte KM, prej të cilave 7 janë Shoqëri Kontabiliteti dhe 15 Persona Fizikë (PF). Secili subjekt është kontaktuar fillimisht me email nga ana e Komisionit për caktimin e datës së intervistës, më tej është kontaktuar në mënyrë telefonike për caktimin e orarit të përshtatshëm për të. Nëpërmjet analizimit paraprak të secilës dosje dhe intervistomi, Komisioni do të intervistave me vendimmarrje për çdo subjekt të verifikuar. Komunikimi i vazhdueshëm në mënyrë elektronike dhe telefonike me subjektet në lidhje me informacionin e përgjithshëm dhe ndërgjegjësimin për procesin e verifikimit ka zënë një pjesë të konsiderueshme të kësaj veprimtarie.
3. Gjatë kësaj periudhe, nga ana e komisionit është realizuar monitorimi i kryerjes së edukimit të vijueshëm të kontabilistëve të miratuar që ushtrojnë profesionin, si dhe atyre profesionistëve që kanë fituar titullin kontabilist i miratuar të cilët nuk janë ushtrues të profesionit. Konkretisht, nga anëtarët e komisionit është bërë monitorimi si fizikisht pranë ambienteve ku organizoheshin trajnimet nga organizatat profesionale, ashtu edhe nëpërmjet platformave on-line, kur trajnimet janë zhvilluar në këtë format.

4. Gjithashtu, është mbajtur korrespondencë e vazhdueshme në mënyrë elektronike dhe shkresore me subjektet KM dhe organizatat profesionale në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre. Ndërkohë, komisioni, në mbështetje të certifikatave të dërguara pranë BMP-së, ka reflektuar dhe përditësuar orët e edukimit të vijueshëm për secilin KM.
5. Gjatë kësaj periudhe, komisioni ka patur komunikim institucional të vazhdueshëm me Ministrinë e Drejtësisë, të cilës i është përcjellë regjistri i konsoliduar i KM-ve, referuar nenit 224/d të Kodit të Procedurës Civile, Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 10619, datë 19.10.2018, me rekomandimin që ky regjistër t'i shtohet regjistrit elektronik të ekspertëve të cilët mund të ofrojnë njohuri të posaçme pranë organeve të drejtësisë për fushën përkatëse. Në kushtet që regjistri i konsoliduar i kontabilistëve të miratuar është në përditësim të vazhdueshëm, BMP do t'i përcjellë në mënyrë periodike Ministrisë së Drejtësisë shtesat apo ndryshimet e mundshme të tij. Gjithashtu, komunikimi ka konsistuar dhe në përcjelljen e informacionit dhe vlerësimit të komisionit në lidhje me subjekte specifike KM, me kërkesën e MD-së.

Problematika të konstatuara në dosjet e analizuara

- Nga shqyrtimi i dosjeve të KM, problematika kryesore mbetet mos përmbushja e detyrimit ligjor përsa i përket kualifikimit të vijueshëm. Vërehet se gjatë pesë viteve të fundit, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk e kanë përmbushur detyrimin për sasinë e orëve që kërkohet.
- U vërejt se shumica e subjekteve KM të intervistuar janë të njohur me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Megjithatë, nuk kanë rregullore apo masa konkrete të tjera për zbatimin e kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore (problematikë e reflektuar pas ndërgjegjësimit nga ana e komisionit).
- Mungesa e kontrollit të cilësisë të ushtruar ndaj subjekteve KM të cilët ofrojnë shërbime kontabiliteti.

4.2.2 Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale

Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP), i krijuar më 29.03.2018, në zbatim të nenit 17 dhe 18 të ligjit 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjorë dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ka për objekt të veprimtarisë organizimin dhe realizimin e testeve, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve për AL dhe KM.

Ky komision ka pësuar ndryshime në përbërjen e tij në vitin 2020. Anëtarët aktualë të këtij komisioni janë emëruar me Vendimin Nr. 68, datë 04.09.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike “Për emërimin e kryetares së Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale” dhe Vendimin

Nr. 71, datë 12.11.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike “Për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale”.

KPAP përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga BMP për një periudhë 4 (katër) vjeçare, sipas propozimeve të mëposhtme:

- a. kryetari nga Ministri i Financave;
- b. dy anëtarë nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
- c. një anëtar nga organizmat profesionalë apo Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
- ç. një anëtar nga profesori i fushës së universiteteve.

Përmes një procesi vlerësimi me pikë të dosjes së kandidatëve për t`u përzgjedhur si anëtarë të KPAP-së, BMP përzgjedh dhe emëron kandidatët fitues të propozuar nga institucionet e përcaktuara në gërmat c) dhe ç) të pikës 2 me shumicë të thjeshtë të anëtarëve pjesëmarrës. Procesi i vlerësimit bëhet nga një komision “Ad-Hoc” nga struktura mbështetëse, që bën vlerësimin e aplikimeve dhe ia paraqet BMP-së për vendimmarrje. Sistemi i vlerësimit miratohet me vendim të veçantë nga BMP-ja në momentin e shpalljes së vendeve vakante duke konsideruar kriteret e përcaktuara në kuadrin rregullator përkatës.

KPAP realizon veprimtarinë në zbatim të misionit të vet të përcaktuar nga ligji dhe nga aktet e tjera rregullatore, sikurse janë:

- Rregullorja Nr. 2, datë 22.02.2018 “Për funksionimin e KPAP dhe të Mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për AL dhe KM”, e ndryshuar;
- Rregullorja Nr. 6, datë 31.05.2018 “Për procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale të kandidatëve për AL dhe KM”, e ndryshuar.

Për vitin 2020, KPAP ka realizuar 16 mbledhje dhe ka marrë 18 vendime.

Disa nga aktivitetet kryesore të zhvilluara nga KPAP, përgjatë vitit 2020, përmbledhen si më poshtë:

- U miratua kalendari i provimeve për sezonin e vitit 2020, u organizua puna administrative nga IEKA, i cili përmes sekretarisë teknike publikoi informacionet, grumbulloi aplikimet dhe i përpunoi të dhënat në kohën e duhur;
- Bazuar në informacionet e përpunuara nga sekretaria teknike, KPAP miratoi listën e kandidatëve që plotësonin kriteret dhe trajtoi e shqyrtoi me seriozitet dhe në përputhje me ligjin, rregulloret dhe aktet e tjera rregullatore të miratuara nga BMP, kërkesat dhe ankesat e kandidatëve;
- Në lidhje me administrimin e procesit të testimit, KPAP, mori të gjitha masat e karakterit teknik dhe administrativ, që provimi në të gjitha disiplinat të realizohej në kushte të barabarta për kandidatët, në përputhje me programin e miratuar e sipas të


gjitha kërkesave të ligjit 10091/2009 dhe Rregulloreve për organizimin e procesit të provimeve, si dhe duke respektuar të gjitha protokollet e sigurisë anticovid të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Organizimi i provimeve të sezonit 2020 u realizua pas marrjes së lejeve të nevojshme dhe në bazë të kushteve të përcaktuara nga Komiteti Teknik i Ekspertëve.

Në sezonin e provimeve të vitit 2020⁷, pjesëmarrja e kandidatëve për secilin provim paraqitet si në vijim:

- Në provimin e parë, të zhvilluar më datë 12 dhjetor 2020, në disiplinën *“Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar”*, u regjistruan 145 kandidatë, prej të cilëve morën pjesë në provim 136 kandidatë. Në këtë provim u shpallën 48 fitues, pra 35.3 % e kandidatëve;
- Në provimin e dytë, të zhvilluar më datë 19 dhjetor 2020, në disiplinën *“Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë”*, u regjistruan 129 kandidatë, prej të cilëve morën pjesë në provim 125 kandidatë. Në këtë provim u shpallën 33 fitues, pra 26.4 % e kandidatëve;
- Në provimin e tretë, të zhvilluar më datë 23 dhjetor 2020, në disiplinën *“Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”*, u regjistruan 147 kandidatë, prej të cilëve morën pjesë në provim 141 kandidatë. Në këtë provim u shpallën 106 fitues, pra 75.2 % e kandidatëve.
- Në provimin e katërt, të zhvilluar më datë 22 janar 2021, në disiplinën *“Procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit”*, u regjistruan 36 kandidatë, prej të cilëve morën pjesë në provim 35 kandidatë. Në këtë provim u shpallën 20 fitues, pra 57.1 % e kandidatëve.
- Në provimin e pestë, të zhvilluar më datë 6 shkurt 2021, në disiplinën *“Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit dhe drejtimit, kontrolli i brendshëm i njësive ekonomike të biznesit dhe përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës”*, u regjistruan 30 kandidatë, prej të cilëve morën pjesë në provim 29 kandidatë. Në këtë provim u shpallën 22 fitues, pra 75.9 % e kandidatëve.
- Në provimin e gjashtë, të zhvilluar më datë 13 shkurt 2021, në disiplinën *“Qeverisja e shoqërive tregtare dhe zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit”*, u regjistruan 26 kandidatë, prej të cilëve morën pjesë në provim 25 kandidatë. Në këtë provim u shpallën 19 fitues, pra 76 % e kandidatëve.

⁷ Me qëllim pasqyrimin e të dhënave të plota dhe të sakta për provimet e sezonit 2020, në këtë paragraf të raportit janë pasqyruar edhe të dhënat për provimet që janë zhvilluar në muajt Janar-Shkurt të vitit 2021.

Në mënyrë të përmbledhur, në grafikun në vijim, pasqyrohet kalueshmëria në *përqindje (%)*, për secilin provim⁸, të zhvilluar në sezonet e tre viteve të fundit.



Për të garantuar një proces sa më të rregullt, transparent e cilësor për hartimin dhe korrigjimin e provimeve, në përputhje edhe me ndryshimet e pasqyruara në vitin 2020 në aktet rregullatore ku bazohet KPAP për të ushtruar veprimtarinë e saj, janë angazhuar hartues, hartues rishikues, korrigjues (të grupit të parë dhe të dytë paralel), si dhe rishikues cilësorë.

Për tre provimet e para të realizuara më dhjetor 2020 janë angazhuar 17 hartues, 3 hartues rishikues, 24 korrigjues (grupi i parë dhe grupi i dytë paralel) dhe 6 rishikues cilësorë.

Përzgjedhja e tyre është bërë nëpërmjet një procesi mjaft të kujdesshëm, duke verifikuar dokumentacionin dhe plotësimin e kriterëve për secilin prej tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Procedura që është ndjekur për përzgjedhjen e tyre paraqitet në mënyrë të përmbledhur në vijim:

⁸ Në sezonin e vitit 2018 janë zhvilluar pesë provime.

1. Publikimi i shpalljes për hartues/korrigjues, sipas kritereve të përcaktuara në Rregulloren nr. 2, datë 22.02.2018 “Për funksionimin e KPAP dhe të Mbiqëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për AL dhe KM”, e ndryshuar.

Për përzgjedhjen e hartuesve, kriteret e përcaktuara janë:

- a. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse, ose
- b. Gradë apo titull shkencor apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
- c. Si dhe përveç pikës i ose pikës ii, aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore.

Kërkesa drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale, së bashku me dokumentacionin shoqërues, është dorëzuar pranë sekretarisë teknike të organizatës profesionale IEKA dhe një kopje e kërkesës, së bashku me dokumentacionin, është dorëzuar pranë Strukturës Mbështetëse të BMP në rrugë postare ose elektronike.

Për përzgjedhjen e korrigjuesve, kriteret e përcaktuara janë :

- a. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- b. Mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
- c. Njohuri të mira të standardeve profesionale dhe/ose kuadrit rregullator të lidhur me fushën në të cilën do angazhohen si hartues dhe korrigjues dhe të kenë përvojë praktike lidhur me fushën përkatëse.

Kërkesa e aplikimit së bashku me dokumentacionin shoqërues është dorëzuar pranë sekretarisë teknike të organizatës profesionale IEKA dhe/ose pranë SM të BMP-së.

Dokumentacioni që është dorëzuar nga të gjithë kandidatët për hartues dhe korrigjues është:

1. Kërkesë me shkrim për pozicionin që po aplikon;
2. Curriculum Vitae;
3. Referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në fushën përkatëse për të cilën po aplikon;
4. Fotokopje të diplomave;
5. Certifikatën e gjendjes gjyqësore (informacion për rekorde penale).

2. Verifikimi i dokumentacionit dhe plotësimit të kritereve nga ana e kandidatëve:

Anëtarët e KPAP dhe sekretaria teknike kanë bërë verifikimin e dokumentacionit në bazë të kritereve të caktuara, përzgjedhjen e kandidatëve që i plotësojnë kriteret e përcaktuara e që eksperiencia e të cilëve i përafrohet secilës prej disiplinave të provimeve.

3. Miratimi i listës me kandidatët fitues:

Lista e *hartuesve, grupit të parë të korigjuesve dhe grupit të tretë të korigjuesve (rishikuesit që bëjnë korigjimin cilësor)*, të cilët plotësojnë kriteret, miratohet nga KPAP, në përfundim të procedurave të përzgjedhjes dhe i dërgohet për miratim Komisionit të Rishikimit. Ky i fundit, përveçse bën verifikimet për të gjithë kandidatët për hartues dhe korigjues në përputhje me procedurat për “*vetingun*” e profesionalizmit të përcaktuar me rregullore të veçantë, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, për të garantuar një përzgjedhje sa më cilësore dhe në rast se konstaton parregullsi ose papajtueshmëri apo në rast se kandidatët nuk plotësojnë kriteret, bën shkualifikimin e tyre duke kërkuar propozime shtesë.

Grupi i dytë paralel i korigjuesve përzgjidhet nëpërmjet një procesi shorti me gogla. Kandidatët për grupin e dytë aplikojnë direkt pranë Strukturës Mbështetëse (SM) dhe përzgjedhja e tyre bëhet nga SM e BMP-së në prezencën e të paktën një përfaqësuesi nga KPAP. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes, pas verifikimit nga Komisioni i Rishikimit, lista i dërgohet KPAP.

Komisioni i Rishikimit miraton gjithashtu edhe listën me hartues rishikuesit.

Kjo procedurë është ndjekur për secilin nga provimet e sezonit.

Përzgjedhja e hartuesve dhe rishikuesve është bërë gjithashtu duke garantuar objektivitetin e procesit, duke nënvizuar shmangien e konfliktit të interesit midis hartuesve dhe korigjuesve dhe mos përfshirjen e tyre në më shumë se një proces.

4.2.3 Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës

Në mbështetje të ligjit 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar dhe në kuadër të përmbushjes së përgjegjësisë që rrjedhin nga rregullorja Nr. 4, datë 29.03.2018 “*Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore*”, Bordi i Mbikëqyrjes Publike nëpërmjet Vendimit Nr. 30, datë 15.07.2019 ngriti pranë tij Komisionin e Investigimit dhe Disiplinës (KIDB). Përgjatë vitit 2020, ky komision ka patur ndryshime në përbërjen e tij dhe aktualisht përbëhet nga 5 anëtarë, prej të cilëve 3 anëtarë janë të përhershëm dhe 2 anëtarë janë ekspertë të jashtëm, të cilët thirren për raste të veçanta të lidhura me çështje që për nga natyra kanë një kompleksitet më të madh.

Në pajtim me nenin 4, të rregullores nr. 4, KIDB konfirmon që në fillim të çdo procesi shqyrtimi për përcaktimin dhe propozimin e masave disiplinore, se çdo anëtar i caktuar për të shqyrtuar rastin nuk është i lidhur apo ka interesa në çështjen që investigohet. Nëse ka konflikt që në fillim ose nëse konflikti lind gjatë procesit të shqyrtimit, anëtari është i detyruar të largohet menjëherë nga procesi i vendim-marrjes së KIDB. Nenet 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 18 të kësaj rregulloreje përcaktojnë mënyrat e nisjes së procedurës nga BMP, trajtimin e saj dhe procesin e vendimmarrjes.

Në funksion të zbatimit të rregullores nr. 4, me Vendimin nr. 28, datë 15.07.2019 është miratuar edhe Manuali nr. 1, datë 15.07.2019 *“Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”*.

Përgjatë vitit 2020, ky komision ka zhvilluar 53 mbledhje dhe ka marrë 79 vendime. Ndër çështjet kryesore të trajtuara prej tij gjatë këtij janë:

- Diskutim dhe vendimmarrje për të gjitha rastet e inspektimeve të cilat kanë patur rezultate jo të kënaqshme nga kontrolli për sigurimin e cilësisë për shqyrtim të mëtejshëm nga KIDB;
- Diskutim dhe vendimmarrje për të gjitha rastet që nuk kanë dorëzuar informacion brenda afateve të planifikuara në kontrollin e cilësisë së BMP;
- Diskutim dhe vendimmarrje për të gjitha rastet e gjetjeve/problematikave që lidhen me Kontabilistët e Miratuar, të deleguara nga Komisioni Ad-Hoc dhe të miratuara nga Bordi për investigim të mëtejshëm;
- Trajtimi i rasteve të problematikave të Audituesve Ligjorë, të cilët në kundërshtim me përcaktimet ligjore kanë audituar me një auditues të vetëm shoqëritë anonime ose shoqëritë që raportojnë me SNRF;
- Diskutim dhe vendimmarrje lidhur me ankesat e mbërritura pranë BMP.

Në vijim, në mbështetje edhe të kuadrit ligjor e rregullator e në përmbushje të përgjegjësisë ligjore, edhe pse jo një qëllim në vetvete, BMP ka ndërmarrë edhe një sërë masash administrative duke filluar nga gjobë e deri në pezullim licence për audituesit ligjorë. Edhe pse në filozofinë e BMP-së mbizotëron qëllimi për të edukuar dhe orientuar audituesit dhe profesionistët kontabël për të kryer një punë cilësore, masat administrative janë veprimi i fundit për të ndikuar në këtë drejtim.

4.2.4 Komisioni Ligjor

Komisioni Ligjor i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i ngritur me vendimin nr. 31, datë 15.07.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, veprimtaria e të cilit mbështetet në rregulloren *“Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Ligjor të BMP”*, të miratuar me vendim të BMP nr. 31, datë 15.07.2019, gjatë vitit 2020 ka patur ndryshime në përbërjen e tij, të miratuara me Vendimin nr. 50 datë 04.08.2020 dhe Vendimin nr. 78 datë 27.11.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Ky komision përbëhet nga 4 anëtarë, specialistë të fushës.

Baza ligjore për ngritjen e Komisionit Ligjor janë shkronja “F”, e pikës 2, të nenit 8 të Statutit të BMP i cili përcakton se *“...Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton krijimin e komiteteve dhe komisioneve të specializuara, që mund të kenë në përbërje ose jo anëtarët të Bordit, punonjësit e Strukturës Mbështetëse, dhe specialistë të jashtëm...”*. si dhe nën paragrafi katër, i pikës 2, të

nenit 11 i cili përcakton se “...Komitetet, komisionet dhe këshillat mund të ngrihen lidhur me çështje të pajtueshmërisë ligjore...”.

Komisioni Ligjor ka qëllim:

- Hartimin e projekt-rregulloreve, projektvendimeve dhe shqyrtimin e çështjeve e tjera që paraqiten në BMP-së;
- Dhënien e opinioneve ligjore mbi çështjet e shqyrtuar nga KIDB, kur natyra e tyre kërkon njohuri të tilla, të cilat e limitojnë personelin që merret me çështje ligjore për të dhënë një opinion të plotë, sipas rregullores së investigimit;
- Shqyrtimin e propozimeve të KIDB dhe relacioneve përkatëse mbi masat disiplinore për subjektet e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe përgatitjen e opinionit përkatës ligjor, i cili i kalon për shqyrtim Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
- Ofrimin e këshillit ligjor për Komisionet dhe organet e tjera administrative të ngritura pranë BMP-së;
- Shqyrtimin e ankesave të dorëzuara nga Drejtori Ekzekutiv lidhur me pajtueshmërinë ligjore dhe rekomandimin e vendimeve mbi masat që duhen marrë;
- Kryerjen e kontrollit të brendshëm të cilësisë, mbi baza përzgjedhje, për dosjet e rekomanduara pozitivisht, me kërkesë të Drejtorit Ekzekutiv.

Komisioni Ligjor, gjatë vitit 2020, ka zhvilluar 17 mbledhje dhe ka dhënë 25 opinione ligjore. Ndër çështjet kryesore të trajtuara prej tij gjatë këtij janë:

1. Interpretimi i germës “c”, kreu III, të VKM Nr. 17, datë 16.01.2019 “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”;
2. Opinion ligjor lidhur me përfundimin e mandateve të disa anëtarëve të KPAP-së në cilësinë e përfaqësimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) dhe Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) mbështetur në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, rregulloreve, organeve kolegjiale dhe mënyrën e përzgjedhjes së tyre;
3. Opinions ligjore lidhur me trajtimin e vendimeve të KIDB për disa subjekte AL;
4. Opinion ligjor lidhur me trajtimin e relacionit dhe evidencave për shkarkimin e një anëtari të KPAP-së;
5. Interpretim i dispozitave ligjore mbi kërkesat e Kontabilistëve të Miratuar;

6. Shqyrtim i kërkesave të KIDB në lidhje me propozimet për masë disiplinore për Audituesit Ligjorë të cilët në kundërshtim me përcaktimet ligjore, kanë audituar me një auditues të vetëm shoqëritë anonime ose shoqëritë që raportojnë me SNRF;
7. Opinion ligjor mbi përfundimin e mandatit;
8. Opinion ligjor mbi interpretimin lidhur me shkresën nr. 224, datë 26.06.2020 të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA) lidhur me çështjen e publikimit të masave disiplinore të vendosura nga BMP ndaj subjekteve të ligjit 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar;
9. Opinion ligjor lidhur me ndryshimet e rregullores Nr. 5, Datë 29.03.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”;
10. Trajtimin e ankesave të Audituesve Ligjorë/Shoqërive të Auditimit për gjobat e vendosura nga BMP;
11. Opinion ligjor lidhur me sigurinë dhe transparencën e administrimit të dokumenteve të provimeve;
12. Interpretim ligjor lidhur me korrespondencat mes BMP dhe KLSH;
13. Opinion Ligjor pas trajtimit të evidencave të akumuluar nga KIDB për disa AL;
14. Opinion ligjor lidhur me kërkesën për interpretim për kërkesa/raste të tjera.

4.2.5 Komisioni për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Komisioni për Trajtimin e Çështjeve të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave për Subjektet e Mbikëqyrjes së Bordit të Mbikëqyrjes Publike është krijuar me Vendimin Nr. 29, datë 15.07.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Përgjatë vitit 2020 ky komision ka zhvilluar tre mbledhje.

Çështjet kryesore të trajtuara nga ky komision janë si në vijim:

- Në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të grupit të punës së ICRG (International Cooperation Review Group) e FATF (Financial Action Task Force), u shqyrtua memorandumi i bashkëpunimit me DPPP në lidhje me përmbushjen e detyrave dhe bashkëpunimin institucional për nxjerrjen e vendit nga lista e vendeve me monitorim të shtuar nga FATF. Gjatë këtij diskutimi u shqyrtua ecuria e realizimit të detyrave sipas afateve të dakordësuara në takimet e zhvilluara me Komitetin e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.
- Shqyrtimi i draft rregullores nr. 12, datë 02.07.2020 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, udhëzuesit për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe

financimi i terrorizmit si pjesë përbërëse e rregullores dhe manualit për mbikëqyrjen e subjekteve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, rregulloren dhe manualin e mbikëqyrjes me fokus në rrezikun e PPP/FT, ku u shqyrtuan rreziqet e PP/FT me të cilat mund të ndeshet profesionisti kontabël gjatë ushtrimit të profesionit, elementët të cilët duhet të përfshihen në matricën e vetëvlerësimit të rrezikut, si pjesë e programit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në zbatim.

- Shqyrtimi i përshtatshmërisë së ndryshimeve të propozuara në rregulloren nr. 10 datë 11.06.2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të regjistrimit dhe përditësimin e regjistrimit publik”*, e ndryshuar, që lidhen me zbatimin e planit të veprimit të ICRG/FATF për kontrollin e lidhjeve kriminale të individëve që hyjnë në profesionin e audituesit ligjor / kontabilistit të miratuar. Këto ndryshime kryesisht do të plotësojnë kuadrin rregullator në lidhje me dokumentacionin e kërkuar për regjistrimin e audituesve ligjorë dhe pronarët individë jo auditues ligjorë në shoqëritë e auditimit në regjistrin publik për të verifikuar nëse janë në proces gjyqësor apo nën hetim nga prokuroria për çështje penale, si edhe mbikëqyrjen e procesit të regjistrimit nga organizata profesionale e audituesve ligjorë.
- Analiza për vlerësimin e rrezikut të profesionit të audituesit ligjor, kontabilistët e miratuar në kuadër të vlerësimit kombëtar të riskut.
- Komisioni shqyrtoi listën e shoqërive të auditimit që ka të regjistruar individë jo auditues ligjorë dhe listën e dokumentacionit që do të verifikohet gjatë inspektimit për vlerësimin e pajtueshmërisë me kërkesat të rregullores nr. 10, datë 11.06.2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të regjistrimit dhe përditësimin e regjistrimit publik”*, e ndryshuar, si edhe programin e inspektimit për vlerësimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së mbajtjes dhe përditësimit të regjistrimit publik dhe komitetit të regjistrimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.
- Ndër çështjet që u shqyrtuan veçojmë edhe gjetjet e konstatuara gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator të parandalimit dhe pastrimit të parave përgjatë veprimtarisë së Kontrollit të Cilësisë, duke mos konstatuar baza për çështje që mund të përbëjnë dyshime të pastrimit të produktit të veprës penale, por përmirësime të procedurave të punës dhe mbajtjes së dokumentacionit në mbështetje të analizave të kryera.
- Në zbatim të planit të veprimit të dakordësuar me grupin e punës së ICRG / FATF u shqyrtua raportimi nga subjektet e mbikëqyrura të BMP-së sipas *“Aneks – Modeli i miratuar i deklarimit të të dhënave për PPP-FT”* dhe matrica e rrezikut e populluar me të dhënat e raportuara dhe draft-plani i inspektimit tematik për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave për t’u realizuar gjatë periudhës nëntor – dhjetor 2020 dhe janar – maj 2021.

4.2.6 Komisioni i Rishikimit

Në mbështetje të ligjit 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar dhe në kuadër të përmbushjes së përgjegjësiqe që rrjedhin nga Rregullorja Nr. 2, datë 20.02.2018 “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësiqe Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar”, pas ndryshimeve të miratuara në këtë rregullore, me Vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike Nr. 69, datë 16.10.2020, ky i fundit, nëpërmjet Vendimit të tij me Nr. 77, datë 27.11.2020, ngriti pranë tij Komisionin e Rishikimit. Mbledhja e parë e këtij komisioni u zhvillua më datë 08.12.2020.

Komisioni i Rishikimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë profesionistë, ndër të cilët 2 (dy) janë juristë dhe 3 (tre) të përzgjedhur nga profesionistë të fushës së kontabilitetit, auditimit, fiskale, e të menaxhimit, ku një prej tyre është anëtar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, të cilët plotësojnë kërkesat e parashikuara në rregulloren Nr. 2, të ndryshuar.

Komisioni i Rishikimit, ndër të tjera, ka kompetencat si më poshtë:

- të verifikojë hartuesit dhe korigjuesit, që propozohen nga KPAP në përputhje me këtë rregullore dhe rregullat e posaçme, që lidhen me përzgjedhjen dhe vetingun e kandidatëve për hartues, korigjues dhe rishikues të miratuara nga BMP me vendim të veçantë;
- të përzgjedhë rishikuesit e cilësisë së hartimit të tezës sipas dispozitave të parashikuara në këtë rregullore (përmes një procedure konkurrimi të hapur dhe intervistimi dhe/ose testimi), që do të kontrollojnë cilësinë e fondit të pyetjeve të përgatitura nga hartuesit;
- të përzgjedhë grupin e tretë të korigjuesve (rishikuesve që do bëjnë korigjimin cilësor) që do të angazhohet për të rishikuar rastet e fletoreve të korigjuara për të gjitha diferencat mbi 5% të pikëve, që rrjedhin nga procesi i korigjimit të dy grupeve paralele të korigjuesve;
- të realizojë rishikimin administrativ.

Përgjatë vitit 2020, Komisioni i Rishikimit ka zhvilluar 4 mbledhje fizikisht dhe 5 mbledhje on-line, në të cilat janë marrë 9 vendime, 5 nga të cilat janë vendime qarkulluese.

Çështjet kryesore të trajtuara prej tij, përgjatë vitit 2020, janë:

1. Verifikimi e miratimi i hartuesve të provimit të parë të datës 12.12.2020, në disiplinën “Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar”;
2. Përzgjedhja e rishikuesit të cilësisë së hartimit të tezës për provimin e parë të datës 12.12.2020 dhe zëvendësimi i tij si rrjedhojë e karantinimit për shkak të kontakteve me persona Covid-19 pozitiv;

3. Verifikimi e miratimi i hartuesve të provimit të dytë të datës 19.12.2020, në disiplinën “Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë”;
4. Verifikimi e miratimi i grupit të parë dhe të dytë paralel të korigjuesve për provimin e parë të datës 12.12.2020;
5. Përzgjedhja e rishikuesit të cilësisë së hartimit të tezës për provimin e dytë të datës 19.12.2020;
6. Verifikimi e miratimi i hartuesve të provimit të tretë të datës 23.12.2020, në disiplinën “Zbatimi në praktike i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”;
7. Përzgjedhja e rishikuesit të cilësisë së hartimit të tezës për provimin e tretë të datës 23.12.2020;
8. Verifikimi e miratimi i grupit të parë dhe të dytë paralel të korigjuesve për provimin e dytë të datës 19.12.2020.

4.2.7 Komisioni i Revistës së BMP-së

Komisioni i Revistës së Bordit të Mbikëqyrjes Publike u ngrit për herë të parë me Vendimin Nr. 61, datë 04.08.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Përgjatë vitit 2020 ka patur ndryshime në përbërjen e tij, ndryshime këto të miratuara me Vendimin Nr. 80 datë 27.11.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Mbledhja e parë e këtij komisioni është zhvilluar më datë 17.09.2020.

Ky komision përbëhet nga 4 (katër) anëtarë profesionistë të fushës së gazetarisë dhe kontabilitetit, auditimit, fiskale, e menaxhimit, ku një prej tyre është anëtar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Komisioni i Revistës së BMP-së është strukturë përgjegjëse për përçarjen e mesazhit që Bordi i Mbikëqyrjes Publike synon të transmetojë tek publiku me qëllim rritjen e sigurisë në auditimet ligjore, të cilat kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik si dhe përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar.

Komisioni i Revistës ka qëllim të publikojë opinionet e profesionistëve të fushës, të zhvillojë debate të nivelit profesional, të informojë për ndryshimet legjislative në vend dhe në botë, si dhe tema të lidhura me misionin e saj, si dhe të pasqyrojë aktivitetet e Bordit të Mbikëqyrjes Publike çdo tre muaj, rezultatet e proceseve të hetimeve administrative mbi audituesit, ecurinë e kontrollit të dokumentacionit të kontabilistëve, etj.

Gjatë vitit 2020 ky komision ka zhvilluar 5 mbledhje në kuadër të publikimit të revistës së BMP-së.

Çështjet kryesore të trajtuara nga ky komision, përgjatë vitit 2020, janë:

- draftimi i strategjisë së zhvillimit të revistës, planifikimi i tyre, si dhe draftimi i planit të punës për numrin e parë të revistës së BMP-së;
- diskutime mbi vijueshmërinë e procesit dhe planit të përcaktuar në kuadër të finalizimit të numrit të parë të revistës së BMP-së;
- shqyrtimi i draftit të përgatitur për numrin e parë të revistës së BMP-së dhe kopertinës së editorialit, finalizimi dhe printimi i numrit të parë të Revistës së BMP-së, me përmbajtjen si në vijim:
 - *Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, Z. Dritan Fino* - Vendosija e besimit në raportimin financiar;
 - *ZV/Kryeministër, Z. Erion Braçe* - Reformat në fushën e profesionit të audituesit dhe kontabilistit në vendin tonë;
 - *Ekspert i Bankës Botërore për Shqipërinë, Z. Andrei Busuioc* - Bordi i Mbikëqyrjes Publike në Shqipëri, një shembull i mirë për shumë vende të rajonit;
 - *Drejtor Ekzekutiv i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, Z. Aldo Spahiu* - Hap pas hapi, ndryshimet ligjore në 4 vitet e reformës;
 - *Kryetar i SHKFSH, Z. Sherif Bundo* - Koha e rrëmujës dhe e informalitetit të lartë ka përfunduar;
 - *Kryetar i IKM, Z. Sotiraq Dharmo* - Formalizimi i profesionit “Kontabël i Miratuar” siguron cilësi dhe saktësi në kryerjen e shërbimit;
 - Artikull - Renditja e kompanive më të mëdha të auditimit në vend;
 - Zhvillimet kryesore ekonomike *Publikohet projektbuxheti i vitit 2021*;
 - *Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë, Znj. Luljeta Minxhozi* - Si do e ndryshojë pandemia sistemin financiar, sfidat e harmonizimit të politikave;
- diskutime, propozime dhe draftimi i planit të punës për numrin e dytë të Revistës së BMP-së;
- diskutime mbi ecurinë e vijueshmërinë e procesit dhe planit të përcaktuar në kuadër të finalizimit të numrit të dytë të Revistës së BMP-së.

4.2.8 Komisioni i Brendshëm për Kontrollin e Cilësisë

Komisioni i Brendshëm i Kontrollit të Cilësisë (KBKC), i ngritur me Vendimin nr. 42 datë 02.07.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, përbëhet nga 3 anëtarë, të cilit janë emëruar me Vendimin nr. 48, datë 04.08.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Komisioni i Brendshëm i Kontrollit të Cilësisë kryen këto detyra:

- Shqyrtimi i procedurave të ndjekura për procesin e KC nga inspektorët dhe nëse është bërë rishikimi i brendshëm i KC në mbështetje të kuadrit rregullator në fuqi për çdo rast që ka ankesa nga subjektet e KC lidhur me procedurat e ndjekura;

- Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet inspektorëve të KC dhe të kontrolluarit, arbitrimi bëhet nga Komisioni i Brendshëm i Kontrollit të Cilësisë, pasi audituesi ligjor i kontrolluar, ka paraqitur formalisht qëndrimet e tij;
- Propozimi i udhëzimeve pranë BMP-së për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe kërkesave ligjore që lidhen me auditimet ligjore;
- Në rast se kontrolli i cilësisë për njësitë jo me interes publik është deleguar te organizata profesionale e audituesve ligjorë, arbitrimi (në rast se nuk është deleguar) ndërmjet inspektorëve të KC dhe të kontrolluarit apo mbikëqyrja e veprimtarisë vjetore lidhur me proceset e kontrollit të cilësisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë, bëhet nga Komisioni i Brendshëm i Kontrollit të Cilësisë;
- Interpretimin e kërkesave lidhur me zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Nga 10 inspektime të kontrollit të cilësisë të kryera gjatë vitit 2019-2020, është paraqitur pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike vetëm një rast për shqyrtim, i cili më pas është deleguar për trajtim të mëtejshëm nga KBKC.

Gjatë vitit 2020, Komisioni i Brendshëm i Kontrollit të Cilësisë, sipas një plani të përcaktuar, ka zhvilluar 7 mbledhje. Në mbledhjet e zhvilluara përgjatë këtij viti është realizuar, trajtuar dhe diskutuar për sa më poshtë:

- Njohja me shkresën e dërguar nga subjekti AL si dhe dokumentin e transkriptimit të regjistrimit të takimit të zhvilluar mes subjektit dhe Inspektorëve të BMP, të vënë në dispozicion nga struktura mbështetëse e BMP-së;
- Zhvillimi i një takimi me Inspektorët e Lartë të Kontrollit të Cilësisë së Bordit Mbikëqyrjes Publike, pas shqyrtimit të materialeve të vëna në dispozicion nga struktura mbështetëse, për tu njohur më tej me evidencat që lidhen me raportin e kontrollit për sigurimin e cilësisë së subjektit AL;
- Thirrja në seancë dëgjimore e subjektit, bazuar në kërkesën e tyre për t'u dëgjuar në lidhje me gjykimet e tyre profesionale. Subjekti u njoftua për zhvillimin e kësaj seance dëgjimore përmes email dhe ajo u zhvillua në ambientet e BMP-së;
Zhvillimi i seancës dëgjimore ndërmjet dy përfaqësuesve të subjektit AL dhe anëtarëve të KBKC, asistuar nga Sekretaria Teknike e këtij Komisioni. Në këtë seancë dëgjimore, u parashtruan gjykimet lidhur me raportin e kontrollit për sigurimin e cilësisë nga ana e përfaqësuesve të subjektit AL. Minutat e seancës dëgjimore, me konfirmim të palëve u regjistruan në audio dhe u transkriptuan nga Struktura Mbështetëse e BMP-së;
- Diskutimi e trajtimi përfundimtar i pretendimeve të subjektit nga KBKC. Ky i fundit, pasi diskutoi lidhur me evidencat e akumuluar, vendosi t'ju përcjellë Inspektorëve të Lartë të Kontrollit të Cilësisë së BMP-së minutat e seancës dëgjimore të zhvilluar nga KBKC me subjektin, për të vlerësuar nëse pretendimet e tyre qëndrojnë ose jo. Në

vijim, anëtarët e KBKC kërkuan një relacion argumentues nga Inspektorët e Lartë të Kontrollit të Cilësisë së BMP-së ku të merren në konsideratë minutat e takimit të zhvilluar me subjektin;

- Inspektorët e KC së BMP-së, me kërkesën e KBKC, hartuan relacionin shpjegues;
- KBKC, pasi analizoi çështjet e ngritura në raportin e kontrollit të sigurimit të cilësisë për subjektin AL, ftoi në mbledhje Inspektorët e KC së BMP dhe trajtuan çështjet e lidhura me konfliktin e interesit, rotacionin dhe ekzistencën e transaksioneve të parasë fizike për të qartësuar më tej gjetjet dhe konkluzionet e evidentuara prej tyre. Në përfundim të procesit, u theksua toleranca dhe mirëkuptimi nga ana e Inspektorëve të BMP për të vazhduar bashkëpunimin me subjektin e kontrolluar, pavarësisht pengesave të hasura gjatë këtij procesi;
- KBKC propozoi t'i përcillet anëtarëve të BMP-së lidhur me sa më sipër.

4.3. Rritja e kapaciteteve të stafit mbështetës

Gjatë vitit 2020, edhe pse në një situatë të vështirë për shkak të pandemisë globale së Covid-19, një vëmendje e veçantë i është kushtuar rritjes së kapaciteteve të stafit të BMP-së. Gjatë kësaj periudhe, nëpërmjet ekspertëve vendas dhe të huaj, si dhe partnerëve ndërkombëtarë janë zhvilluar një sërë sesionesh trajnimi dhe asistence teknike me stafin e strukturës mbështetëse.

Pjesëmarrja në trajnime është realizuar nëpërmjet video konferencave.

Janë zhvilluar trajnime me video konferencë të organizuara nga IFAC në lidhje me çështje të rëndësishme të auditimit dhe ndikimit të pandemisë në cilësinë e punës dhe dokumentimit të auditimit, si planifikimi i auditimit, kryerja e auditimit dhe raportimi i audituesit.

Janë zhvilluar trajnime të brendshme të strukturës mbështetëse lidhur me çështje të raportimit financiar, kontrollit të cilësisë, dispozitave ligjore, çështjeve të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjithashtu janë zhvilluar trajnime në terren të strukturës mbështetëse përmes bashkëpunimit me Forumin Ndërkombëtar të Rregullatorëve të Pavarur (IFIAR), Komitetin e Bordeve Evropiane të Mbikëqyrjes së Auditimit, Bankës Botërore për çështje të lidhura me :

- Kontrollin e cilësisë së audituesve ligjorë
- Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
- Teknologjinë e informacionit në auditim
- Investigimin dhe marrjen e masave disiplinore
- Ndryshimet në sistemin e pagesave

- Pavarësinë e autoriteteve rregullatore të mbikëqyrjes publike të profesionit kontabël

Qëllimi kryesor i këtyre trajnimeve ka qenë rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve të inspektorëve të strukturës mbështetëse.

Në zbatim të rekomandimeve të Komitetit Moneyval, struktura mbështetëse ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara në kuadër të programit të Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë me temë “*Sanksionet financiare në lidhje me terrorizmin, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë*”, me fokus kryesor identifikimin e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohen subjektet e mbikëqyrura.

Një tjetër cikël seminaresh në distancë janë ndjekur nga stafi i strukturës mbështetëse në kuadër të programit global për luftën kundër pastrimit të parave në bashkëpunim me GIZ – Bashkëpunimin Ndërkombëtar Gjerman dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Në këto seminare u ofrua asistencë dhe informacion në formën e materialeve, për hartimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator për mbikëqyrjen me qasje në rrezik, hartimin e planeve të veprimit për mbikëqyrjen e PPP/FT, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave dhe kryerjen e inspektimeve pranë subjekteve të mbikëqyrura dhe marrjen e masave përkatëse.

5. Vështrimi i përgjithshëm mbi shërbimet e auditimit

5.1. Cilësia në auditim

Auditimi është një e mirë publike, ai i jep siguri palëve të interesuara për integritetin dhe cilësinë e informacionit financiar në tregun e kapitalit dhe formon bazën për vendimmarrje në investime. Auditimi i ofron një siguri të arsyeshme drejtuesve të shoqërive mbi integritetin e shoqërisë. Një shoqëri e drejtuar mirë, transparente dhe e përgjegjshme nuk gjeneron vetëm kapital për të financuar më shumë investime, por i jep besim punonjësve që puna e tyre është e sigurtë dhe furnitorëve që do të paguhen në të ardhmen.

Në të njëjtën kohë nevoja për cilësi më të lartë të auditimit vjen gjithmonë e në rritje, edhe për shkak të nivelit më të lartë në pritshmëritë që ka vetë biznesi. Si rrjedhojë, aktet rregullatore, metodologjitë e reja të miratuara nga BMP, si dhe zbatimi i tyre synojnë mbështetjen e cilësisë së lartë dhe praktikave më të mira të standardeve të auditimit, duke shkuar aq larg sa të mbrojnë audituesin në pavarësinë dhe në parandalimin e konfliktit të interesit që mund të ekzistojë në qoftë se një auditues është angazhuar në ofrimin e shërbimeve jo audituese për një njësi të audituar.

Nëse audituesit nuk mund të tregojnë pavarësinë e tyre, ata nuk mund të trajtojnë perceptimin që mbajnë disa nga palët e interesit, duke u nxitur më shumë nga konsideratat e tyre tregtare dhe shitjen e shërbimeve jo audituese sesa duke vepruar në interesin publik. BMP tashmë ka filluar punën duke parë efektivitetin e kërkesave ndaj audituesve në lidhje me punën që bëjnë për informacionin e publikuar, së bashku me pasqyrat financiare.

5.1.1 Cilësia në auditim dhe përgjigja jonë

BMP ka zhvilluar një strategji të kontrollit dhe monitorimit të shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë e cila bazohet në kontrollin e drejtpërdrejtë (me inspektime të vazhdueshme) për shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë të NjIP, si dhe në monitorimin (mbikëqyrjen) e shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë të mesëm dhe të vegjël. Çdo vit, me të dhënat e mbledhura nëpërmjet raportimit të misioneve të angazhimeve të auditimit, inspektorët e strukturës mbështetëse plotësojnë matricën e rrezikut që shërben si bazë për realizimin e procesit të kontrollit dhe monitorimit bazohet në një analizë risku, duke e fokusuar veprimtarinë e BMP-së në subjektet që paraqesin risk më të lartë.

Në vijim të inspektimeve të realizuara në terren gjatë vitit 2019, ku janë realizuar 10 inspektime të kontrollit të sigurimit të cilësisë në nivel firme dhe janë rishikuar 20 dosje në nivel angazhimi të auditimit, gjatë vitit 2020 u realizua procesi i raportimit të këtyre inspektimeve. Faza e raportimit është një proces dinamik dhe ndërveprues me subjektin e inspektuar, gjatë të cilit rishikohen evidencat e mbledhura gjatë vizitës në terren dhe realizohen takimet përmbyllëse me qëllim hartimin e një raporti të plotë të inspektimit i cili do të nxisë përmirësimin e cilësisë së auditimit.

Në seksionin 5.3/5.4 të këtij raporti, janë publikuar gjetjet e shpalosura në përfundimit të procesit të raportimit në shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë pjesë e procesit të inspektimit. Megjithëse janë identifikuar shembuj të praktikave të mira, nga inspektimet e realizuara u konstatua se cilësia e auditimit nuk është në nivele të tilla që të sigurojë një informacion cilësor shtesë për përdoruesit e pasqyrave financiare. Është identifikuar një nevojë e menjëhershme për të rritur kapacitetet e audituesve ligjorë si dhe të personelit mbështetës që ato përdorin në realizimin e angazhimeve të ofrimit të sigurisë (auditimit dhe shërbimeve të tjera të sigurisë).


Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka krijuar një eksperiencë të çmuar gjatë kontrolleve të cilësisë së viteve 2018 – 2020, e cila ka rritur kapacitetet teknike dhe efektivitetin e stafit të BMP-së. Nga ana tjetër, kjo eksperiencë transferohet gjatë procesit të inspektimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë edhe tek shoqëria e auditimit / audituesit ligjor duke u përkthyer si një proces zhvillues profesional për të gjitha palët pjesëmarrëse në proces.

Gjatë procesit të inspektimeve, BMP i kushtoi rëndësi të madhe transparencës dhe diskutimit të hapur të gjetjeve me palët e përfshira në proces. BMP ka qenë i fokusuar për të identifikuar çështjet me rrezik më të lartë për interesin publik dhe t’i adresojë ato në mënyrë të përshtatshme dhe t’i mbrojtë me vendosmëri.

5.1.2 Konkurrenca në tregun e auditimit

Tregu i auditimit në Shqipëri është i përbërë nga 148 auditues ligjorë që e ushtrojnë aktivitetin si person fizik dhe 58 shoqëri auditimi dhe 25 auditues ligjorë të punësuar pranë shoqërive të auditimit, me një total prej 231 auditues ligjorë të regjistruar në fund të vitit 2020.

Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit ndërmarrin rreth 3288 auditime ligjore në vit



referuar të dhënave për angazhimet e realizuar në vitin 2020. Qarkullimi i përgjithshëm i vlerësuar nga të dhënat e disponueshme pranë BMP-së është 1,068.83 milionë Lekë ose rreth 8.6 milion EURO⁹.


Audituesit ligjorë kanë realizuar një qarkullim vjetor prej rreth 36% të auditimeve për pasqyrat financiare të vitit 2019, ndërsa shoqëritë audituese kanë realizuar një qarkullim prej rreth 64%.

Gjatë tre viteve të fundit të ardhurat e realizuara për shërbimet e auditimit kanë qenë në rritje si për shoqëritë e auditimit, ashtu edhe për audituesit


⁹ Ky informacion është mbështetur mbi tabelat e misioneve të dorëzuara nga audituesit ligjorë dhe nuk reflekton misionet e 3 subjekteve të cilat nuk kanë dorëzuar informacionin e kërkuar deri në datën e përgatitjes së këtij raporti.

ligjorë, por duke mbajtur të pandryshuar përqindjen në totalin e të ardhurave nga shërbimet e auditimit.

Në mënyrë të detajuar të ardhurat e realizuara nga shërbimet e auditimit përkatësisht prej shoqërive të auditimit dhe audituesve ligjorë gjatë tre viteve të fundit paraqiten në tabelën e mëposhtme:



Ecuria e tregut për tre vitet e fundit sipas numrit të njësive të auditimit dhe të ardhurat e realizuara nga shërbimet e auditimit paraqitet si në vijim:





Shërbimet e tjera të realizuara nga audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit zënë një peshë të konsiderueshme në të ardhurat e tyre. Kështu, nga të dhënat e disponueshme për vitin 2020, rezulton që audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit kanë realizuar të ardhura nga shërbime të tjera në një vlerë prej rreth 831 milion Lekë ose rreth 6.7 milion EURO.

Ashtu si në angazhimet e auditimit, shoqëritë audituese zënë peshën më të konsiderueshme me rreth 52% e të ardhurave në dhënien e shërbimeve të tjera.

Shërbimet e tjera përfshijnë: angazhime të dhënies së sigurisë si rritje kapitali, transformim, bashkim, ndarje, vlerësim aktivesh, ekspertiza gjykatë dhe të ngjashme; angazhime të rishikimit të informacioneve financiare historike, mbajtje kontabiliteti, përgatitje e pasqyrave financiare, konsulencë dhe të tjera të ngjashme.

5.2. Inspektime me fokus kontrollin e cilësisë

Objektivi i inspektimeve për rishikimin e cilësisë së auditimit është të sigurojë dhe promovojë përmirësimin në cilësinë e auditimeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Rishikimi i cilësisë së auditimit vlerëson cilësinë e punës, procedurave dhe politikave të audituesve në angazhimet që ata ndërmarrin, veçanërisht pranë njësive ekonomike me interes publik (NIP).

Shoqëritë e auditimit dhe angazhimet e auditimit të shqyrtuara janë përzgjedhur bazuar në vlerësimin e riskut sipas metodologjisë së sipërpërmendur, si një risi e cila mbështetet në kriteret ligjore dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Realizimi i planit të inspektimeve të kontrollit të cilësisë në terren rezultoi i pamundur përgjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2020, si rrjedhojë e kufizimeve për shkak të masave të marra në kuadër të gjendjes së pandemisë.

Gjatë vitit 2020, në vijim të inspektimeve të realizuara në terren, ku janë realizuar 10 inspektime të kontrollit të sigurimit të cilësisë në nivel firme dhe rishikimi i 20 angazhimeve të auditimit ligjor, u finalizuan raportet e kontrollit të sigurimit të cilësisë. Qëllimi i inspektimit për çdo shoqëri auditimi/auditues ligjor përfshiu si në vijim:

- Kontrollin e sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë së shoqërisë në nivel të firmës;

- Kontrollin e cilësisë të një kampioni të angazhimeve të auditimit të përzgjedhur, pjesërisht të aprovuara nga Bordi dhe pjesërisht të zgjedhura gjatë vizitës në terren në vijim të analizimit të informacionit të grumbulluar.

Procesi i punës vijoi me vlerësimin e elementëve të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë, si janë adresuar këto elementë në politikat dhe procedurat e shoqërisë, pajtueshmërinë e politikave dhe procedurave me standardin ndërkombëtar të kontrollit të cilësisë (SNKC1), me standardet ndërkombëtare të auditimit, kodin e etikës, me legjislacionin në fuqi dhe zbatimin e tyre në angazhimet e auditimit të përzgjedhura.

Raportimi: Në përfundim të kryerjes së kontrollit është zhvilluar një takim përmbyllës ku janë diskutuar gjetjet kryesore me drejtuesit dhe personat përgjegjës për kontrollin e cilësisë. Faza e parë e raportimit konsiston në përgatitjen e draft raportit dhe planit të veprimit, të cilat i komunikohen zyrtarisht shoqërisë së auditimit për koment. Në fazën e dytë të raportimit adresohen komentet e shoqërive të auditimit nëpërmjet diskutimeve të gjata dhe konstruktive midis shoqërisë së auditimit dhe inspektorëve të BMP-së, për të garantuar një proces transparent dhe të paanshëm.

Pavarësisht masave parandaluese të ndërmarra nga ekipi i inspektimit, gjatë realizimit të procesit të kontrollit dhe lëshimit të draft raportit kontrollit janë ndeshur sfida të shumta nga të cilat do të veçonim:

- Vështirësi në paraqitjen e informacionit mbi politikat dhe procedurat në zbatim nga shoqëria edhe pas shpalosjes në draft raportin e kontrollit;
- Rezistencë nga subjektet për të siguruar komentet që adresojnë mangësitë e identifikuar në draft raportin e kontrollit për sigurimin e cilësisë.

Në përfundim të këtij procesi, me lëshimin e raporteve të inspektimit, po paraqesim në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet kryesore të ndara në nivel të:

- sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë së shoqërisë së auditimit/audituesit ligjor;
- dosjes së angazhimit të auditimit;
- rekomandime për përmirësimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe kryerjes dhe dokumentimit të angazhimit të auditimit.

5.3. Gjetje të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Më poshtë janë paraqitur gjetjet kryesore të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë të grupuara sipas nën çështjeve më poshtë:

5.3.1 Manualet dhe procedurat e brendshme në lidhje me kontrollin e cilësisë

- Manualet e kontrollit të cilësisë, në zbatim nga shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë, nuk janë të përshtatura në nivel të praktikës. Ka një mungesë të përcaktimit të:
 - politikave apo procedurave të hartuara për të siguruar arritjen e objektivave të lidhura me sistemin e kontrollit të cilësisë;
 - procedurave të cilat sigurojnë zbatimin dhe monitorimin e pajtueshmërisë me këto politika;
 - politikave dhe procedurave se si do të përmbushen elementët e kontrollit të cilësisë në rastet e angazhimeve të përbashkëta apo në raste kur persona të jashtëm angazhohen në kryerjen e një angazhimi;
 - politikave mbi delegimin dhe kriteret e vlerësimit, për procesin e rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit, në rastet e angazhimit të audituesve ligjorë/shoqëri auditimi të pavarur.
- Mangësi në përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga monitorimi i rrjetit, si p.sh:
 - rishikimi nga partneri i angazhimit para lëshimit të raportit;
 - procesin e arkivimit të dosjes së auditimit;
 - kryerjen në baza ciklike të rishikimit të brendshëm të kontrollit të cilësisë për të vlerësuar përshtatshmërinë dhe zbatimin e politikave dhe procedurave dhe rishikime individuale të angazhimeve të auditimit.

5.3.2 Metodologjia e auditimit

- Shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë nuk kanë në përdorim një platformë/sistem të informatizuar të auditimit. Në disa prej shoqërive të kontrolluara është identifikuar se metodologjia/manuali i përdorur nuk është i përditësuar me standardet ndërkombëtare të auditimit të rishikuara;
- Gjithashtu, në manualet në përdorim nga shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë ka munguar përshtatja e manualeve me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator vendas;
- Në manualet e kontrollit të cilësisë/auditimit ka munguar përcaktimi i kriterëve për vlerësimin e rreziqeve të angazhimit.

5.3.3 Mbledhja, arkivimi dhe ruajtja e dosjes së angazhimit

Firmat më të vogla të auditimit dhe praktikuesit e vetëm nuk kanë procedura të arkivimit apo sisteme të arkivimit që të garantojnë ruajtjen dhe mos ndryshimin e letrave të punës pas datës së opinionit, kjo si rrjedhojë e mungesës së politikave dhe procedurave në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në SNKC1 dhe SNA 220.

Sistemet nuk ofrojnë siguri përsa i përket plotësisë së dosjes së angazhimit dhe arrijen në të njëjtat konkluzione me ekipin e auditimit nëse dosja e angazhimit do të ishte objekt rishikimi prej një pale të tretë të autorizuar.

5.3.4 Raporti i transparencës

Raporti i transparencës nuk është publikuar, edhe në rastet kur është publikuar ky raport është shumë i përgjithshëm dhe nuk ka trajtuar të gjithë elementët e parashikuar në ligjin për auditimin.

5.3.5 Auditimet e përbashkëta, kryerja e angazhimit, menaxhimi i dosjes, plotësimi dhe arkivimi i saj

Në rastet e bashkë auditimeve marrëdhënia e bashkëpunimit është e rregulluar me një kontratë të thjeshtë ndërmjet palëve, por që në këtë kontratë nuk përcaktohen përgjegjësitë në lidhje me sigurimin e cilësisë së angazhimit, përgjegjësitë në lidhje me rishikimin e letrave të punës, menaxhimin e dosjes, plotësimin dhe arkivimin e saj.

5.4. Gjetje të angazhimeve individuale

Ekipi i inspektimit ka vlerësuar cilësinë e përgjithshme të çdo auditimi individual të rishikuar. Janë shqyrtuar aspektet e kontrollit të cilësisë dhe zbatimi i procedurave në të gjitha angazhimet e auditimit që janë kontrolluar.

5.4.1 Parakushtet për pranimit/vazhdim të klientit/angazhimit të auditimit

Pavarësia

- Janë identifikuar mangësi në dokumentimin e deklaratës së pavarësisë nga audituesi ligjor apo personat e tjerë të angazhuar në auditim, si ekspertët e angazhuar në ekipin e auditimit;
- Ka munguar dokumentimi dhe marrja e masave për zbutjen e kërcënimeve ndaj pavarësisë, në rastin kur një anëtar i ekipit të auditimit ka qenë i punësuar tek klienti i auditimit.

Pranimi/vazhdimi i angazhimit

- Shoqëritë e vogla të auditimit/praktikuesit e vetëm që janë angazhuar në kryerjen e angazhimeve të auditimit të njëjësive ekonomike të mëdha, publike e me rëndësi strategjike kanë rezultuar që nuk kanë pasur struktura të duhura dhe burime të mjaftueshme për të siguruar nivelin e duhur të cilësisë së punës;
- Mos zbatim në kohën e duhur të procedurave të pranimit/vazhdimit të angazhimit;

- Mungesa e komunikimit me audituesin ligjor paraardhës;
- Emërimi i audituesit ligjor nga asambleja e ortakëve pas datës së lëshimit të opinionit.

5.4.2 Vlerësimi i riskut dhe përgjigja ndaj riskut të vlerësuar

- Në angazhimet e auditimit të rishikuara është identifikuar mos pajtueshmëri me SNA 230:
 - mungesa e dokumentacionit në lidhje me natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në pajtim me SNA-të individuale dhe kërkesat rregullatore në fuqi;
 - mungesa e dokumentacionit/referencimi i dobët përsa i përket rezultatit të procedurës së auditimit të realizuar;
 - mungesa e dokumentacionit/referencimi i dobët i evidencës së auditimit të siguar, çështjeve të rëndësishme të dala gjatë auditimit, konkluzioni i arritur si dhe gjykimet/supozimet profesionale të bëra në mbështetje të këtyre konkluzioneve.
- Në dosjet e auditimit të rishikuara nuk ka evidencë përsa i përket procedurave të vlerësimit të rrezikut dhe përgjigjes ndaj rrezikut prej audituesit. Ky është një aktivitet kyç gjatë fazës së planifikimit të auditimit. Për pasojë është vënë re një mos pajtueshmëri me standardet përsa i përket dokumentimit të procedurave të auditimit dhe evidencës së auditimit. Dosja e angazhimit ka pasur mungesa në letra pune;
- Dokumenti i procesit të kuptueshmërisë dhe njohjes së sistemeve të teknologjisë informative dhe të sistemeve të kontabilitetit, duke përfshirë proceset që lidhen me raportimin financiar dhe komunikimin ka pasur mangësi në njohjen e:
 - mjedisit të biznesit/sistemin e kontrollit të brendshëm përfshirë raportimin financiar;
 - si komunikojnë/integrohen sistemet me njëri tjetrin; dhe
 - dështimi për të identifikuar rolet dhe përgjegjësitë në këto sisteme që mund të rezultojë në një vlerësim të gabimit material të gabuar si dhe në përgjigje të auditimit (procedurat e auditimit të dizenuara në përgjigje të këtij rreziku) jo të duhur e të pambështetur.

Edhe në rastet kur këto procese dokumentohen, mungon formulimi i konkluzioneve në përfundim të procedurave të kryera dhe për rrjedhojë mungon edhe hartimi i programit të auditimit në përgjigje të rreziqeve të identifikuara;

- Është konstatuar mos dokumentimi dhe dokumentimi jo i plotë përsa i përket kërkimeve me drejtimin mbi çështje të ndryshme si në lidhje me përdorimin e parimit të vijimësisë në hartimin e pasqyrave financiare, transaksionet me palët e lidhura, vetëvlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, etj. (mungesë e të dhënave mbi takimin, palët pjesëmarrëse, feedback mbi çështjet e diskutuara);

- Dokumentimi i konkluzionit mbi vetëvlerësimin e njësisë ekonomike përsa i përket sistemit/strukturave të kontrollit të brendshëm në lidhje me përdorimin e parimit të vijimësisë dhe rrezikun e mashtrimit dhe gabimit, nuk është i mbështetur në dokumentet/buxhetet e njësisë ekonomike të audituar;
- Në të tjera raste është konstatuar një analizë e pjesshme e faktorëve të rrezikut për shkak të mashtrimit dhe gabimit, në zbatim të kërkesave të SNA 240. Mungon dokumentimi i testeve në nivel të regjistrimeve kontabël. Mangësi në kryerjen e procedurave të rishikimit analitik paraprak dhe rishikimin analitik përfundimtar;
- Procedurat e auditimit nuk kanë pasur informacion mbi popullatën, mënyrën e kampionimit dhe madhësinë e kampionit të përzgjedhur për testimin apo kryerjen e procedurave të auditimit mbi verifikimin e pohimeve të zërave të pasqyrave financiare (si të ardhurat, llogaritë e pagueshme, për rikuperimin e llogarive të arkëtueshme, për investimet, mbi angazhimet dhe detyrimet e paparashikuara);
- Evidenca e auditimit nuk është siguruar nëpërmjet letrave të konfirmimit gjatë testimit të balancave me bankat, llogarive të arkëtueshme, të pagueshme, si edhe në mungesë të përgjigjes së konfirmimit nuk realizohen procedurat alternative.

5.4.3 Raportimi

Përsa i përket lëshimit të opinionit dhe fazës së mbylljes së procesit të auditimit janë identifikuar çështjet si më poshtë:

- Në pasqyrat financiare të audituara mungon data e autorizimit për përdorim të pasqyrave nga drejtimi;
- Mangësi në përdorimin e listave të kontrollit mbi paraqitjen e pasqyrave financiare dhe shënimet shpjeguese dhe listave të kontrollit përfundimtar;
- Shënimet shpjeguese nuk kanë qenë të plota në pajtim me kërkesat e SKK dhe SNK-ve të ndryshme, si p.sh. informacioni mbi transaksionet me palët e lidhura, ngjarjet e nevojshme, etj;
- Letra e përfaqësimit në disa raste nuk është gjetur si pjesë e dosjes së angazhimit dhe nuk është siguruar.

6. Rekomandime për audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit

Në rekomandimet kryesore të shpalosura në raportet e kontrollit të sigurimit të cilësisë është theksuar rëndësia e plotësisë, aksesit, formës dhe sigurimit në kohë dhe pa kufizime i informacionit të aksesuar nga ekipi i inspektimit.

6.1. Rekomandime për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë

- Hartimi i politikave dhe procedurave të përshtatshme me strukturën e tyre në funksion të arritjes së sigurimit të cilësisë së shërbimeve që ato ofrojnë dhe sigurimit të pajtueshmërisë me kërkesat e standardeve dhe kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi. Shoqëria/audituesi ligjor duhet të ngrejë një sistem të kontrollit të sigurimit të cilësisë në pajtim me standardet, në mënyrë që opinioni mbi pasqyrat financiare të jetë i përshtatshëm në rrethanat;
- Rekomandohet që shoqëritë e auditimit të rishikojnë procedurat e brendshme të monitorimit, përta i përket kritereve të përzgjedhjes së shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë kur ky proces delegohet jashtë zyre, kriteret për rishikim të angazhimeve të auditimit, në mënyrë që përzgjedhja të jetë sa më përfaqësuese;
- Hartimi dhe përditësimi i metodologjisë së auditimit në pajtim me SNA-të në fuqi dhe me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator vendas;
- Mbajtja e dosjeve të angazhimit, hartimi, assembly dhe arkivimi i tyre duhet të bëhet në pajtim me kërkesat e SNKC1. Mbledhja/mbyllja e dosjes së angazhimit (fizike dhe elektronike) duhet të bëhet brenda periudhës 60 ditore në pajtueshmëri me kërkesat e SNKC1 dhe SNA 230;
- Hartimi dhe publikimi i raportit të transparencës nga audituesit ligjorë ose shoqëritë e auditimit të cilat angazhohen në auditime të njëjshme me interes publik. Ky raport duhet të trajtojë çështjet/seksionet siç parashikohen nga ligji për auditimin. BMP inkurajon të gjithë shoqëritë e auditimit të hartojnë raporte të cilat japin më shumë informacione dhe një pamje të vërtetë të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë të shoqërisë së auditimit;
- Në rastet e auditimeve të përbashkëta, tashmë një praktikë e përhapur dhe e mbështetur nga korniza rregullatore, do të rekomandohej që manuali i kontrollit të cilësisë të trajtojë në mënyrë specifike për këto tip angazhimesh se si do të administrohet:
 - kryerja e angazhimit të auditimit;
 - rishikimi në nivel të angazhimit, për rastet kur angazhimi i përbashkët kualifikohet për kontroll cilësie në nivel angazhimi;
 - mbledhja, arkivimi dhe ruajtja e dosjes së angazhimit;
 - përcaktimi dhe trajtimi i nevojës për konsultime.
- Përditësimi dhe parashikimi i politikave dhe procedurave në lidhje me rregulloret për PPP/FT sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin 9917/2008. Kërkesat e ligjit 9917/2008

duhet të trajtohen në kuadër të procesit të vlerësimit të rreziqeve paraprake në pajtim me SNA 315 dhe SNA 250.

6.2. Rekomandime për angazhimet e auditimit

- Rekomandohet shoqëria e auditimit/audituesi ligjor të krijojë sistemet e duhura që të sigurojnë që procedurat në lidhje me (i) pavarësinë realizohen për çdo anëtar të ekipit të auditimit, dhe (ii) pranim/vazhdimin e klientit/angazhimit të realizohen gjatë fazës paraprake të auditimit dhe konkluzioni i audituesit ligjor të mbështetet me evidencë të përshtatshme e të mjaftueshme;
- Komunikimi me audituesin paraardhës rekomandohet që të dokumentohet, si dhe trajtimi i klientëve potencial të cilët kanë pagesa të parealizuara ndaj audituesit ligjor paraardhës të bëhet në pajtim me kërkesat përkatëse të kodit të etikës;
- Rekomandohet dokumentimi:
 - (a) i realizimit të procedurave të vlerësimit paraprak të rrezikut përfshirë (i) mjedisin ligjor; (ii) mjedisin e kontrollit të brendshëm dhe vlerësimin për rrezikun e mashtrimit; (iii) rishikimin analitik paraprak; (iv) mjedisin e teknologjisë informative; (v) palëve të lidhura dhe (vi) përdorimit të parimit të vijimësisë në hartimin e pasqyrave financiare në kuadër të krijimit të kuptueshmërisë së mjedisit (të brendshëm dhe të jashtëm) në të cilin ushtron aktivitetin njësia ekonomike e audituar;
 - (b) i vlerësimit të rreziqeve të gabimit material (përfshirë rrezikun e mashtrimit) në nivel të pasqyrave financiare, klasave të transaksioneve dhe të pohimeve;
 - (c) përgjigjes së audituesit/procedurave të auditimit për t'u ndërmarrë në përgjigje të këtij vlerësimi;
- Rekomandohet që shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë të krijojnë sistemet e duhura që sigurojnë: (i) dokumentimi i letrave të punës në mbështetje të procedurave të kryera të jetë i plotë; (ii) rishikimi të ketë ndodhur (në rastet kur ekipi i auditimit përbëhet prej me shumë se 1 anëtar); (iii) evidenca e auditimit të jetë e përshtatshme dhe e mjaftueshme; (iv) konkluzioni mbi procedurën e realizuar të jetë i qartë; (v) referimin e ndërsjellë ndërmjet letrave të punës dhe procedurave të auditimit të hartuara;
- Rekomandohet ndjekja e praktikave më të mira për procesin e verifikimit të pajtueshmërisë së paraqitjes së pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese me kuadrin raportues financiar duke përdorur listat e kontrollit përfundimtar (completion checklist/memorandum) dhe listat e kontrollit mbi paraqitjen e pasqyrave financiare dhe shënimet shpjeguese (disclosure check-list);
- Rekomandohet audituesi ligjor të dokumentojë në mënyrë formale komunikimet me drejtimin dhe me komitetet e auditimit në përfundim të procesit të auditimit.

7. Procese të realizuara në kuadër të kontrollit të cilësisë

7.1. Rishikimet e Kontrollit të cilësisë në bashkëpunim me Bankën Botërore

Banka Botërore kërkon që auditimet e projekteve dhe njërive të financuara nga Banka të kryhen nga auditues të pavarur të cilët duhet të plotësojnë disa standarde për të qenë pjesë e rishikimit nga Banka Botërore. Kështu gjatë periudhës nëntor – dhjetor 2020 u realizua procesi i vlerësimit për përcaktimin e pranueshmërisë së audituesve, duke kryer një rishikim të kontrollit të cilësisë të shoqërive të interesuara të auditimit. Në përgjigje të interesit të shfaqur nga një numër i shoqërive të auditimit të regjistruara në Shqipëri u planifikua ky rishikim për përditësimin e listës së shoqërive të auditimit që plotësojnë standardet për të qenë pjesë e shoqërive që do të auditohen këto projekte

Vlerësimi i shoqërive të auditimit u realizuar në përputhje me udhëzimet e vlerësimit të shoqërive të Auditimit, në zbatim nga Banka Botërore. Këto udhëzime bazohen në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontrollit të Cilësisë 1 (ISQC1) të lëshuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB) i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC).

Faza e parë e këtij vlerësimi përfshin një rishikimin nga zyra të informacionit fillestar të siguruar nga të gjitha shoqëritë e auditimit që shfaqën interesin e tyre nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të përgatitur nga Banka Botërore. Nisur nga këto informacioni, ekipi i përbërë nga specialistë të menaxhimit financiarë përgatiti një listë të shkurtuar të shoqërive të auditimit me rishikimin e shoqërive të auditimit.

Pjesë e këtij rishikimi u bë edhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike, si fillim në sigurimin e rezultateve të arritura gjatë kryerjes së procesit të kontrollit të cilësisë. Një kriter i vendosur nga Banka Botërore për të qenë subjekt i përzgjedhjes për rishikim ishte dhe ndarja e rezultateve të kontroleve të cilësisë së realizuar nga BMP dhe pjesëmarrja e inspektorëve të BMP' së gjatë procesit të vlerësimit.

Tre shoqëri auditimi shfaqën interes për t'u bërë pjesë e këtij vlerësimi, i cili u planifikua të realizohej gjatë muajit dhjetor 2020.

Faza e dytë përfshin vizitën në terren, gjatë të cilës u realizuan takime me drejtimin e shoqërisë së auditimit dhe rishikimit të një kampioni të dosjeve të angazhimit të auditimit dhe fletëve të punës. Ky proces rishikimi u realizua nga një ekip i përbërë nga specialisti i lartë i menaxhimit financiar të dhe konsulentit të jashtëm të angazhuar nga Banka Botërore dhe dy inspektorë të lartë të kontrollit të cilësisë nga BMP.

Në fazën e tretë, në vijim të vizitës në terren dhe shqyrtimit të informacionit të mbledhur gjatë rishikimit të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë dhe angazhimit të auditimit në shoqëritë e auditimit, realizohet edhe komunikimi i rezultateve të rishikimit.

7.2. Vlerësimi i zbatimit të planit të veprimit në vijim të procesit të kontrollit për sigurimin e cilësisë

Në tremujorin e katërt të vitit, ekipi i inspektimit të strukturës mbështetëse të BMP-së filloi punën për realizimin e procesit të vlerësimit të zbatimit të planit të veprimit në vijim të realizimit të procesit të kontrollit të cilësisë pranë shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë të realizuar gjatë vitit 2018.

Qëllimi i këtij vlerësimi përfshin rishikimin e masave të ndërmarra nga shoqëria e auditimit si përgjigje e dobësive/gjetjeve të dala nga kontrolli i cilësisë i realizuar nga inspektorët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike nëpërmjet:

- (i) rishikimit dhe testimit të ndryshimeve të ndërmarra në nivel të sistemit të kontrollit të cilësisë së audituesit ligjorë/shoqërisë së auditimit, dhe
- (ii) rishikimet dhe testimet e ndryshimeve në nivel të angazhimeve të auditimit/të angazhimeve të tjera për ato gjetje të raportuara në zbatim të standardeve të auditimit dhe të raportimit financiar.

Procesi është hartuar i tillë që të ndodhë në dy faza:

Në fazën e parë u kërkua dërgimi i informacioneve mbi: (i) vetëvlerësimin e zbatimit të masave të ndërmarra në nivel të sistemit të kontrollit të cilësisë dhe në nivel të angazhimeve; (ii) komunikimet me rrjetin përsa i përket kontrollit të cilësisë së realizuar nga rregullatori, nëse ka/nëse është e aplikueshme; (iii) raporte të monitorimit prej rrjetit apo të brendshme të realizuara (kur nuk janë pjesë e rrjetit) nëse ka pasur/nëse është e aplikueshme; (iv) informacione të tjera

Në fazën e dytë, ekipi i inspektorëve në bazë të një analize racionale do të vendosë për testimin në distancë apo për testimin në terren, në mbështetje dhe në respektim të dispozitave dhe masave të ndërmarra për Covid-19, të informacionit/dokumentacionit të siguruar sipas pikës 1 më lart si dhe mundësisë që shoqëria e auditimit/audituesi ligjor ofron për qasjen në distancë në angazhimin/angazhimet e përzgjedhura.

7.3. Inspektimet tematike në zbatim të rregullores nr. 12, datë 02.07.2020 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”

Gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2020 u hartua plani i inspektimit me qasje në rrezikun e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në kuadër të planit të veprimit

miratuar me vendim nr. 1, datë 19.02.2020 të Komitetit të Bashkëndimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave me qëllim realizimin e kërkesave të grupit të punës ICRG/FATF dhe në zbatim të metodologjisë së mbikëqyrjes të bazuar në rrezikun e parandalimit dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në rregulloren nr. 12, datë 02.07.2020 “*Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*”, udhëzuesin për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit dhe manualit për mbikëqyrjen e subjekteve parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.

Metodologjia e zbatuar përmirëson efikasitetin e kontroleve të PPP/FT gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut dhe siguron një kuptueshmëri më të mirë të rrezikut të PP/FT duke i mundësuar BMP-së fokusin në fushat me rrezik të lartë, por edhe për subjektet raportuese. Metodologjia e bazuar në rrezik e BMP-së ka për qëllim të parandalojë cenimin nga PP/FT para ndodhjes së ngjarjes.

Procesi i kontrollit u realizua sipas fazave në vijim:

Mbledhja e informacionit: Gjatë muajit shtator deri në mes të muajit tetor subjektet auditues ligjorë raportues kanë paraqitur informacionin nëpërmjet *Aneks - Modeli i miratuar i deklaramit të të dhënave për PPP-FT (pyetësor statistikor)* për mbledhjen e të dhënave për popullimin e matricës së rrezikut. Gjatë kësaj periudhe kemi patur një komunikim intensiv me subjektet raportuese për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi rolin e tyre në kuadrin e mbikëqyrjes me bazë rrezikun në PPP/FT dhe rëndësisë së kryerjes së procesit të vlerësimit të rrezikut nga ana e tyre.

Zhvillimi i matricës së rrezikut: Matrica e rrezikut është hartuar duke marrë parasysh rreziqet e identifikuar në burimet e mëposhtme të informacionit (Tetor 2020):

- i. Nga dokumenti i Vlerësimit Kombëtar të Riskut të PP/FT në Shqipëri (NRA) është integruar rreziku i ekspozimit të subjekteve të mbikëqyrura nga BMP ndaj: a) rrezikut nga ekonomia informale dhe përdorimit në shkallë të gjerë të parasë fizike; b) rreziku i vetvetishëm i OJF-ve; sidoqoftë audituesit ligjorë dhe kontabilistët e miratuar janë të klasifikuar si subjekte me rrezik të mesëm;
- ii. Vlerësimi sektorial i rrezikut (rreziqet nga personat juridikë dhe rreziku i audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar si pjesë e sektorit të DNFBP (numri i raportimit të RAD & RTPF nga audituesit ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar; rreziku i personave juridikë siç janë firmat e ndërtimit etj.);
- iii. Vlerësimi i rrezikut nga mbikëqyrësi (ekspozimi i subjektit raportues ndaj PP/FT; struktura e firmës së auditimit; përshtatshmëria e programit PPP/FT, numri i punonjësve, etj).

Procesi i përzgjedhjes së shoqërisë së auditimit/audituesit ligjor: Në vijim të popullimit të matricës së rrezikut është realizuar pikëzimi i subjekteve raportuese dhe është përfutur rezultati sipas renditjes së pikëve. Niveli i rrezikut përcaktohet në bazë të sistemit të pikëzimit me katër nivele si më poshtë:

<u>Niveli i rrezikut</u>	<u>Pikët</u>
Rrezik i Ulët	0 – 6
Rrezik i Mesëm	7 – 12
Rrezik i lartë	13 – 20
Rrezik i lartë	Subjekte që nuk raportojnë

Nga kombinimi i faktorëve të rrezikut, u përzgjedhën 8 subjekte dhe u planifikua realizimi i vizitës në terren në periudhat nëntor - dhjetor 2020 dhe janar - maj 2021.

Vizita e inspektimit në terren: Në këtë fazë është realizuar vizita në shoqërinë e auditimit/audituesin ligjor të përzgjedhur për inspektim, duke filluar me një takim fillestar me drejtimin e shoqërisë së auditimit. Inspektorët në këtë takim kanë prezantuar në mënyrë të përmbledhur qëllimin e kontrollit, kohëzgjatjen e parashikuar të punës pranë shoqërisë, është konfirmuar marrja e informacionit të kërkuar, janë përzgjedhur dosjet e angazhimeve të cilat do të rishikohen. Gjatë kësaj faze u zhvilluan diskutime mbi efektivitetin e programit të PPP/FT, duke përfshirë politikën, procedurat dhe proceset, dokumentimin e vlerësimit të rrezikut, trajnimet, monitorimin, mënyrën e ruajtjes së informacionit në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara në ligjin për PPP/FT, për mbajtjen e regjistrave dhe analizave të kryera, zbatimin e masave të vigjilencës së duhur dhe vigjilencës së zgjeruar nëpërmjet verifikimit të dosjeve të subjektit dhe dokumentimit të procedurave të realizuara, etj.

Raportimi: Në përfundim të kryerjes së kontrollit, ekipi i inspektimit ka shpallur në raportin e kontrollit një vlerësim të subjektit mbi sistemin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe pajtueshmërisë me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit, për periudhën që mbulon programin e inspektimit deri në datën e vizitës në terren.

Shoqërisë së auditimit/audituesit ligjor iu la si detyrë hartimi i një plani veprimi për adresimin e mangësive/rekomandimeve të shpallura në raportin e kontrollit me përmbajtje:

- (i) mangësinë e identifikuar/rekomandimin;

- (ii) personin përgjegjës;
- (iii) masat që do të ndërmarrë për adresimin e mangësive/rekomandimeve; dhe
- (iv) afatin për realizimin e masave.

7.3.1 Rekomandime për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit

Në përfundim, në raportin e kontrollit të hartuar, u dhanë rekomandime për çështjet si në vijim:

- Përmirësime dhe përditësime në rregulloren e parandalimit të pastrimit të parave në përputhje me kërkesat në kuadrin ligjor dhe rregullator për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Hartimi i dokumentit të vlerësimit të rrezikut të PPP/FT në përputhje me kërkesat e kuadrin ligjor dhe rregullator për PPP/FT;
- Hartimi i politikave dhe procedurave përsa i përket klasifikimit të rrezikut të klientit dhe masave të vigjilencës që do të ushtrohen nga shoqëria e auditimit;
- Realizimi i monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies me klientin dhe transaksioneve të realizuara, në mbështetje të masave të zbatueshme të vigjilencës;
- Kryerja e proceseve të kontrollit të brendshëm përsa i përket plotësisë së dokumentacionit në zbatim të masave të kërkuara të vigjilencës;
- Përmirësime në dokumentimin e trajnimeve të organizuara nga shoqëria e auditimit/audituesi ligjor për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Identifikimi, vlerësimi dhe krijimi i kuptueshmërisë mbi rreziqet e PPP/FT për klientët, vendet apo zonat gjeografike, produktet, shërbimet, transaksionet apo kanalet e shpërndarjes, përcaktimi dhe zbatimi i masave të vigjilencës në përputhje me vlerësimin e rrezikut;
- Dokumentimi i kërkimeve të realizuara në burime të hapura dhe rezultatet e kërkimeve në informacionin në portalin e DPPP, gjatë procesit të pranimit/vazhdimin të klientit;
- Dokumentimi i analizës së transaksioneve të kryera nga klientët për të cilat siguron shërbime dhe raportimi pranë Autoritetit Përgjegjës dhe/ose autoritetit mbikëqyrës nëpërmjet formularëve RAD, kur identifikon raste të dyshimta;
- Krijimi i sistemit të centralizuar për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave në zbatim të kërkesave të kuadrin ligjor dhe rregullator për PPP/FT;

- Dokumentimi në dosjet përkatëse të klientëve të kërkimeve dhe verifikimeve të kryera në përputhje me verifikimin e listave të personave të shpallur (TFS) dhe kryerjen e kontrollit në burimet e hapura gjatë pranimit/vazhimit të marrëdhënieve me klientin, në zbatim të ligjit nr. 157, datë 10.10.2013 “Për masat e marra kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.

8. Masat e marra ndaj subjekteve të ndryshëm

Përgjatë vitit 2020, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, në kuadër të veprimtarisë mbikëqyrëse dhe rregulluese të përcaktuar në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 4, datë 29.03.2019 “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”, bazuar në rrethanat dhe faktet e shqyrtuara prej tij, ka marrë 26 masa disiplinore për auditues ligjorë/shoqëri auditimi. Prej tyre, 1 është pezullim licence, 2 pezullime të përkohshme, 2 pezullime të ushtrimit të profesionit për 15 ditë dhe 2 vite, ndërsa pjesa tjetër e masave disiplinore kanë qenë gjoba.

9. Mbikëqyrja e organizatave profesionale

9.1. Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar

Bazuar në rregulloren nr. 9, datë 27.02.2019 “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të kontabilistit të miratuar dhe organizatave të tyre profesionale”, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka vazhduar mbikëqyrjen pranë OP të Kontabilistëve të Miratuar.

Rregullorja nr. 9 është hartuar në bazë të nenit 1, pika 1 dhe 2; nenit 2, pika 6; nenit 5, pika 2; nenit 51, pika 1, 2 dhe 3, të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

BMP ka vijuar me procedurat mbikëqyrëse për zhvillimet për njohje nga Organizata të Kontabilistëve të Miratuar, përkatësisht Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë (SHKFSH).

Inspektorët e BMP-së kanë shqyrtuar dokumentacionin tashmë të përpunuar të kësaj organizate, nga materialet e dërguara nga vetë SHKFSH.

Disa nga materialet e shqyrtuara janë:

1. Kërkesa e Organizatës Profesionale për njohje;
2. Statuti i organizatës;
3. Rregullore e Kualifikimit të Vijuëshëm Profesional;
4. Manuali i Etikës për anëtarët e SHKFSH;
5. Rregullorja e Disiplinës dhe Investigimit;
6. Rregullorja e Regjistrimit të anëtarësisë (hyrja dhe dalja nga profesioni);
7. Rregullorja e kontrollit dhe e garantimit të cilësisë së shërbimeve kontabël;
8. Format i regjistrimit që përdor Organizata;
9. Rregullorja për përzgjedhjen e Trajnerëve për kualifikimet;
10. Informacione për raportime të brendshme të kontrollit të cilësisë;
11. Programi i Kualifikimeve për vitet 2015-2019 dhe lista e pjesëmarrësve;
12. Kontratat me Trajnerët.

Në fund të këtij procesi, u paraqit një material pranë BMP-së dhe u mor vendimi për njohjen me kusht të SHKFSH në dhjetor 2020.

Për sa më sipër, në vitin 2020, nën mbikëqyrjen e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, njihen vetëm 2 (dy) organizata profesionale për kontabilitetin, IKM dhe SHKFSH, e cila njihet me kusht

sipas rekomandimeve përkatëse dhe në proces njohje vetëm pasi të përmbushen kushtet që rrjedhin nga detyrimet ligjore dhe kuadri rregullator në fuqi.

9.2. Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Audituesve Ligjorë

Në mbështetje të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë (IEKA) është subjekt i mbikëqyrjes prej Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Ligji i sipërcituar parashikon që disa nga veprimtaritë lidhur me profesionin kryhen nga Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë, nën mbikëqyrjen dhe rregullimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Gjatë vitit 2020, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka ushtruar mbikëqyrjen e mbledhjeve të Komitetit të Regjistrimit, ku, nëpërmjet personit të ngarkuar për realizimin e mbikëqyrjes, ka marrë pjesë në dy mbledhje.

Në periudhën tetor – nëntor 2020, ekipi i strukturës mbështetëse të BMP-së ka qenë i pranishëm si pjesë e aktiviteteve mbikëqyrëse për monitorimin e programit të edukimit të vijueshëm të anëtarëve të IEKA-s të realizuar nga kjo e fundit.

Përgjatë veprimtarisë së tij, në mbështetje të kuadrit rregullator, është rritur bashkëpunimi midis dy institucioneve përsa i përket:

- Informacionit dhe mënyrën e organizimit të edukimit të vijueshëm të anëtarëve ushtrues si dhe audituesve ligjorë jo ushtrues;
- Informacionit lidhur me veprimtarinë e Komitetit të Regjistrimit dhe zbatimin e rregullores së regjistrimit përmes të cilave mundësohet verifikimi lidhur me pastërtinë e figurës së ortakëve të firmave të auditimit dhe problematika potenciale në mbështetje të dispozitave të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave;
- Publikimit të masave të marra nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike lidhur me audituesit ligjorë subjekt i këtyre vendimeve;
- Publikimit të përkthimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit të rishikuara, në faqen zyrtare të IEKA-s;

Dhe kanë vijuar të ndeshen problematikat të lidhura me:

- Informacione të lidhura me veprimtari në lidhje me Komisionin e Investigimit dhe Disiplinës së Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë;

- Vënien në dispozicion sipas afateve të përcaktuara në kuadrin rregullator lidhur me detyrimet që rrjedhin nga rregulloret që lidhen me procesin e provimeve të aftësive profesionale për kandidatët për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar;
- Plotësimin e detyrimeve financiare në mbështetje të rregullores nr. 1, datë 27.07.2017, e ndryshuar, për financimin e aktiviteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
- Të tjera.

Sa më sipër, mbështetur në kuadrin rregullator në fuqi, Bordi Mbikëqyrjes Publike ka kërkuar nga Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë zbatimin e detyrimeve ligjore dhe kuadrin rregullator, si dhe ka ndërmarrë veprimet në vijim:

- Për të gjitha çështjet e lidhura me deklarin e misioneve të auditimit është kërkuar informacion nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me audituesit ligjorë;
- BMP ka ngritur një grup pune më përfaqësues nga të gjitha institucionet e lidhura me profesionin si dhe ekspertë nga rajoni apo të certifikuar në Mbretërinë e Bashkuar apo vendet e Komunitetit Evropian për të kontribuar në implementimin e rekomandimeve të Bankës Botërore.

Për të gjitha hapat e mësipërme, përveç vënies në dijeni të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, është vënë në dijeni anëtarësia si organi më i lartë vendimmarrës i kësaj organizate, dhe është kërkuar zbatimi i të gjitha këtyre detyrimeve si një hap përfundimtar përpara se të ndiqen hapat e tjerë ligjorë.

9.3. Inspektimi tematik pranë Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë

Në zbatim të ndryshimeve të miratuara me vendimin nr. 31 të BMP-së, datë 28.05.2020, në rregulloren nr. 10, datë 11.06.2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të regjistrimit dhe përditësimin e regjistrit publik”*, e ndryshuar, u realizua edhe procesi i mbikëqyrjes së veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit dhe Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, nëpërmjet inspektimit tematik të realizuar gjatë periudhës 16 - 27 nëntor 2020.

Gjithashtu, vlen të theksohet se ky inspektim ishte pjesë e planit të veprimit të miratuar me vendim nr. 1, datë 19.02.2020 të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave me qëllim realizimin e planit të veprimit, adresimit të kërkesave të grupit të punës ICRG/FATF për parandalimin e infiltrimit të kriminelëve në subjektet e licencuar auditues ligjorë dhe në interesat kontrollues të shoqërive të auditimit nga individë që nuk janë auditues ligjorë.

Inspektimi tematik, që mbuloi periudhën Korrik 2019 - Tetor 2020, kishte për qëllim vlerësimin e:

- ✓ Pajtueshmërisë së veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit me kërkesat e rregullores nr. 10, datë 11.06.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të regjistrimit dhe përditësimin e regjistrimit publik”, e ndryshuar;
- ✓ Pajtueshmërisë me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi dokumentacionin e dosjeve të regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit në regjistrin publik;
- ✓ Pajtueshmërisë së veprimtarisë së Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë (IEKA) me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi mbajtjen dhe përditësimin e regjistrimit publik të audituesve ligjorë.

Si një proces që u realizua për herë të parë pranë Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, ekipi i inspektimit u mbështet nga kryetari i Komitetit të Regjistrimit, duke krijuar një mjedis bashkëpunues dhe konstruktiv për arritjen e qëllimit të inspektimit, pavarësisht skepticizmit të stafit ekzekutiv të organizatës profesionale.

Gjatë vizitës në terren u siguruan të dhënat e regjistrimit dokumentar të mbajtur nga Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë, dokumentacioni i veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit, 34 dosje të audituesve ligjorë dhe 15 dosje të shoqërive të auditimit të përzgjedhura për realizimin e procedurave të inspektimit dhe verifikimit të dokumentacionit.

Çështjet kryesore që u konstatuan nga ekipi i inspektimit janë si në vijim:

- Mbi veprimtarinë e Komitetit të Regjistrimit:
 - Përbërja e Komitetit të Regjistrimit nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e pikës 5 të nenit 2 të rregullores nr. 10, datë 11.06.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të regjistrimit dhe përditësimin e regjistrimit publik”, e ndryshuar;
 - Nuk është hartuar dhe dërguar raporti i veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit;
 - Mangësi në plotësinë e referencave relevante në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, mbi të cilin është mbështetur vendimmarrja e KR;
 - Çështje të ndryshme procedurale përsa i përket formulimit të rendit të ditës, procesverbaleve, relacioneve dhe dokumentacionit të mbledhjeve të Komitetit të Regjistrimit.
- Mbi procedurat për mbajtjen dhe përditësimin e regjistrimit publik nga Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë:
 - Regjistri publik nuk përmban të gjithë elementët në përputhje me kërkesat e nenit 28 dhe 29 të ligjit 10091/2009, i ndryshuar;
 - Nuk është realizuar publikimi i informacionit të detyrueshëm në regjistrin publik, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator;

- Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë nuk ka në përdorim një manual/udhëzues të përkthyer në politika dhe procedura, për mënyrën e aksesit, administrimit dhe arkivimit të dokumentacionit të audituesve ligjorë dhe regjistrin publik të audituesve ligjorë;
 - Nuk realizohet nga sekretaria teknike procesi i ndjekjes së plotësisë të kushteve pas vendimit të Komitetit të Regjistrimit në rastet e kërkesave për pezullim, për çregjistrim të shoqërive të auditimit.
- Dokumentacioni i dosjeve të regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit në regjistrin publik:
- Janë ndeshur në mangësi përsa i përket plotësisë dhe përditësimit të dokumentacionit të dosjeve të regjistrimit, kryesisht në dokumentet e identifikimit jo të përditësuara, vërtetimet të gjendjes gjyqësore jo të kohëve të fundit.

Në përfundim të vizitës në terren, ekipi i inspektimit realizoi një takim përmbyllës me Kryetarin e Këshillit të Drejtimit, Kryetarin e Komitetit të Regjistrimit dhe stafin ekzekutiv të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, ku u komunikuan gjetjet dhe mangësitë kryesore të identifikuara dhe u theksua rëndësia e realizimit të përmirësimeve në funksion të zbatimit të kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator dhe nxitur frymën e bashkëpunimit në realizimin e mbikëqyrjes së profesionit të auditimit.

Disa prej rekomandimeve kryesore për përmirësim u dhanë për çështjet si në vijim:

- (i) Në nivel të rishikimit të veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit u rekomandua:
- Marrja e masave në lidhje me përbërjen e Komitetit të Regjistrimit, duke emëruar një anëtar që nuk mban funksion ekzekutiv pranë Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, në pajtueshmëri me pikën 5, të nenit 2, të rregullores nr. 10, datë 11.06.2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të regjistrimit dhe përditësimin e regjistrin publik”*, e ndryshuar;
 - Hartimi dhe dërgimi pranë BMP-së i raportit të veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit;
 - Përmirësimi i formulimit të referencave relevante në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi të vendimeve të Komitetit të Regjistrimit;
 - Përmirësime në formulimin e rendit të ditës, procesverbaleve, relacioneve dhe dokumentacionit të mbledhjeve të Komitetit të Regjistrimit.

- (ii) Në nivel të rishikimit të procedurave të administrimit të procesit të regjistrimit dhe mbajtjes dhe përditësimit të regjistrimit publik nga Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë u rekomandua:
- Plotësimi i regjistrimit publik i audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit me të gjithë elementët në përputhje me kërkesat e nenit 28 dhe 29, të ligjit 10091/2009, i ndryshuar;
 - Publikimi i informacionit të detyrueshëm në regjistrin publik në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator;
 - Hartimi i një manuali/udhëzuesi i përkthyer në politika dhe procedura, për mënyrën e mbajtjes, aksesit, administrimit dhe arkivimit të regjistrimit publik dhe dokumentacionit të audituesve ligjorë dhe regjistrimit publik të audituesve ligjorë;
 - Realizimin e procesit të ndjekjes së plotësimit të kushteve pas vendimit të Komitetit të Regjistrimit në rastet e kërkesave për pezullim, për çregjistrim të shoqërive të auditimit.
- (iii) Në nivel të rishikimit të dokumentacionit të dosjeve të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit u rekomandua:
- Plotësimi dhe përditësimi i dokumentacionit në dosjet e të gjithë shoqërive të auditimit dhe audituesve ligjorë në përputhje me kërkesat e ligjit 10091/2009, i ndryshuar dhe kërkesat e rregullores nr. 10, datë 11.06.2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të regjistrimit dhe përditësimin e regjistrimit publik”*, e ndryshuar.

10. Aktivitetet me institucionet homologe dhe institucionet e tjera

10.1. Webinar mbi çështjet e papajtueshmërisë ligjore dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Më datë 30 korrik 2020, Bordi i Mbikëqyrjes Publike organizoi webinar-in mbi çështjet e papajtueshmërisë ligjore dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ku morën pjesë rreth 150 auditues ligjorë.

Në këtë webinar u prezantuan temat si në vijim:

1. *“Mbi çështjet ligjore të identifikuara gjatë procesit të investigimit”* u prezantuan dhe trajtuan në mënyrë të përmbledhur çështjet mbi:

- misionin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
- auditimin e shoqërive aksionare dhe ato që raportojnë me SNRF;
- publikimin e raportit të transparencës nga të gjithë audituesit ligjorë që kanë audituar shoqëri me interes publik;
- marrëdhëniet e punësimit të audituesve, papajtueshmëritë në ushtrimin e profesionit dhe zbatimin të dispozitave për kushtet dhe kërkesat e ushtrimit të profesionit të audituesit ligjor;
- afatet kohore dhe tarifën orare të auditimit;
- edukimin e vijueshëm profesional;
- raportet e auditimit, kërkesat për përmbajtjen dhe siglimin e raportit të audituesit;
- zbatimin e detyrimeve ligjore që lidhen me çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- verifikimin e dokumentacionit të aksionarëve dhe personave të angazhuar në organet drejtuese të cilët nuk janë auditues ligjor.

2. *“Rregullore Nr. 12 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”* u prezantuan dhe trajtuan në mënyrë të përmbledhur çështjet lidhur me:

- kuadrin e zbatueshëm ligjor;
- objektin e rregullores;
- masat e vigjilencës;
- strukturat përgjegjëse;
- raportimin tek autoriteti përgjegjës (DPPPP);
- kërkesat mbikëqyrëse;
- inspektimet;
- udhëzuesin për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit;
- procesin e vlerësimit të rrezikut.

10.2. Webinar mbi plotësimin e formularit të deklaramit të të dhënave për PPP-FT

Më datë 4 shtator 2020, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, si rezultat i pyetjeve e kërkesave të shumta të ardhura nga ana e audituesve ligjorë mbi plotësimin e formularit “*Aneks - Modeli i miratuar i deklaramit i të dhënave për PPP-FT*”, organizoi një webinar në formën pyetje-përgjigje, lidhur me udhëzimet teknike për plotësimin e tij. Në këtë webinar morën pjesë 159 auditues ligjorë.

Në vijim të webinar-it të realizuar audituesit ligjorë paraqitën raportimet e tyre, të cilat u përdorën më pas për realizimin e inspektimeve tematike për çështje të PPP-FT.

10.3. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Moneyval

Bordi i Mbikëqyrjes Publike në mënyrë të vazhdueshme ka vijuar bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të vënë në zbatim të gjitha kërkesat që vijnë nga rekomandimet e Komitetit Moneyval dhe nga FATF për matjen e efektivitetit të zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Gjatë vitit 2020 ka vijuar bashkëpunimi me DPPPP dhe janë kryer aktivitete bashkë inspektimi me tematikë çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në shoqëri auditimi.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka marrë pjesë në forumin virtual të mbikëqyrësve të profesioneve të lira jo-financiare nga FATF ku morën pjesë mbi 500 institucione mbikëqyrëse dhe autoritete rregullatore të profesioneve të lirë nga e gjithë bota. Në këtë forum u diskutuan sfidat e mbikëqyrjes së profesioneve të lira jo – financiare, ku bëjnë pjesë edhe audituesit ligjorë dhe kontabilistët e miratuar, strategjia për ngritjen e sistemeve të mbikëqyrjes me qasje në rrezikun e PP/FT, diskutim nga Departamenti i Drejtësisë dhe Barazisë së Irlandës dhe specialistë të lartë të financave të Bankës Botërore.

Dokumenti i vlerësimit kombëtar i riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Shqipëri është një tjetër bashkëpunim i rëndësishëm me DPPPP. Në këtë dokument analizohet dhe vlerësohen përmirësimet në kuadrin ligjor dhe rregullator të profesionit të auditimit ligjor dhe kontabilistit të miratuar si edhe nëpërmjet analizës sektoriale realizohet një vlerësim i rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për profesionistët kontabël. Në vlerësimin kombëtar të riskut, profesioni i audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar u vlerësua me rrezik të mesëm.

Kjo analizë ka shërbyer edhe në realizimin e vlerësimit të rrezikut për inspektimet tematike me qasje në rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

10.4. Roli dhe kontributi i BMP në raportimin në FATF

Plenarja e parë e FATF 2020 e konfirmoi vendin tonë në proces monitorimi të përforcuar nga Komiteti Moneyval, si dhe njëkohësisht në një periudhë monitorimi nga ICRG (pjesë e FATF), në këto kushte u ndërmor një angazhim të nivelit të lartë politik për të punuar me FATF dhe MONEYVAL për të forcuar efektivitetin e regjimit të saj PPP/FT.

Në këtë frymë të lartë angazhimi për bashkëpunim, Bordi i Mbikëqyrjes Publike u bë pjesë e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar sipas vendimit nr. 1, datë 19.02.2020 i Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave. Me kryesimin e Zv/Kryeministrit, janë realizuar takime intensive virtuale në kuadër të organizimit të punës dhe raportimit të ecurisë nga të gjitha institucionet, për zbatimin e planit të veprimit të grupit të rishikimit të bashkëpunimit ndërkombëtar i FATF (ICRG/FATF), me qëllim nxjerrjen e Shqipërisë nga lista e vendeve me monitorim të përforcuar.

Një memorandum bashkëpunimi u nënshkrua midis Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave përsa i përket raportimit të ecurisë dhe përmbushjes së detyrave të ICRG/FATF.

Ndër detyrat më të rëndësishme të realizuara nga BMP, si autoritet rregullator dhe mbikëqyrës i profesionit të auditimit ligjor dhe kontabilistit të miratuar renditen:

- 1) Rritja e efektivitetit në masat e parashikuara nga kuadri ligjor dhe rregullator për zbulimin dhe parandalimin e kriminelëve që synojnë të mbajnë, kontrollojnë apo të hyjnë në profesionin e audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar;
- 2) Hartimi dhe zbatimi i mbikëqyrjes me qasje në rrezikun e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- 3) Sigurimi dhe zbatimi i kompetencave për zbatimin e masave disiplinore.

Me mbështetjen e vazhdueshme të DPPP, i cili në këtë proces ka kryer funksionin e sekretariatit teknik, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka qenë pjesë e delegacionit Shqiptar në tryezat virtuale të organizuara për raportimin e ecurisë së zbatimit të planit të veprimit me ekspertët vlerësues të grupit ICRG/FATF. Gjatë muajit të parë të vitit 2021, në raportin e vlerësimit të progresit për realizimin e rekomandimeve dhe zbatimit të planit të veprimit këto detyra u vlerësuan si gjerësisht të adresuara.

Megjithatë, puna dhe bashkëpunimi intensiv me grupin ndërinstitucional të punës për nxjerrjen e vendit nga lista e vendeve me monitorim të shtuar mbetet ndër detyrat prioritare e Bordit të Mbikëqyrjes Publike edhe në vitin në vijim.

10.5. Bordi i Mbikëqyrjes Publike anëtar i IFIAR

Që nga 12.09.2011, Bordi i Mbikëqyrjes Publike vijon të jetë anëtar i IFIAR - Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit. Ky forum është një shoqatë e rregullatorëve të pavarur të auditimit nga 55 juridiksione, të dedikuara për përmirësimin e cilësisë së auditimit dhe nxitjen e bashkëpunimit rregullator në fushën e mbikëqyrjes së audituesve për t'i shërbyer interesit publik dhe për të rritur mbrojtjen e investitorëve.

Objektivat kryesore të IFIAR janë:

- Shkëmbimi i njohurive dhe përvojës në fushën e auditimit me qëllim kryesor kontrollin e cilësisë së audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit;
- Të nxisë bashkëpunimin në veprimtarinë rregullator ndërmjet anëtarëve të IFIAR;
- Mundësimi i një platforme të dialogut me organizata të tjera ndërkombëtare që kanë një interes në cilësinë e auditimit.

Përmes bashkëpunimit me IFIAR, BMP mund të marrë shumë informacione të tilla si:

Informacion rreth aktiviteteve të IFIAR. Ky zakonisht është informacion përshkruar dhe procedural i cili mbulon kryesisht çështjet organizative dhe procedurale të pranuar nga Anëtarët, duke përfshirë, për shembull, informacione të përgjithshme rreth organizatës dhe funksionet e saj, kartën e saj, anëtarësimin, procedurat e saj operative dhe oraret dhe programet e takimeve të ardhshme.

Informacion rreth rezultateve të IFIAR dhe produkteve të punës. Ky zakonisht është informacion thelbësor dhe është miratuar nga anëtarësia, duke përfshirë, për shembull, vendimet e anëtarëve (parimet bazë, planet e punës), raportet vjetore, anketat (gjetjet e inspektimit), dokumentet informative dhe sfondin mbi lëndët e përzgjedhura, dokumentet e diskutimit dhe njoftimet për shtyp lidhur me mbledhjet plenare.

Pikëpamjet dhe qëndrimet e IFIAR për temat specifike të lidhura me politikën në të dy standardet dhe çështje jo standarde, të kërkuara nga një organizatë tjetër, ose të iniciuar nga Zyrtarët, Grupet e Punës ose anëtarët individualë. Kjo është shumë e rëndësishme për IFIAR-in të rritet shikueshmëria e tij publike, por gjithashtu është e rëndësishme për ne si anëtarë, për të shprehur dhe shkëmbyer komentet dhe sugjerimet tona në lidhje me temat e lartpërmendura.

Komunikime të tjera të tilla si informacioni rreth monitorimit të Grupit apo të zhvillimeve të ardhshme. Ky komunikim do të lejojë që anëtarësimi të përditësohet në natyrën dhe përmbajtjen e kontakteve të tyre të jashtme në çështjet e IFIAR, duke përfshirë njoftimin e anëtarëve për pjesëmarrjen e tyre në takimet me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe paraqitjen e tyre publike në emër të IFIAR.

BMP ka mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me IFIAR përmes mënyrave të ndryshme me qëllim që të shkëmbejë përvojën dhe pjesëmarrjen e saj në aktivitete, të organizuara nga IFIAR,

duke u përditësuar me tendencat e fundit rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe për aplikimin e parimeve dhe praktikave më të mira. Gjithashtu, një faktor i rëndësishëm për intensifikimin në kontaktet me homologët ka qenë dhe mbetet nevoja e harmonizimit të rregullatorit për legjislacionin e raportimit financiar me Direktivat e BE-së.

Gjatë vitit 2020 është realizuar raportimi në IFIAR për sa në vijim:

- Të dhëna statistikore mbi tregun e auditimit dhe inspektimeve të realizuara si p.sh numrin e shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë, numri i angazhimeve të auditimit të kontrolluara, etj;
- Informacion mbi nevojat për trajnim në funksion të rritjes së kapaciteteve të strukturës mbështetëse të BMP-së;
- Në tremujorin e tretë të çdo viti raportohet në IFIAR mbi të dhënat e gjetjeve të inspektimit;
- Pyetëtori i Grupit të Punës së Masave Disiplinore IFIAR Enforcement Working Group (EWG);
- BMP, si anëtar i IFIAR, shpreh mendimin nëpërmjet të drejtës së votimit mbi çështje të ndryshme të anëtarësisë si p.sh:
 - Pranimin e mbikëqyrësve nga vende të ndryshme si anëtarë të rinj të IFIAR;
 - Miratimin e raportit vjetor të analizës së gjetjeve të inspektimit;
- Raportimi si pjesë e IRDAM TF mbi pyetësin mbi çështjet e politikave relevante në zbatim sipas juridiksionit të vendeve anëtare të IFIAR.

Pyetëtori synon të marrë një pasqyrë të përgjithshme të matjeve kryesore të tregut të auditimit dhe kërkesave rregullatore në 5 fusha kryesore:

- Përqendrimi i tregut;
- Zgjedhja dhe emërimi i auditorit;
- Kombinimi i shërbimeve të auditimit dhe jo-auditimit;
- Transparenca dhe dhënia e informacionit;
- Qeverisja, kontrollet e brendshme dhe kultura organizative.

10.6. Bordi i Mbikëqyrjes Publike anëtar i IRDAM

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, që prej muajit Qershor të vitit 2019, vijon të jetë i përzgjedhur si anëtar i task forcës për zhvillimet e rëndësishme ndërkombëtare në tregjet e auditimit (IRDAM). Anëtarësimi në këtë task forcë përveçse ishte një vlerësim tepër i madh pasi ishte hera e parë që vlerësohej pozitivisht një institucion shqiptar i cili vepron në fushën e kontabilitetit, duke u përzgjedhur në struktura kaq të rëndësishme të një prej organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e profesionit kontabël, ishte edhe një përgjegjësi e rëndësishme që kërkonte impenjim dhe kapacitete profesionale të dedikuara për t'ju përgjigjur obligimeve teknike për tregjet ndërkombëtare të auditimit. BMP u zgjodh në datën 26 Qershor

2019 si anëtar i Task Force të Forumit Ndërkombëtar të Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit (IFIAR) në të cilin është anëtar me të drejta të plota.

Task Force përbëhet nga: Abu Dhabi, Shqipëria, Kanadaja, Franca, Italia, Irlanda, Japonia, Zelanda e Re, Norvegjia, Arabia Saudite, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cilat kanë mbështetjen e Bordit të IFIAR.

Objektivat kryesore të kësaj Task Force lidhen me monitorimin e zhvillimeve të rëndësishme brenda juridiksioneve të vendeve anëtare të IFIAR, për të analizuar ndikimin e këtyre zhvillimeve në tregun e auditimit dhe ndikimin e tyre potencial në cilësinë e auditimit.

Një zgjedhje e tillë është një vlerësim për kapacitetet e BMP-së për të realizuar funksionet e veta në mënyrë sa më të suksesshme, jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij.

10.7. CFRR

Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR) e vendosur në Vjenë, Austri, është përgjegjëse për aktivitetet e raportimit financiar të Bankës Botërore në të gjithë Evropën dhe rajonin e Azisë Qendrore. Qendra ofron shërbime të njohurive dhe ndihmë për zhvillimin e kapaciteteve. Shërbimet përfshijnë shërbime analitike dhe këshilluese, zhvillimin e mësimin dhe aftësive, njohuri dhe transferim të njohurive, asistencë teknike si dhe forcim institucional.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, përmes projekteve të Bankës Botërore për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve rregullatore dhe organizatave profesionale në fushën e auditimit dhe kontabilitetit, ka bashkëpunuar në mënyrë të vijueshme me Bankën Botërore në kuadër të përmirësimit të rolit mbikëqyrës dhe përmirësimit të cilësisë së auditimit ligjor dhe raportimit financiar.

Banka Botërore organizoi në shkurt 2020 një seminar për shpalosjen e raportit mbi zbatimin e standardeve dhe kodeve në kontabilitet dhe auditim (ROSC A&A). Ky event bashkoi përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, organizatat profesionale të audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar, përfaqësues të mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si edhe anëtarë të komunitetit të donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare.

Ky vlerësim kryhet me kërkesë të Qeverisë së Shqipërisë dhe përmban një prezantim të progresit të bërë që nga ROSC A&A të vitit 2006 dhe Dokumentit Teknik të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar të vitit 2014 (FSAP). Në të bëhet një përmbledhje e konstatimeve kryesore, identifikohen mangësitë dhe jepen rekomandime për t'u mbajtur parasysh nga autoritetet për rritjen e harmonizimit me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mirë.

Ndër reformat më të rëndësishme që u theksuan në raport ishte ngritja e kuadrit ligjor dhe rregullator për auditimin dhe profesionin kontabël (2009), ndryshimet ligjore (2016) për krijimin e strukturës mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe funksionimit si autoritet rregullator dhe mbikëqyrës. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator dhe ngritja e kapaciteteve të strukturës mbështetëse të BMP-së, ndryshimi i ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me mbështetjen e projektit EQ – FINREP të Bankës Botërore, fokusi në kryerjen e kontroleve të cilësisë për audituesit e NIP, proceset e investigimeve, bashkërendimi i aktiviteteve me rregullatorët përkatës për përmirësimin e cilësisë së auditimit, u theksuan në raport si reforma të realizuara me sukses gjatë kësaj periudhe.

Rekomandimet kryesore politike dhe institucionale:

- Finalizimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Vendin i përditësuar;
- Harmonizimi i kuadrit legjislativ dhe rregullator;
- Përmirësimi i organizimit institucional;
- Harmonizimi me standardet ndërkombëtare;
- Fuqizimi i organizatave profesionale;
- Fuqizimi i arsimit dhe formimit kontabël;
- Fuqizimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit të cilësisë së auditimit;
- Fuqizimi i profesionit të auditimit;
- Fuqizimi i monitorimit dhe zbatimit të reformave të ndërmarra.

10.8. Bashkimi Evropian – Progres Raporti

Komisioni Evropian ka publikuar në datën 06.10.2020 Progres Raportin për Shqipërinë në të cilën vlerësohet ecuria dhe progresi për plotësimin e kriterëve të anëtarësimit të vendit tonë në BE.

Ndër të tjera, në kapitullin nr. 6, vlerësohet puna e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, duke i kushtuar rëndësi të veçantë pavarësisë së BMP, forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse të tij, profesionit të Audituesve Ligjorë dhe Kontabilistëve të Miratuar dhe cilësisë së punës së tyre.

Gjithashtu, Komisioni European vlerëson:

- Miratimin e vendimit për rregullimin e investigimit dhe disiplinës së audituesve ligjorë/firmave të auditimit dhe kontabilistëve të miratuar;
- Marrjen e masave disiplinore nga Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës.

Në raport citohet:

“Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) është autoriteti i pavarur kompetent për sigurimin e cilësisë (me vetëfinancim). Në korrik 2019, ky institucion ka miratuar një vendim për rregullimin e investigimit dhe disiplinës së audituesve ligjorë / firmave të auditimit dhe kontabilistëve të miratuar. Për periudhën për të cilën raportohet, Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës ka vendosur 10 masa disiplinore (nëntë gjopa dhe një pezullim të përkohshëm të

licencës). Gjithashtu, theksohet se duhen bërë përpjekje të mëtejshme për forcimin e kapaciteteve të BMP-së dhe harmonizimit me rregullat e auditimit ligjor të BE-së”.

10.9. Bashkëpunimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në përmbushje të misionit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike për të rritur sigurinë që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik, gjatë vitit 2020, janë realizuar disa bashkëpunime të rëndësishme me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në përmirësimin dhe forcimin e mbikëqyrjes së raportimit financiar.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike u bë pjesë e tryezës virtuale në shqyrtimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat në mbledhjet për shqyrtimin e projektligjit “Për tregjet e kapitalit” dhe projektligjit “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, gjatë të cilave kontribuoi saktësimin në aspekte teknike të çështjeve të lidhura me profesionin e auditimit ligjor dhe terminologjinë e përdorur në këto projektligje. Saktësimi dhe rregullimi i terminologjisë në këto ligje do të mundësojë jo vetëm zbatimin e tij përmes dispozitave, tashmë të rregulluara në kuadrin ligjor dhe rregullator për auditimin ligjor, por edhe disa rregullime që lidhen me harmonizimin me ligjin e auditimit dhe direktivën përkatëse.

Në vijim të bashkërendimit të punës midis dy institucioneve, si edhe me miratimin e projektligjeve të sipër përmendura, puna vijoi me përmirësimin e kuadrit rregullator në zbatim të këtyre ligjeve. Kontributi i BMP-së lidhet me standardizimin e kritereve të shoqërive të auditimit dhe dokumentacionit mbështetës për të qenë të kualifikuara për të kryer auditimet ligjore. Kështu, nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, janë propozuar ndryshimet në:

- Rregulloren nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, e ndryshuar;
- Rregulloren nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të SIK dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar;
- Rregulloren nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”.

Ndër kriteret e propozuara nga BMP për përzgjedhjen e shoqërisë audituese do të veçonim:

- Shoqëria e auditimit duhet të ketë si pjesë të brendshme të strukturës së shoqërisë, burimet njerëzore me kompetencat e duhura profesionale për të kryer auditimin ligjor, ku ekipi i auditimit (pa përfshirë ortakun kryesor të auditimit dhe aktuarin) të ketë minimumi dy anëtarë me përvojë në mbikëqyrjen dhe kryerjen e angazhimeve të auditimeve ligjore;
- I njëjti ekip auditimi, përfshirë edhe aktuarin e kontraktuar nga shoqëria e auditimit, të mos jetë i angazhuar në më shumë se tre auditime të shoqërive të sigurimit (dy auditime të shoqërive administruese);
- Të mos kenë konflikt interesi me shoqërinë që auditon, sipas përcaktimeve të Ligjit;
- Të mos jetë subjekt i parashikimeve të nenit 55, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor”, sipas afateve të përcaktuara në vendimet përkatëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Si pjesë e dokumentacionit mbështetës AMF miratoi me propozimin e BMP-së, si në vijim:

- Metodologjia e auditimit të propozuar duke përfshirë theksin në fushat kryesore dhe qasja përkatëse e auditimit. Programin e auditimit të shoqërisë dhe ekspertë të jashtëm të angazhuar nga shoqëria e auditimit;
- Letra e angazhimit të shoqërisë audituese për aktivitetin e shoqërisë në Shqipëri, si dhe për aktivitetin e konsoliduar të shoqërisë, e cila përveç angazhimit për përmbushjen e kërkesave ligjore në fuqi, duhet të përfshijë edhe trajtimin e çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për shoqëritë që janë subjekt i ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”;
- Letra e angazhimit të shoqërisë audituese duhet të parashikojë edhe:
 - i. Komunikimin e shoqërisë së auditimit me komitetin e auditimit;
 - ii. Letrën e drejtimit; si edhe
 - iii. Letrën e përfaqësimit.

Vlerësimi nga procesi i kontrollit të sigurimit të cilësisë dhe refuzimi i shoqërisë audituese

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejtë të refuzojë shoqërinë audituese, e cila gjatë kontrollit të cilësisë së punës të tyre në tre vitet e fundit, në rastet kur është kryer një kontroll i tillë, është vlerësuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, nën notën C.

10.10. Bashkëpunimi me KKRF

Autoriteti rregullator për mbikëqyrjen dhe rregullimin e profesionit kontabël në Kosovë (KKRF), së bashku me Bordin e Mbikëqyrjes Publike të Shqipërisë, janë gjithnjë në kontakte e përpjekje të vazhdueshme për të vendosur ura bashkëpunimi e nënshkruar memorandume bashkëpunimi për bashkërendimin e aktiviteteve të lidhura me kontrollin e cilësisë dhe ushtrimin e profesionit të audituesit ligjor në të dy vendet. Procesi i hartimit të memorandumit, i lënë pezull për shkak të situatës pandemike përgjatë vitit 2020, pritet të finalizohet brenda vitit 2021.

10.11. Bashkëpunimi me rregullatorë të tjerë në rajon dhe organizata të tjera rajonale

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, në kryerjen e aktiviteteve të veta, në mënyrë të vazhdueshme bashkëpunon me institucionet homologe të rajonit, veçanërisht për çështje të shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave të lidhura me kontrollin e cilësisë. Ky bashkëpunim konsiderohet i rëndësishëm për konsolidimin e marrëdhënieve ndërmjet rregullatorëve të rajonit dhe në vijim pritet që ky bashkëpunim të konsolidohet edhe më tej në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave apo rritjen e kapaciteteve të stafit të strukturës mbështetëse.

11. Planifikimi i punës për vitin 2021

11.1. Planifikimi i punës për rregullimin dhe organizimin e kurseve profesionale për kandidatët për Kontabilistë të Miratuar

Në zbatim të ligjit 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar, BMP ka planifikuar të ndërmarrë hapa për rregullimin dhe organizimin e kurseve profesionale për kandidatët për Kontabilistë të Miratuar. Në këtë aspekt është planifikuar të miratohet edhe Rregullorja “*Për organizimin e kurseve profesionale për kandidatët për Kontabilist të Miratuar*”. Kjo rregullore do të ketë për qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të kurseve profesionale të detyrueshme për kandidatët për kontabilist të miratuar, do të parashikojë rregullimet lidhur me literaturën e nevojshme, programin e trajnimit, kriteret që duhet të plotësojnë personat e përfshirë në procesin e trajnimeve nga Organizatat Profesionale, do të përcaktojë mënyrën e organizimit të këtyre kurseve lidhur me kohëzgjatjen dhe procedurat e testimit që dëshmojnë zotërimin e njohurive të nevojshme nga kandidatët për Kontabilist të Miratuar, si dhe gjithashtu do të parashikojë procedurat e verifikimit, klasifikimit, të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve për të fituar statusin kandidat për Kontabilist i Miratuar.

Me qëllim realizimin e testeve, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve për auditues ligjorë, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) do të ngrihet dhe funksionojë Komisioni i Provimeve të Kurseve Profesionale (KPKP), funksionimi dhe detyrat e të cilit do të gjejnë pasqyrim në rregulloren e sipërpërmendur.

11.2. Ndryshimi i Rregullores Nr. 7, datë 02.10.2018 për “Procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor”

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, në bashkëpunim me Organizatën Profesionale të Audituesve Ligjorë, me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator të kontrollit të cilësisë dhe përafrimit të saj me kërkesat e direktivës evropiane për auditimin dhe rregulloren në zbatim të kësaj direktive, ka nisur një punë intensive për rishikimin e Rregullores Nr. 7, datë 02.10.2018 për “*Procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor*”. Ndryshimet e propozuara kanë ardhur edhe si rrjedhojë e eksperiencës tre vjeçare të realizimit të inspektimeve të kontrollit të cilësisë dhe sfidave të ndeshura gjatë procesit të kontrollit të sigurimit të cilësisë.

11.3. Memorandumi me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Në vitin 2021, Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) ka planifikuar të nënshkruajë një memorandum bashkëpunimi me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

Ky memorandum, ndër të tjera, pritet të parashikojë:

- bashkëpunimin në përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e rregullator në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare;
- delegimin e kontrollit të cilësisë për njësitë jo NIP;
- bashkërendimin e proceseve të investigimit;
- unifikimin e deklaramentit të misioneve;
- bashkërendimin e veprimtarisë në proceset e përmirësimit të punës nga anëtarët e IEKA's;
- rritjen e imazhit dhe rolit të institucioneve dhe profesionistëve të fushës.

11.4. Kontrolli i cilësisë

Përgjatë vitit 2021 do të realizohen 20 inspektime, pjesë e planit të miratuar nga BMP për angazhimet e auditimit të realizuara gjatë vitit 2019 – 2020. Në fokus do të jetë edhe kontrolli i cilësisë për audituesit që kanë më pak se 5 vite përvojë punë që ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor në mbështetje të nenit 38 dhe 39 të ligjit të auditimit mbi bazën e analizës së riskut mbështetur në metodologjinë e parashikuar në rregulloren nr. 7, datë 02.10.2018. Ky proces tashmë ka filluar, në periudhën Mars – Prill 2021 janë përzgjedhur për kontroll katër auditues ligjorë të cilët kanë dorëzuar informacionin dhe do të vijohet me një vizitë në terren. Përzgjedhja e audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit realizohet në bazë të kriterëve si më poshtë: (i) audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit të angazhuar në auditimin e njësive ekonomike me interes publik, bazohet në një cikël 3-vjeçar kontrolli të angazhimeve të auditimit. Ky proces realizohet të paktën 1 herë, brenda ciklit 3 vjeçar. Ndërkohë, bazuar në faktorët e riskut si dhe nisur edhe nga burimet e informacionit, BMP mund të identifikojë angazhime specifike auditimi të njësive me interes publik, të cilat kërkojnë kontroll më të shpeshtë; (ii) audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit që kanë ndërmarrë angazhime auditimi të njësive jo me interes publik, bazohet në një cikël 6-vjeçar. Prioritet i kushtohet audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit që paraqesin riskun më të madh bazuar në vlerësimin e riskut të bërë.

Kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit duhet të marrin në konsideratë edhe informacionin shtesë që vjen nga raportet vjetore të veprimtarisë së audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit, si dhe rezultatet e kontrolleve të cilësisë të realizuara prej BMP-së në të kaluarën.

11.5. Inspektimet tematike për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Në zbatim të planit të inspektimit të hartuar gjatë vitit 2020 do të realizohen inspektimet me qasje në rrezikun e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në kuadër të planit të veprimit të miratuar dhe në zbatim të metodologjisë së mbikëqyrjes të bazuar në rrezikun e parandalimit dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit në rregulloren nr. 12, datë 02.07.2020 “*Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*”, udhëzuesin për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit dhe manualit për mbikëqyrjen e subjekteve parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka parashikuar realizimin e vizitave në terren gjatë periudhës prill – maj 2021 në 4 (katër) subjekte raportuese, auditues ligjorë / shoqëri auditimi.

Gjithashtu do të realizohet ndjekja e rekomandimeve të lëna nga ekipi i inspektimit, në subjektet e inspektuara gjatë vitit 2020.

11.6. Testimi i kontabilistëve të miratuar për përmbushjen e orëve të edukimit të vijueshëm profesional

Përgjatë vitit 2021, BMP, me propozimin e Komisionit Ad-Hoc për verifikimin e KM, ka planifikuar të realizojë testimin e kontabilistëve të miratuar për përmbushjen e orëve të edukimit të vijueshëm profesional, për ata të cilët nuk e kanë përmbushur këtë detyrim për periudhën kohore 2014-2019.

Ky testim u pa si domosdoshmëri pas shqyrtimit të orëve të edukimit të vijueshëm të Kontabilistëve të Miratuar gjatë procesit të verifikimit nga ana e komisionit. Nga shqyrtimi i dosjeve të KM u pa se problematika kryesore mbetet mos përmbushja e detyrimit ligjor përsa i përket kualifikimit të vijueshëm.

Vendimi i Komisionit Ad-Hoc u bazua në nevojën emergjente dhe mbështetet në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*” si dhe aktet nënligjore të miratuara, konkretisht neni 25 dhe neni 52 i ligjit 10091/2009, i ndryshuar, pika 7 e nenit 4 të Rregullores nr. 9 datë 27.02.2019, pika 29 e nenit 12 të Rregullores nr. 9, datë 27.02.2019.

Testimi i Kontabilistëve të Miratuar për orët e pa përmbushura pritet të realizohet brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe kalimi me sukses i tij do të konsiderohet si përmbushje e detyrimit të ndjekjes së orëve për edukimin e vijueshëm profesional.

Në kuadër të këtij testimi, BMP ka planifikuar të finalizojë e miratojë në vijim edhe rregullat specifike për organizimin dhe funksionimin e këtij testimi. Ky vendim do të ketë për qëllim monitorimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të testimit sipas moduleve përkatëse profesionale të detyrueshme për Kontabilistët e Miratuar që nuk kanë përmbushur detyrimin e edukimit të vijueshëm profesional për periudhën 2014-2019, si dhe në të do të parashikohen: rregulla të përgjithshme lidhur me modulet e përfshira në programin e testimit dhe kriteret që duhet të plotësojnë personat e përfshirë në procesin e testimit, si dhe organizimi i procedurave të testimit nga Organizata Profesionale e Kontabilistëve të Miratuar dhe monitorimi nga Sekretariati Mbikëqyrës.

11.7. Mbikëqyrja e Kontabilistëve të Miratuar dhe organizatave profesionale përkatëse

Në kuadër të rregullimit dhe mbikëqyrjes së profesionit të Kontabilistëve të Miratuar të parashikuar në rregulloren nr. 9, do të vijojë puna intensive e stafit të BMP-së në procesin e verifikimit të KM-ve dhe mbikëqyrjes së organizatave profesionale përkatëse, sipas një kalendarit të brendshëm pune.

BMP do të vijojë të përditësojë dhe pasqyrojë çdo ndryshim eventual në listën e organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar të njohura prej tij në faqen zyrtare.

11.8. Trajnime të ndryshme për zhvillimin e stafit

BMP ka parashikuar trajnimin e stafit me qëllim rritjen e mëtejshme të aftësive të tyre profesionale në kuadër të veprimtarisë mbikëqyrëse.

Gjatë muajit Shkurt 2021 është planifikuar ndjekja e seminareve virtualë mbi mbikëqyrjen publike të auditimit të organizuar nga Qendra e Bankës Botërore për Reformën Financiare (CFRR) në kuadër të programit rajonal për Forcimin e Auditimit dhe Raportimit në Vendet e Partneritetit Lindor, STAREP, në bashkëpunim me autoritetin e mbikëqyrjes së auditimit të Francës H3C (Haut Conseil du Commissariat aux Comptes). Qëllimi i këtyre webinar-ëve është ndarja e njohurive dhe eksperiencës në mbikëqyrjen publike dhe sistemeve të sigurimit të cilësisë së auditimit përmes prezantimeve dhe diskutimeve të përvojës së të gjitha vendeve pjesëmarrëse.

Për shkak të gjendjes së pandemisë globale, pjesëmarrja në takimet dhe seminarët e planifikuar në vitin 2020 nga Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit (IFIAR) nuk mundën të realizohen sipas kalendarit.

Gjatë vitit 2021, në 23 – 25 Mars, është planifikuar realizimi i Seminarit të Inspektimit të IFIAR në formën e tryezave virtuale me qëllim vijimin e shkëmbimit të eksperiencave me shtetet anëtare dhe marrjen e njohurive më të mira në realizimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë, diskutimin e raporteve dhe analizave të kryera nga mbikëqyrësit homologë dhe trajtimin e çështjeve kryesore dhe sfidave të procesit të kontrollit të cilësisë që ndeshen nga të gjithë mbikëqyrësit e profesionit të auditimit ligjor.

Në vijim, janë planifikuar trajnime të ndryshme pranë Qendrës së Ekselencës Financiare – CEF ndër të cilat vlen të përmendim:

- Auditimin e bazuar në performancë (performance-based auditing), që synon të sigurojë një kuptueshmëri të kornizës për auditimin e bazuar në performancë, pasi kjo i lejon audituesit në sektorin publik të sigurojnë që njësitë ekonomike të audituara janë duke përmbushur objektivat e tyre dhe realizimin e misionit në ofrimin e shërbimeve të tyre;
- Shpalosja e të Dhënave në Raportimin e Auditimit (Data Visualization in Audit Reporting) si një mjet i rëndësishëm për komunikimin efektiv të informacionit të rëndësishëm të mbledhur gjatë kryerjes së inspektimeve, për të nxjerrë në pah mesazhet dhe për t'i organizuar me qëllim raportimin efektiv të mangësive të identifikuara. Kjo nga ana tjetër ndihmon subjektin e kontrolluar që të kuptojë si duhet çështjet komplekse dhe të adresojë mangësitë e identifikuara.

11.9. Roli dhe kontributi i BMP në raportimin në FATF

Që prej muajit Shkurt të vitit 2020, kur Shqipëria bëri një angazhim të nivelit të lartë politik për të punuar me FATF dhe MONEYVAL për të siguruar një sistem të fortë të PPP/FT, janë përmirësuar një sërë aspektesh të rëndësishme, përfshirë këtu zbatimin e ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, marrjen e masave për zvogëlimin e ekonomisë informale, etj.

Për zbatimin e planit të veprimit për efektivitetin e masave të marra, Bordi i Mbikëqyrjes Publike vijon të jetë pjesë aktive e raportimeve të ecurisë së zbatimit të këtij plani tek ekspertët vlerësues të grupit ICRG/FATF. Gjatë vitit 2021 prioritet vijon të mbetet kryerja e inspektimeve tematike me fokus në rrezikun e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të subjekteve të mbikëqyrura, raportimi dhe marrja e masave disiplinore dhe administrative, në rast se do të konstatohen mangësi në programet dhe zbatimin e masave të PPP/FT nga subjektet e mbikëqyrura.

11.10. Bashkëpunime me institucione të tjera

BMP, me qëllim realizimin e misionit dhe vizionit të tij mbikëqyrës, do të vijojë bashkëpunimin e tij aktiv me institucione të tjera qendrore e lokale në vend si DPT, QKB, KKK apo institucione të tjera rregullatore.

Gjithashtu, do të vijojë bashkëpunimi e komunikimi ndërinstitucional me Ministrinë e Drejtësisë lidhur me regjistrin e konsoliduar të KM-ve me qëllim mbajtjen e tij të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe reflektimin e shtesave/ndryshimeve në regjistrin elektronik të ekspertëve të cilët mund të ofrojnë njohuri të posaçme pranë organeve të drejtësisë për fushën përkatëse, si dhe përcjelljen e informacionit që mund të kërkohet lidhur me subjekte specifike KM.

Bashkëpunime të tjera do të synohen të vijojnë gjithashtu edhe me shoqatat e biznesit dhe institucionet e drejtësisë.

Ky raport është përgatitur vetëm për informacion të përgjithshëm. BMP nuk pranon asnjë përgjegjësi ndaj ndonjë pale për humbje, dëmtime ose shpenzime, pavarësisht nëse janë në kontratë, kundërvajtje ose në ndonjë mënyrë tjetër nga ndonjë veprim apo vendim i marrë (ose jo), si rezultat i ndonjë personi që mbështetet në këtë raport ose e përdor gjetje të pasqyruara në të.